



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 23 DHE 30 MAJ 2013**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 23. I 30. MAJA 2013. GODINE**

**MAJ - MAJ
2013**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Zyrës së Rregullatorit për Ujësjetllës dhe Kanalizim për vitin 2012,
5. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2012,
6. Debat parlamentar lidhur me gjendjen e pyjeve në Kosovë, sipas kërkesës së Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanje izvan dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Razmatranje Godišnjeg izveštaja o radu Kancelarije Regulatora za vodovod i kanalizaciju za 2012. god.
5. Razmatranje Godišnjeg izveštaja o radu Regulativnog autoriteta za železnice za 2012. god.
6. Parlamentarna rasprava u vezi situacije šuma na Kosovu, na zahtev Komisije za poljoprivredu, šumarstvo, seoski razvoj, sredinu i prostorno planiranje.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I hap punimet e mbledhjes plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar në 30 minuta. Diskutimet në emër të grupeve parlamentare deri në 5 minuta, në emër të deputetit 3 minuta.

Fjalën e ka deputetja Valbona Dibra.

VALBONA DIBRA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot dua ta ngre një çështje shumë shqetësuese për qytetarët e Prishtinës në rastet kur kemi reshje të shiut.

Shumë lagje të Prishtinës, e njëra nga lagjet ku unë isha e pranishme Mati 1, dje pas dite ishte vërshuar nga ujërat e zeza. Këto vërshime ishin si pasojë e pusetave të ndërtuara dobët, të cilat nuk e kanë kapacitetin e duhur për thithjen e ujërave.

Për mua ishte shumë shqetësuese kur uji i vërshoi edhe lokalet përreth, e në një nga ato lokale ishte një barnatore, e cila e tëra ishte në ujë.

Si pasojë e vërshimit nga ujërat e zeza, ky biznes familjar kishte pësuar dëme të mëdha në medikamente mjekësore.

Kjo është një papërgjegjësi e Komunës së Prishtinës ndaj qytetarëve të vet. Prandaj, nga këtu u bëj thirrje organeve kompetente të komunës së Prishtinës që të marrin masa urgjente në rregullimin e pusetave, sepse një gjë e tillë është lehtë e menaxhueshme, kuptohet nëse ekziston vullneti i mirë.

Përpos kësaj dukurie, e cila paraqitet çdo herë kur ka reshje në këtë lagje, shumë shqetësuese për këta banorë është edhe derdhja e ujërave të zeza mu pranë banesave të banimit, ku kundërmimi i erës së kanalizimit është i pranishëm gjatë gjithë kohës, karshi pluhurit që gjithashtu është gjithmonë i pranishëm në kryeqytetin tonë.

Çështjet e ngrehura janë shumë shqetësuese për këta qytetarë dhe nga këtu apeloj që urgjentisht të merren masa në rregullimin e kanalizimit në këtë lagje, me qëllim të parandalimit të ndonjë epidemie. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Hykmete Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Jakup Krasniqi!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar përfaqësues të Qeverisë,

Unë në fakt i kam disa çështje që janë shumë më shqetësuese se çështja e shirave dhe çështja e pushtetave në Prishtinë. Besoj se ato rregullohen dhe janë në proces për t'u rregulluar çdo ditë, por po se shihni vërshime ka në çdo anë të botës dhe ato nuk mund t'i ndalë askush.

Të nderuar deputetë,

Shitja e Distributimit dhe Furnizimit të energjisë ishte skandal në vete. U shit për 26,3 milionë euro. Mbi këtë skandal, Qeveria e ndërtoi një skandal tjetër. Ditë më parë, Zyra e Rregullatorit të Energjisë e ka marrë një vendim që t'i japë konsorciumit "Limak&Çalik" 17,9 milionë euro.

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Nga kjo foltore, unë kërkoj që Kuvendit, apo kushdo që është i mandatuar ta thërrasë urgjentisht Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dhe ta shpjegojë vendimin e ZRE-së për dhënien e 17,9 milionë eurove.

Në mbledhjen e ditës së premte të Komisionit për Buxhet dhe Financa, ku ZRRE-ja raportoi për raportin financiar të zyrës së saj, unë e pyeta për arsyeshmërinë e këtij vendimi. Arsyeja ishte skandaloz.

Ata thanë se KEK-u në planifikimin e të hyrave ka marrë nga qytetarët 17, milionë euro më tepër gjatë vitit 2012 dhe kjo shumë duhet t'u kthehet qytetarëve, në mënyrë që t'u kthehet qytetarëve, sipas ZRE-së kjo shumë duhet të jepet konsorciumit "Limak&Çalik".

Pyetja ime pasuese ishte: Si do ta shohim ne si konsumatorë se na janë kthyer këto të holla, pasi KEK-u i paska marrë më tepër? Ata thanë që ju nuk do t'i shihni, sepse kjo shumë nuk do të faturohet.

Të nderuar kolegë deputetë,

Jam munduar ta gjej një fjalë më të përshtatshme, por me të vërtetë fjala më e përshtatshme këtu ka qenë hajni klasike, dhe ne duhet ta thërrasim ZRRE-në dhe të na tregojë cili ka qenë ndikimi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomikë dhe të japë përgjegjësi para këtij Kuvendi.

Unë kërkoj shumë falje nëse po ndërhyj në punën e Komisionit Hetimor për Energji, por e shtrova këtë çështje për arsye se koha vlen shumë dhe ne duhet të marrim vendim si Parlament para se ky vendim të zbatohet pikërisht për këtë arsye. Do të thotë, 17,9 milionë euro!

Distribucioni është shitur për 26,3 milionë, konsorciumit “Limak&Çalik” i jepen 17,9 milionë euro, vlera e Distribucionit bie në 8,4 milionë. Nëse llogaritim edhe orët digjitale që janë instaluar pas kohës së privatizimit, që kanë kushtuar 9,5 milionë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Vazhdo, në emër të grupit.

HYKMETE BAJRAMI: ...i bie që Qeveria e Kosovës i ka dhënë diku konsorciumit “Limak&Çalik” 1,6 milion euro për ta marrë Distribucionin dhe Furnizimin, për të krijuar një monopol privat dhe kjo është e papranueshme dhe ne nuk duhet të ngelim në nivelin deklarativ, por definitivisht duhet të marrim hapa.

Skandali tjetër: Këto ditë Gjykata e Arbitrazhit në Londër mori vendim që PTK-ja t’i kthejë kompanisë ‘AMDOCS’ 8,7 milionë euro. A e dini pse? Sepse në vitin 2008, Postë-Telekomi i Kosovës kishte nënshkruar një kontratë për një projekt faturimi me kompaninë ‘AMDOCS’. Ministria e Financave asaj kohe e Qeverisë Thaçi 1 e ndaloj projektin. Ky vendim i Qeverisë sot i kushton Buxhetit të Kosovës 8,7 milionë euro. Dhe, për këtë, njerëzit duhet të japin përgjegjësi, sepse i kemi pikërisht ata persona që sot e udhëheqin Qeverinë e vendit.

Skandal tjetër ishte Ligji për bankat dhe institucionet mikrofinanciare. Nëpërmjet këtij ligji, deputetët e këtij Kuvendi, njerëzit nga Qeveria, Banka Qendrore, u munduan të manipulojmë me mbi 100 milionë euro të këtyre institucioneve. Ne e kundërshtuam fort si Lidhje Demokratike e Kosovës këtë ligj, tash e kemi vendimin e Gjykatës Kushtetuese, i cili i shpalli të pavlefshme dhe antikushtetuese pikërisht ato nene, të cilat ne i kundërshtuam.

Të nderuar deputetë,

Këto janë çështje shumë serioze. Kjo Qeveria po e ha buxhetin e shtetit! Kjo Qeveri po e vjedh ardhmërinë e fëmijëve tanë! Andaj ne duhet të bashkohemi dhe duhet të marrim masa, e të mos mbetemi vetëm në nivele deklarative, sepse deklaratat po na vijnë nga mediet dhe ne duhet të veprojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën, në emër të Grupit, e ka deputeti dhe kryetari i Grupit “Vetëvendosje”, Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Tash e 14 vjet, “Trepça” është trajtuar nga të gjitha instancat e pushtetit në Kosovë, vendore e ndërkombëtare qofshin ato, sikur barrë, e jo si pasuri. Ajo që dikur ishte krenarie ekonomike e industriale e Kosovës, e që kishte qenë po ashtu objekti më tërheqës për pushtim e kolonizim të vendit tonë, që prej çlirimit filloi të konsiderohej si fatkeqësi. Filluan të na thonë se si është një gjigant i vdekur, që ka shumë borxhe, që kërkon shumë investime, e rezervat i ka në rënie. Pra, na thoshin se industria e rëndë e metaleve në Kosovë është çështje e së shkuarës, ndërsa tash ekonomia jona na paska

nevojë për ndërmarrje të vogla e të mesme, kryesisht këto tregtie, shërbimesh tjera, e ndoshta edhe e ndonjë prodhimi në shkallë të ulët.

Dhe pas krejt këtyre fjalëve fshihej diçka tjetër. Që ndarja e Mitrovicës dhe e “Trepçës” ishin një dhe e vetmja gjë. Që prej atëherë, kombinati ynë i “Trepçës” funksionon si dy: “Trepça” në veri dhe “Trepça” në jug. Kjo ndarje praktikisht e paralizoi ndërmarrjen, sepse minierës ia tjetërsoi shkritoren. Miniera pa shkritore dhe kapacitetet tjera përpunuese të metalit përfundon në industri nxjerrëse me shkallë të ulët të shtimit të vlerës. Kështu nuk shesim metale, por koncentrat metalesh, e pastaj metalet e prodhimet e metalurgjisë i bën tjetërkush dhe na i shet neve shumë më shtrenjtë.

Serbia përherë fliste se si veriu i Kosovës na qenka i banuar me serbë dhe prandaj aty pushteti i Kosovës nuk është i pranueshëm. Këtë ndërkombëtarët e pranuan për të vërtetë. Dhe, fatkeqësisht, filluan t’i bindin edhe pushtetet vendore. Por, në fakt, Serbia nuk e do pushtetin e Kosovës në veri për shkak se aty banojnë “Trepça” dhe “Ujmani”. Dhe, kjo u dëshmuar me ngarendjen e Qeverisë së Serbisë të nënshkruajë marrëveshje me “New Power Generation” për partneritet publiko-privat për “Trepçën”.

E ashtuquajtura marrëveshje ndërmjet Kathurias dhe ministrit të Resurseve Natyrore dhe Minierave të Serbisë, vjen si pasojë e veprimeve e vendimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe negociatave në Bruksel. Faktorizimi politik e ekzekutiv i Serbisë brenda Kosovës, që ndodhi gradualisht nëpërmjet negociatave, e që u kurorëzua me marrëveshjen e 19 prillit, e inkurajoi Serbinë që të sillet sikur ka pushtet sovran në Kosovë. Bordi i AKP-së, i politizuar e i ndërkombëtarizuar, vështirë se mund të reagojë. E Qeveria e shantazhuar e Kosovës, më me rëndësi e ka të mbetet në pushtet e larg nga burgu se sa ta mbrojë “Trepçën” dhe plaçkitësit e matrapazët.

Për këtë tregon më së miri gatishmëria e kryeministrit Thaçi, që sot, sikur të mos ketë ndodhur asgjë, takohet sërish me Daçiçin, ministrat e të cilit bëjnë marrëveshje për “Trepçën” me palë të treta.

Lëvizja “Vetëvendosje” kurrë dhe asnjëherë nuk do të pranojë marrëveshje të tilla për pasuritë e Kosovës. Në këtë kohë të matrapazëve, ata edhe mund të bëhen se i shesin, e matrapazë të tjerë edhe mund të bëhen se po i blejnë, por ato janë dhe do të mbeten pasuri e popullit dhe shtetit të Kosovës.

Është po ashtu shumë e çuditshme dhe absolutisht e papranueshme se si Qeveria e Kosovës ende nuk reagon për këtë marrëveshje, që e ka nënshkruar Serbia, përkatësisht Qeveria e Serbisë për “Trepçën”, pra për një gjigant, i cili është i Kosovës.

Kjo Qeveri duhet sa më parë të kërkojë llogari edhe nga Departamenti Amerikan i Shtetit, meqenëse është përmendur në këtë marrëveshje të deklarohet për qëndrimin e tij karshi kësaj marrëveshjeje dhe karshi këtij investimi potencial në “Trepçë” dhe të deklarohet nëse e njeh “Trepçën” dhe veriu si pjesë të Kosovës apo jo. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën, në emër të Grupit, e ka kryetari i Grupit të Aleancës, Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Vërtet te deklarinimet jashtë rendit të ditës është bërë pak problem të vendosen prioritetet. Domethënë kur mblidhet grupi dhe fillon të bisedojë se çka, temat janë të zorshme, ka tepër shumë tema të rënda, ka tepër shumë çështje të cilat do të duhej ta kenë vëmendjen edhe të Kuvendit, edhe të publikut, por definitivisht ndoshta edhe të Qeverisë.

Sot, në emër të grupit, do të flas për situatën në Administratën Publike të Kosovës, shumë shkurt. E di që do të kemi raport, mirëpo mendoj që duhet të nisë ky debat.

Është e njohur që janë tri motive kryesore, ose tri elemente kryesore për ta motivuar Administratën për të punuar. Çka i motivon ata njerëz që ta kryejnë punën siç duhet?

Çështja e parë, si gjithkund, në botë janë pagat, sepse punojnë për një rrogë.

Çështja e dytë, zakonisht kur dikush punon për shtet, e ka edhe një shtresë të hollë të patriotizmit, se ata punojnë për shtetin, e është një sadsfaksion të punohet për shtetin.

Çështja e tretë, që është jashtëzakonisht e rëndësishme, ndoshta më e rëndësishmja - vija e karrierës. A përparojnë në karrierë ata njerëz me vite?

Dhe kur çështja e pagës dhe e karrierës eliminohen prej konfiguracionit nuk mbetet patriotizëm. Njerëzit nuk kanë më motiv për të punuar.

Në Qeverinë e Kosovës, sidomos në 5 vjetët e fundit, ajo që ka ndodhur me punëtorët e Administratës është me të vërtetë tragjike.

Punëtorët që punojnë aty tash e 10 vjet i kanë parë shefat duke u ndërruar. Vjen dikush prej një partie politike, vjen dikush në sistem nepotist, vjen dikush kush e di për çka, po ata njerëz të cilët kanë punuar gjatë, ata njerëz të cilët janë edukuar për punën e vet, ata njerëz të cilët janë trajnuar me buxhetin e shtetit, e kanë parë vetën për 10 vjet duke mbetur në pozitën e njëjtë. A beson dikush prej jush që ata e kanë ndonjë motiv për të punuar? A besoni ju dikush se ka motiv të punojë një njeri, të cilit dy herë i ndërrohet shefi, dhe shefi i shefave i thotë t'i duhet ta mësosh si të punojë.

Mund të them se mënyra kryesore për ta shkatërrua shtetin, është të shkatërrohet Administrata. Ka shtete shumë të fuqishme, në të cilat politika, politikanët sikur ne, janë gati në ekzistent me muaj të tërë për shkak se nuk zgjidhen, por shteti funksionon. Funksionon sepse funksionon Administrata e shtetit, se është profesionale, se është e mirë. Shteti shkatërrohet kur shkatërrohet Administrata e shtetit. Jo ndryshe! Edhe ndërtimi i asaj administrate është ndërtim i shtetit. U bë me mund një pjesë e madhe. Kryetari i sotëm i Kuvendit ka qenë ministër kur ka nisur një reformë në Administratë. Ka vazhduar edhe më vonë. Kemi pas ndihmë për ndërtimin e asaj administrate.

Për 5 vjet, zonja dhe zotërinj, Administrata e shtetit është shkatërruar, është joekzistente, e njerëzit të cilët udhëheqin me Administratën janë joprofesionalë, janë të padijshëm,

përderisa të dijsmit, të ndershmit, ata që kanë punuar mbi 10 vjet aty, janë anashkaluar për një kohë të gjatë dhe nuk shohin vijë të karrierës, nuk shohin shpresë se një ditë do të përparojnë në karrierën e tyre, që të mund të angazhohen më tepër.

Aleanca mendon se në një të ardhme të afërt, një ndër çështjet kryesore të ndërtimit të shtetit, do të jetë motivimi i Administratës, ndërtimi i situatës në të cilën njerëzit që punojnë në Administratë, edhe nëpër komuna, edhe nëpër ministri, edhe këtu në Kuvend, ta ndiejnë se nëse punojnë ndershëm, ta ndiejnë se nëse aftësohen ndershëm, do të përparojnë edhe në karrierë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Goran Marinković.

GORAN MARINKOVIĆ: Hvala predsedniče!

Dana 20.5.2013.godine, Poslanička grupa "Zajednička Budućnost" dobila je dopis od predsednika opštine Gračanica, koji nas je veoma uznemirio i zabrinuo. Naime radi se o procesu privatizacije, koje je pokrenuto od Kosovske agencije za privatizaciju, u kojim je agencija u 57. i 58. kolu objavila privatizaciju kosovskih društvenih preduzeća, u kojem je obuhvaćena imovina društvenog preduzeća 'Ratar' iz Lapljeg sela, a gde se imovina preduzeća nalazi u Lapljem selu i u selu Sušica.

Poštovani poslanici,

Razlog našeg zabrinutosti je taj da se tom privatizacijom ugrožavaju vitalne funkcije opštine. Tom privatizacijom je obuhvaćena je nepokretna imovina za koje opština Gračanica ima predviđene projekte svojim urbanističkim planom, kojim je planirala svoje kapitalne razvojne projekte, koji su od oplštenog društvenog značaja za opštinu i njen dalji razvoj. Ono što nas je posebno zabrinulo, a što smo iz dopisa i razgovora sa odgovornim ljudima iz opštine, kao i sa gradonačelnikom mogli primetiti, to je da KPA prekršila procedure, koja je kao agencija morala da ispoštuje, jer u članu 12. Zakona o korišćenju i razmenu nepokretne imovine opština, opština može da povрати nepokretnu imovinu koja obuhvata zemljište bivših preduzeća na teritoriji opštine na kojima se nalazi.

Gospodo poslanici,

Kosovska agencija za privatizaciju morala je da sarađuje i ispoštuje zahteve opštine za dostavljene informacija o delovima preduzeća koji će se privatizovati, a koje se odnose na društvene preduzeće 'Ratar'. Da bi se ustanovilo da ne postoje i potraživanja fizičkih lica po osnovu pravosnažnih akata, kao i potraživanja opštine Gračanica za realizaciju njenih kapitalnih projekata, što možemo videti iz nama dostavljenih i-melova, koje smo dobili iz opštine kao dokaz da su zaposleni u opštini obraćali agenciji, ali nažalost niko nije odgovorio.

Poštovani poslanici,

Ovom prilikom apelujem i tražim u svoje ime, kao u ime Poslaničkog kluba "Zajednička Budućnost", i u ime opštine Gračanica, da se u 57. i 58. kolu obustavi proces privatizacije koji se odnosi na imovinu novo preduzeće 'Ratar Laplje selo 1', 'Novo preduzeće Ratar

Laplje Selo 2', 'Novo preduzeće Ratar Laplje Selo 3', kao i novo poduzeće 'Ratar 1', 'Sušica 2', novo poduzeće 'Sušica 3'.

Nadam se da će odgovorni ljudi iz agencije čuti našu poruku, kao i našu zabrinutost, i da će na najbolji mogući način, naći način da se ovaj problem reši na obostrano zadovoljstvo i uvažavanja interesa obeju strana. Hvala!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë nuk do të flas as për ujin e Prishtinës, as për ato çështjet mikrofinanciare, por do të flas për një gjendje dhe një masakër që ka ndodhur në Burgun e Dubravës dhe kur vitin e kaluar ne e kemi mbajtur një debat këtu në Kuvend të Kosovës pikërisht për këtë çështje, dhe nga Shoqata e të Burgosurve Politikë është kërkuar dhe është bërë një padi penale në Gjykatën e Qarkut atëherë, tash të Apelit në Pejë, në vitin 2007, dhe nga ajo datë nuk kemi asnjë përgjigje, që në një formë apo një tjetër dikush është marrë me këtë çështje.

Në Burgun e Dubravës, në masakrën prej 19 majit deri më 24 maj janë vrarë mbi 120 shqiptarë nga forcat policore-ushtarake serbe, të komanduara drejtpërdrejtë nga shteti serb, nga ministri dhe Ministria e Serbisë.

Për këtë çështje ne kemi qenë edhe dje në vizitë në Burgun e Dubravës, e kemi parë edhe dokumentarin e bërë mbrëmë, ku 120 shqiptarë të vrarë me dëshmi dhe me faktografi, me armë dhe nga afërsia, me pistoletë, prandaj është një gjendje shumë e rëndë dhe një traumë që nuk mund të kalohet.

Në Burgun e Dubravës nuk dihet as për Ukshin Hotin, nuk dihet për fatin e tij se ku është. Të gjitha këto duhet të ngjallen nga enigma, enigma të zbardhet, sepse atë e ka marrë komandanti i burgut, Branko Komadina, drejtori i Burgut, Aleksandar Rakoçeviq, dhe Miki, komandant i burgut.

Këto të gjitha dihen, dihen edhe përgjegjësit të cilët kanë marrë pjesë në masakër, dihen edhe emrat e atyre që shoqata i ka bërë publik, dihen edhe vrasësit, dihen edhe të vrarët. Ndërsa, gjykata, Prokuroria, Ministria e Drejtësisë, apo Inspektorati as nuk e kanë çarë kokën për këtë gjendje.

Mund të pyesim se deri ku do të shkojë dhe do të vazhdojë kjo gjendje pas 14 vjetëve? A do të presim që ne do të pajtohemi edhe do t'i ulim gjakrat? A do të presim që ne do të jemi ata që do të falim? Përderisa nuk veprojnë organet e drejtësisë, për njerëzit të cilët kanë humbur dhe kanë rënë në Dubravë, falje nuk mund të kërkohet.

Falje nuk mund të kërkohet pa u dënuar krimi dhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Në emër të grupit, regjia edhe dy minuta Naitit.

NAIT HASANI: ...Në këtë masakër, ne si ish të burgosur e pjesëmarrës që kemi pasur fatin të jemi aty e t'i shohim ato tmerre, duhet dikush të japë përgjegjësi. Ministria e Drejtësisë nuk e çan kokën ose deklarohet vetëm se ne jemi në veprim. Inspektorati Gjyqësor po ashtu. Prokurorët heshtin. Kujt t'i drejtohem, cilit organ t'i drejtohem që të merren masa në këtë drejtim?

Kallëzimi penal ekziston. Ekziston që nga viti 2007 në Gjykatën e Pejës, në Prokurorinë e Pejës. Ne presim, me shpresë që drejtësia do të vijë në vend. Ne besojmë në drejtësi dhe ligje, por këto ligje do t'i bëjnë njerëzit, të cilët janë të zgjedhur dhe janë përgjegjës për marrjen e vendimeve. Ne nuk kemi asgjë kundër serbëve, por ne kemi, dhe duhet të kemi, dhe do të kërkojmë marrjen e masave ndaj atyre që kanë qenë përgjegjës në Burgun e Dubravës dhe që e kanë bërë masakrën. Nuk duhet të presim, se në vitin e ardhshëm e kemi 15-vjetorin dhe, nëse deri atëherë nuk do të ndërmerren masa, besoj që shoqata do ta shikojë mundësinë e veprimit të vet. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Sadri Ferati.

SADRI FERATI: Përshëndetje, i nderuar kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Edhe unë do t'i bashkohem një shqetësimi të të gjithë shoqërisë kosovare. Ajo çka ndodhi javën e kaluar, pra një spektakël i nënshkrimit të një marrëveshjeje ose forme të bashkëpunimit ndërmjet ministrisë përkatëse të Serbisë dhe të një investitori spekulativ, por që lidhet me pronën dhe pasurinë e Kosovës, pra në këtë rast me "Trepçën". Nuk u brengosa dhe nuk merakosa pse dikush në Beograd bisedon për pronën e huaj, pra për pronën e Kosovës, por brengosem kur institucionet kompetente në Kosovë mjaftohen me deklaratën se ajo nuk është legale.

Jua përkujtoj më herët edhe një deklaratë të zyrtarëve të lartë, përkatësisht kryeministrit të Serbisë në Këshillin e Sigurimit se prona e "Trepçës" është e Serbisë dhe shikoni se a mund të gjeni diku ndonjë reagim të institucioneve të Republikës së Kosovës për atë deklaratë jo të vogël, ngase kjo është një prej pasurive të mëdha të Kosovës, që ende nuk është shitur dhe ende nuk është zhvlerësuar sikur që kanë ndodhur me shumë të tjera. Prandaj, me këtë rast, unë dua të nge shqetësim dhe pres nga institucionet, pra gjithsesi nga Agjencia, nga Dhoma e Veçantë, por edhe nga ministrinë përkatëse, ngase e marrim me mend se çfarë mobilizimi ndodh kur pritët një shirit me gazeta, me gazetarë, me kamera, ndërsa kur flitet për një pasuri kaq të madhe të Kosovës, mjafton nga një kabinet, nga një skaj i një zyre del një deklaratë se kjo nuk është legale. Kjo është shumë keq.

E para, për të reaguar, për të treguar se sa të ndjeshëm jemi në pasuritë tona dhe, e dyta, për të dërguar mesazh tek ata investitorë, të cilët kanë interesime për "Trepçën", që kjo nuk është e vërtetë dhe duhet t'ua themi ne, e jo ata të shkojnë e të hulumtojnë dhe të bëjnë hetime se çfarë ka ndodhur në Beograd, e pastaj të vijnë e të na tregojnë neve. Prandaj, unë po e ngre edhe një herë këtë shqetësim. Kemi pasur të drejtë kur kemi

debatuar, kur kemi treguar se çfarë dëmi po i bëhet “Trepçës”, kur kemi kërkuar që të bëhet një ligj i veçantë për “Trepçën” dhe po presim këto ditë, me kthimin e Kryeministrit, që të sqarojë se a është në pyetje Brukseli, apo është thjesht një veprim ilegal që është bërë në Beograd, dhe unë besoj që atëherë do të thërrasim në veprimin që duhet ta bëjë edhe Parlamenti, nëse jo ministria përkatëse, nëse jo AKP-ja, nëse jo Dhoma e Veçantë. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka nënkryetari, Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Qeveria e Kosovës e ka fituar një varësi shqetësuese dhe serioze nga negociatat me Serbinë. Negociatat nuk kanë të ndalur dhe tash pas arritjes së marrëveshjes politike po vazhdojnë negociatat për zbatimin e saj. Në fillim, zyrtarët qeveritarë na patën thënë se ky proces do të përfundojë me njohjen që do të na e bëjë Serbia, kurse në të vërtetë ky proces përfundoi me njohjen që Qeveria jonë ia bëri autonomisë serbe në veri.

Në fillim, këta qeveritarë na thanë se Serbia po ndryshon dhe kështu një ditë do ta ndryshojë edhe Kushtetutën e saj. Tash po na thonë se u dashka ne ta ndryshojmë Kushtetutën dhe ligjet tona për t’iu përshtatur Serbisë. Pra, Serbia, që është përgjegjëse për shumicën e viktimave të luftërave në ish-Jugosllavi, me 30 000 apo 40 000 kriminelë lufte, disa prej të cilëve mund të punojnë nëpër institucionet e sigurisë, nuk paska nevojë ta ndryshojë kushtetutën, por Kosova paska nevojë ta ndryshojë Kushtetutën, që ishte viktimitë, në këtë rast e interesave të Serbisë.

Zonja dhe zotërinj,

Nuk ka fatkeqësi më të madhe për një shtet dhe për një popull se sa të ketë kësi zyrtarësh politikë. Këta qeveritarë, në vend që të punojnë për interesat tona shtetërore drejt ndryshimit të Serbisë, këta po e modelojnë shtetin tonë sipas kërkesave të Serbisë. Nëse po u dashka të ndryshohet Kushtetuta, atëherë zonja e zotërinj, pse Kushtetuta nuk ndryshon aty ku i konvenon, për shembull, kombit shqiptar dhe Shqipërisë? Për shembull, pse nuk po e ndryshojnë pikën 1.3 të Kushtetutës, që na e ndalon bashkimin me Shqipërinë, por po u dashka ndryshuar Kushtetuta vetëm aty ku i konvenon Serbisë.

Në vend që Kushtetuta jonë të ndryshojë për të mirën e kombit, ajo po ndryshon për të keq, për ta dobësuar Republikën edhe më shumë, si dhe për t’i akomoduar tutje aspiratat e Serbisë. Ku ka politikanë në botë që garojnë se cili më shpejt po i ndryshon ligjet e veta për t’iu përshtatur një shteti armik, siç është për ne Serbia? Ky është një turp i madh që nuk e lan bash asgjë dhe Kosova do të pavarësohet vërtet nga Serbia vetëm atëherë kur ne si shtet shkëputemi plotësisht nga Qeveria e Hashim Thaçit.

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: I nderuar kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Dola sot këtu për të shprehur për të satën herë një shqetësim të vendit tonë, të njerëzve tanë, të atyre që vërtet kanë nevojë për një përkrahje më zëmadhe institucionale nga Kosova dhe që nuk po arrijnë ta kenë atë. Është fjala për Kosovën Lindore, për bashkëkombësit tanë, të cilët jetojnë në një terror dhe në një gjenocid, i cili në vazhdimësi është nga të gjitha pushtetet që janë ndërruar në Serbi, dhe asnjë veprim nga Kosova në përkrahje të drejtpërdrejtë të tyre, përveç disa takimeve kurtuazie të nivelit institucional.

Në vend se t'u lehtësohet jeta banorëve të Preshevës, Medvegjës e Bujanocit, atyre u është vështirësuar pikërisht nga Qeveria e Kosovës, e institucioneve të Kosovës, duke i ngarkuar me taksa për 20 euro në javë dhe duke mos e pasur fare parasysh pozitën e tyre ekonomike dhe sociale, në të cilën ata jetojnë.

Territori i Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit edhe tani është militarizuar në mënyrë enorme. Brezi kufitar i kësaj malësie është i shpërngulur, ndërsa në Medvegjë tani jeton vetëm një numër simbolik i shqiptarëve. Ata janë tani në një izolim të plotë dhe ne, në vend që t'i përkrahim si Qeveria e Kosovës me fonde, kërkesa për hapjen e një zyre që do të komunikonte drejtpërdrejt me qytetarët atje, me institucionet e atjeshme që udhëhiqen nga popullata e atjeshme, përkundrazi është bërë vesh i shurdhër dhe askush nuk e dëgjon zërin e tyre. Asnjë zë nuk është dëgjuar, asnjë përkrahje për grupin që është dënuar në Beograd e që quhet 'Grupi i Gjilanit', sepse ata dënohen për territorin e Kosovës dhe asnjë lëvizje, së paku për t'u përkujdesur, për të parë drejtësinë sa është ajo, as nga faktori vendor, e as ai ndërkombëtar.

Ndërsa, kur është në pyetje një përcjellje e...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Dhe i fundit për sot, Halit Krasniqi e ka fjalën.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Parlamentit të Kosovës,

Një koncept i pavërtetë për të kaluarën dhe shumë i dëmshëm në perspektivë, më ka provokuar për fjalën time tani.

Deklarata të ministrave, edhe në të kaluarën ka pasur të atilla, të cilat nuk janë artikuluar në nivelin e autoritetit të tyre, as në performansën e tyre në publik, as në përmasa të subjektit nga janë katapultuar në ndonjë rast në baza të kriterëve të diskutueshme, por asnjëherë të kundërshtueshme nga asnjë nivel i adresës së tyre deleguese, edhe në rastet kur kanë pasur moshë aq sa bashkëpartiakët e shumtë, të cilët kanë pasur përkushtim permanent dhe përfaqësim të përgjegjshëm të konceptit për ndryshim të gjendjes dhe të emancipimit të shoqërisë.

Deklarata e fundit, duke prezantuar vizionin e institucionit të Republikës së Kosovës dhe të shoqërisë sonë, përkitazi me konceptin e shteteve të mëdha nuk të lë indiferent, sepse edhe indiferentit ia lëndon observimin intuitiv.

Çdo njeri nga figurat qeveritare, duke qenë me përgatitje universitare, do të duhej t'i dinte dhe t'i njihje konceptet e shteteve me pretendime dhe veprime shoviniste, për t'u shtrirë bri territorit, popujve, identiteteve dhe shteteve tjera, duke e sendërtuar konceptin shtetmadh.

Prej se është krijuar historia e shteteve dhe prej se ekziston koncepti komb, asnjë fakt historik nuk mund të gjendet që shteti i shqiptarëve, çfarëdo sistemi politik apo juridik, kombi shqiptar si tërësi në këtë nuk ka pretenduar apo të ketë vepruar për të pushtuar territore të shteteve apo për të robëruar popuj të tjerë. Këtë edhe nuk ka mundur ta bëjë, sepse gjithnjë prej filleve të këtyre koncepteve shtet dhe komb, në periudha të caktuara, fqinjët tanë herë në aleancë, herë të vetëm, kanë synuar e kanë pushtuar territore në vazhdimësi, duke e tkurrur gjeografinë tonë, e duke e robëruar popullin tonë.

Në historinë e përpjekjeve të popullit shqiptar, asnjë projekt kombëtar i shqiptarëve nuk gjendet, jo vetëm në pushtimin e territoreve për të cenuar shtete tjera, madje në ato projekte çlirimtare nuk kanë ideuar as për t'u kthyer në gjendjen parapushtuese, sepse është bërë eksod i tokës së djegur në masa të mëdha gjatë pushtimeve, të cilat kanë mbetur mallkim i kohëve.

Ngaqë nuk ka pasur projekte të tilla për ta krijuar shtetin e madh shqiptar, pse tani dëgjohet ky koncept i përçudshëm dhe aspak nuk mund të mendoja nga një integritet, i cili në tërësi të plotë të personalitetit rrezaton në aparençë cilësi imponante për përfaqësim të intelektit tonë, për përfaqësim të emancipimit tonë të përgjithshëm aktualisht.

Sa herë të flitet për Serbinë e Madhe, derisa ika brenda Luginën e Preshevës, Sanxhakun e Vojvodinën, çdo referues i këtij togfjalëshi është brenda realitetit aktual dhe historik.

KRYETARI: Sa u përket deklarimeve jashtë rendit të ditës nga deputetët, ato kanë përfunduar me fjalën e deputetit Krasniqi. Tani është radha për Qeverinë.

Fjalën e ka ministri i Punëve të Jashtme, zoti Hoxhaj.

ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryetar!

Shumë i nderuar, zoti kryetar,

Të nderuar dhe të respektuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Zëvendëskryeministra dhe ministra,

Më lejoni që me reagimin tim në pjesën e parë të marr qëndrim në emër të Qeverisë sa u takon disa shqetësimeve që u ngritën për “Trepçën” edhe nga deputeti i LDK-së, Ferati, dhe nga deputeti i “Vetëvendosjes”, zoti Ymeri.

Më lejoni të ju informoj që ne si Qeveri e Kosovës, kryeministri personalisht, por edhe unë, kemi qenë në kontakt nga momenti që është botuar lajmi për gjoja një kontratë të nënshkruar në Beograd ndërmjet Qeverisë së Beogradit dhe një kompanie amerikane.

Më lejoni të ju informoj, po ashtu, se e kam obligim që të jem transparent ndaj këtij Kuvendi, që edhe në të kaluarën ka pasur tendenca, jo vetëm nga kompani amerikane, por edhe nga kompani të disa shteteve tjera, gjoja të nënshkruajnë kontratë në Beograd, dhe qëndrimi ynë ka qenë i prerë dhe shpeshherë në takimet tona është dashur të jemi jo vetëm diplomatikë, por brutalë, që t'u sqarojmë që askush nuk mund të nënshkruajë kontratë me Qeverinë e Serbisë sa i takon kompleksit të minierës së "Trepçës". Dhe, unë po flas për raste konkrete gjatë këtyre dy vjetëve të fundit.

Po ashtu, dua të ju informoj që kemi qenë në kontakt edhe me Departamentin e Shtetit dhe Ambasada amerikane në Prishtinë ka qenë në kontakt me Departamentin e Shtetit dhe mendoj që pas deklaratës që ka bërë Ambasada amerikane në Prishtinë, ku në mënyrë recidive thuhet që ata kanë qenë të prerë dhe e kanë këshilluar këtë kompani që të mos e bëjë një hap të tillë, se Qeveria e Serbisë nuk ka juridiksion mbi kompleksin e minierave të "Trepçës", mendoj se kjo çështje është sqaruar njëherë e përgjithmonë.

Ndërsa, unë dua të ju informoj që për ne, si Qeveri e Kosovës, një kontratë e tillë është e kundërligjshme, e paligjshme, e pavlerë, pa ndonjë efekt, dhe nëse ka nevojë do të ndërmarrim masa juridike, me të gjitha mjetet juridike, në të gjitha gjykatat ndërkombëtare, vetëm e vetëm që kjo pasuri e shtetit të mbrohet dhe mendoj që kjo çështje nuk duhet të jetë dilemë, mbi të gjitha për këtë Kuvend të Kosovës.

Sa i takon reagimit të dytë, unë e falënderoj deputetin për shqetësimet që i ngrehu. Më lejoni të ju informoj që ministri i Punëve të Jashtme komunikon me disa audienca, e jo vetëm me audiencën e Kosovës, por komunikon me dy-tri audienca dhe çdo komunikim imi, çdo intervistë imja, çdo fjalim imi është goxha i kujdesshëm.

Së dyti, çfarë bën ministri i Punëve të Jashtme është zgjatje, zgjerim i politikës së brendshme. Politika e jashtme është zgjatje e zgjerim i politikës së brendshme. Ju e keni shumë të qartë nenin 1.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku thuhet që Republika e Kosovës nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë shteti dhe Republika e Kosovës nuk synon të bashkohet me asnjë shtet.

Dhe unë, personalisht, jo vetëm për këtë nen, çfarë shkruan në Kushtetutë, besoj fuqishëm se Republika e Kosovës do të jetë përherë shtet dhe ky Kuvend e ky Parlament do të jetë përherë Kuvend i shtetit të pavarur të Republikës së Kosovës. Prandaj, këto qëndrime komunikohen edhe në arenën ndërkombëtare.

KRYETARI: Ministër, nuk e kam nënkryetarin që të dal në foltore, por unë do t'i them dy-tri fjalë.

Një e vërtetë e madhe është që "Trepça" nuk është unike. Janë dy drejtorë atje. Puna e parë që duhet të bëhet, "Trepça" duhet të bëhet një.

Tjetër, edhe dorëheqjet që kanë ndodhur në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, po e them titullin në origjinal, edhe pse nuk është shqip, janë lidhur jo me proceset e parregullta të privatizimit që kanë ndodhur në Kosovë, por me atë që duhet të privatizohet. Edhe kjo është shqetësuese për çdo qytetar që i dhimbset pasuria kombëtare.

Prandaj, kjo që ka ndodhur me atë marrëveshje është një sinjal që duhet të na japë ne si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës që kemi ardhur këtu, që të mendojmë më kthjellët dhe secilit dhe çdokujt t'ia bëjmë të qartë se “Trepça” nuk mund të privatizohet pa vendosur së paku 2/3-at e përfaqësuesve të zgjedhur të qytetarëve të Kosovës dhe se çdo formë tjetër e privatizimit do të jetë në vazhdim të kriminalizimit të jetës politike në Kosovë.

Dhe, mendoj që kjo duhet të diskutohet dhe duhet të merret vendim dhe praktika e faljes së pasurisë publike dhe kombëtare në Kosovë duhet të ndërpritet njëherë e mirë. Përndryshe, ne e marrim përgjegjësinë edhe për të sotmen, edhe për të ardhmen e këtij vendi. Deklaratat, vërtet, edhe këto që u thanë sot, edhe kjo imja, mbeten vetëm deklarata nëse nuk merren vendime, që duhet t'i marrë ky Kuvend, për çka edhe është i thirrur. Nëse një institucion në Kosovë ka obligim të marrë vendime në interes të këtij vendi, pa u marrë me historinë, por me të ardhmen e këtij vendi, unë mendoj që ne nuk e kryejmë detyrën tonë kushtetuese që e kemi.

Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Kymete Bytyçi, pyetje për ministrin Dardan Gashi. Ministri nuk është këtu. Do ta parashtrosh pyetjen, deputete? Nuk është as deputetja.

Deputetja Albanë Fetoshi, pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi. Kryeministri nuk është këtu. Deputete, doni ta bëni pyetjen?

ALBANA FETOSHI: Jo, edhe ashtu i ka kaluar aktualiteti.

KRYETARI: Deputeti Afrim Kasolli, pyetje për ministrin Ramë Buja. Ministrin e kemi këtu. Deputet, sot je i privilegjuar.

AFRIM KASOLLI: Faleminderit, kryetar!

Mbi njëqind studentë të Institutit për Gazetari dhe Komunikim të Kosovës KIJAC, që ka funksionuar për pesë vjet në Kosovë, janë sot pa përgjigje në lidhje me faktin që u zbulua më vonë se institucioni arsimor në fjalë nuk ka qenë as i regjistruar, e as i akredituar. Edhe pse ka qenë themeluar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, atëbotë drejtuar nga Agim Veliu, këta studentë edhe sot nuk janë të akredituar, nuk janë pranuar dhe dorëzuar diplomat nga Ministria e Arsimit.

Në mesin e këtyre studentëve ka edhe ministre nga ky Kabinet qeveritar, sikur zonja Çitaku, e cila mund të ju ofrojë edhe më shumë të dhëna në këtë drejtim. Po ashtu, një

nga këshilltarët e kryeministrit, zoti Dukagjin Gorani, ka qenë po ashtu drejtues në këtë institucion arsimor, nëse sërish do të ju nevojiteshin më shumë të dhëna.

Prandaj, pyetja është me vendim të firmosur nga ju, sipas një baze ligjore të mjegullt, e cila mban datën 27 prill 2012, kur ju saktësoni se do të ju njihen diplomat dhe dokumentet tjera studentëve të KIJAC-it. Atëherë, deri ku ka mbërritur ky proces?

Nëse ky institucion nuk ka qenë i akredituar dhe i regjistruar, mbi çfarë bazoheni se cilët janë vërtetë studentët apo ish-studentët e institutit dhe a e keni dërguar këtë rast në organet e drejtësisë, meqë ky rast përbën, sipas të gjitha gjasave, një krim ekonomik?

Secili student ka paguar të paktën 1 mijë euro për një vit dhe ende janë të padiplomuar. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Ministër, e keni fjalën.

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Kolegë ministra,

Zëvendëskryeministra,

I nderuar deputet Kasolli, faleminderit shumë për pyetjen e bërë!

Instituti për Gazetari dhe Komunikim i Kosovës, i njohur me shkurtesën KIJAC, është krijuar më 5 shtator 2005 me memorandum mirëkuptimi, të nënshkruar nga ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në atë kohë Agim Veliu, siç e thatë edhe ju, përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, Soren Jessen Peterssen, dhe presidenti i shkollës “Gimle Kollen”, të Gazetarisë dhe Komunikimit nga Norvegjia, doktor Hans Age Gravas.

Sipas memorandumit me zhvillimin e programeve dhe mbajtjes së mësimin, si dhe bartjen e praktikave të mira në këtë fushë, është përfshirë edhe shkolla e gazetarisë “Kardif” nga Mbretëria e Bashkuar. Në bazë të këtij memorandum, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë në vitin 2005 kishte marrë obligim për t’i udhëhequr procedurat e licencimit, procedurë që nuk është përmbytur.

Bazuar në obligimin e dalë nga memorandum në fjalë, unë si ministër në vitin 2012 kam marrë vendim për njohjen e këtyre diplomave, vendimi numër 220/01, datë 27.4.2012. Vendimi është marrë në mbështetje të nenit 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, që është pasqyruar në Gazetën Zyrtare nr. 82 të datës 21 tetor 2010, nenit 16 të Ligjit të arsimit të lartë, që është pasqyruar në Gazetën Zyrtare nr. 14 të datës 9 shtator 2011, nenit 8, paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores numër 02/2011 për fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe të ministrave, që është e datës 22.3.2011 dhe të Udhëzimit Administrativ numër 3/2010,

të datës 16.4.2010, si dhe duke u bazuar në memorandumun e mirëkuptimit, të datës 5.9.2005.

Po ashtu, ne jemi në kontakt të rregullt me Ambasadën e Mbretërisë së Norvegjisë për sjelljen e të dhënave të studentëve nga shkolla “Gimle Kollen”, në serverin e së cilës njëkohësisht janë mbajtur të dhënat elektronike të detajuara për secilin program që është zhvilluar atje dhe të dhënat e të gjithë studentëve.

Me qëllim që asnjë student të mos dëmtohet, procedura e vërtetimit ose vulosjes së diplomave do të kryhet vetëm kur të kemi ta kompletuar dosjen e regjistrimit të studentëve, të vijueshmërisë dhe të provimeve të kryera. Ne po e presim këto dosje të kompletuara dhe pastaj ta bëjmë hapin që na takon si Ministri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kasolli, keni pyetje shtesë?

AFRIM KASOLLI: Faleminderit!

Ministër, ju thatë se jeni duke pritur dosjen, para se të merrni vendime. Çështja është shumë e thjeshtë: Si mund t’i njihni disa diploma të një institucioni, i cili nuk është i akredituar?

Kjo konsiderohet shkelje e ligjit, sepse, në fund të fundit, institucioni kompetent për t’i njohur këto diploma dhe për ta njohur atë institucion është Agjencia e Akreditimit. Ministria, me sa e di unë, nuk mund të bëjë asgjë në këtë drejtim. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, urdhëroni!

MINISTRI RAMË BUJA: I nderuar deputet!

Gjithë kjo, edhe procedura e atij vendimi domethënë është në konsultim me Agjencinë e Akreditimit dhe gjithsesi vendimet, vulosjet dhe të gjitha ato do të merren duke u konsultuar me atë, sepse nuk mund të bëhet ndryshe.

Ndërsa procedurat tjera janë në rrjedhë e sipër, dhe unë besoj se kjo nuk do të zgjasë shumë. Do të marrim përgjigjen, sepse gjithmonë thonë që të dhënat janë të saktësuara në këtë institucion dhe do të na i sjellin së shpejti.

Ndërsa, mundësia për plotësimin e të dhënave nëse ka nevojë, janë edhe sqarimet nga Udhëzimi Administrativ ku kërkohen dokumentet plotësuese pastaj për ato provime, kur janë dhënë notat dhe procedurat tjera, regjistrimi i semestrit, kur është bërë, e kur është përfunduar dhe tjera, kështu që besoj se gjithçka do të shkojë konform normativave që i kemi përcaktuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Albana Gashi, pyetje për zëvendëskryeministren Edita Tahiri. Zonja deputete, e keni fjalën.

ALBANA GASHI: Faleminderit, kryesues!

Që në fillim të vitit 2011, kur zonja Tahiri i filloi rundet e takimeve me Borisav Stefanoviqin në Bruksel, nën lehtësimin e Robert Kuper, u deklarua publikisht dhe u mor zotim nga Qeveria dhe kryeministri se këto bisedime teknike do të sillnin rezultate për çështjen e të pagjeturve, të rrëmbyer e të vrarë prej shtetit serb.

Po ashtu, edhe kryeministri Thaçi deklaroi para takimit të parë me Daçiqin dhe gjatë takimeve tjera se do të flitej dhe se e kishin prioritet këtë çështje. Deri tani, as familjarët, as ne këtu në Kuvend, as opinioni publik, madje as familjarët nuk kanë parë asnjë rezultat.

Prandaj, pyetja është: Zonja zëvendëskryeministre, çfarë keni bërë dhe çfarë informatash të reja keni rreth çështjes së Ukshin Hotit?

KRYESUESI: Zonja zëvendëskryeministre, e keni fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: I nderuar kryesues, Deputetë të nderuar, Kabinet qeveritar, E nderuar deputete Gashi, Kjo pyetje nuk më ka ardhur për këtë radhë, megjithatë unë do të ju jap përgjigje. Ka qenë për radhën tjetër, kur unë nuk kam qenë këtu.

Megjithatë, përgjigja është si në vijim: Çështja e të pagjeturve është hapur si çështje në dialogun teknik, të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian, dhe për këtë çështje është mbajtur vetëm një takim, në të cilin ne e kemi paraqitur platformën tonë dhe kërkesat tona konkrete për ta zgjidhur përfundimisht çështjen e të pagjeturve dhe, siç e dini, theksojnë ka qenë që kjo çështje të ndërkombëtarizohet më tej dhe kërkojmë nga Bashkimi Evropian që ta marrë një rol më aktiv në këtë çështje.

Edhe në platformën e dialogut për normalizim, ne kërkesën e kemi të qartë: kërkojmë që Bashkimi Evropian të caktojë një emisar special, i cili do të merrej me këtë çështje deri në zbardhjen përfundimtare të të gjitha rasteve, pra të të pagjeturve.

Ndërsa, sa i takon rastit të intelektualit dhe patriotit të madh zotit Ukshin Hoti, unë në atë takim kam kërkuar posaçërisht ndriçimin e rastit të tij, si një rast i veçantë, me peshë nacionale të veçantë për vendin tonë. Natyrisht, dua të them se ka edhe shumë figura tjera që janë në kuadrin e të pagjeturve, por rasti i Ukshin Hotit është krejt i veçantë.

Po ashtu, dua të ju them se para se ta formulojmë platformën, unë jam takuar me të gjitha shoqatat që kanë të bëjnë me të pagjeturit, si dhe me njerëz të familjes së Ukshin Hotit. Jam takuar me vajzën e tij, Erleta Hoti, me motrën dhe me dhëndrin, që është kryetar i Shoqatës së të Pagjeturve.

Dhe, e fundit, ju e dini që e kemi pasur një interpelancë këtu pikërisht për të pagjeturit, ku unë kam folur gjerësisht për këtë çështje.

Në fund, dua të ju them se në dialogun për normalizim në fazat e ardhshme kjo çështje do të shtrohet nga ne dhe theksi ynë është që BE-ja ta përcaktojë një emisar special që do të merret me këtë çështje.

Arsyeja pse e kërkojmë është sepse një dialog që zhvillohet ndërmjet komisioneve shtetërore të të dy shteteve - të Kosovës dhe Serbisë, nuk ka arritur ta zgjidhë përfundimisht këtë çështje dhe në këtë, siç e dini, ndihmon Kryqi i Kuq Ndërkombëtar, por ende është një numër i rasteve - rreth 1 800 të pazbardhura. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Gashi?

ALBANA GASHI: Po, zoti kryesues! Faleminderit!

Zonja kryeministre, në këtë që sapo e thatë, nuk ka asgjë të re. Çështjen e të pagjeturve, në përgjithësi, dhe çështjen e Ukshin Hotit ju e keni përdorur sa herë që keni shkuar në negociata.

Çështjen e të pagjeturve ju e keni përdorur vetëm sa për t'i legjitimuar këto negociata dhe për t'i bërë kinse të domosdoshme dhe sikur gjoja po merreni me çështje të ndjeshme, siç është pra rasti i të pagjeturve.

Por, zonja zëvendëskryeministre, Ukshin Hoti, si veprimtar dhe qytetar i Kosovës, e ju jeni përfaqësuese e kësaj Qeverie, na thoni konkretisht çka keni bërë ju në rastin e tij, jo këtë që na e keni thënë në interpelancë, na e keni thënë në komision dhe të njëjtat fjalë na i thatë edhe sot.

Çfarë konkretisht keni bërë? Faleminderit!

KRYESUESI: Zonja zëvendëskryeministre Tahiri, e keni fjalën!

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Fillimisht, një korrigjim! Unë jam zëvendëskryeministre, e nuk jam kryeministre. E dyta, më lejoni të ju them se grupi juaj, pra i "Vetëvendosjes", ka kërkuar anulimin e dialogut teknik në përgjithësi, si dhe ka kërkuar që çështja e të pagjeturve të mos jetë në dialogun teknik.

Tani, për mua është një kontradiktë. Nëse ju keni qenë kundër këtij procesi dhe kërkonit rezultate nga ky proces, tregon se konceptualisht mënyra ju si mendoni të zgjidhet kjo çështje është në kontradiksion.

Megjithatë, ka qenë mirë që Kuvendi me shumicë ka votuar pro vazhdimit të dialogut teknik dhe pro vazhdimit që çështja e të pagjeturve të jetë temë dhe unë mund të ju them se në të ardhmen, si qëndrim dhe platformë qeveritare, e kemi që në kuadër të dialogut për normalizim të shtrohet dhe të gjejë zgjidhje edhe kjo çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Bytyçi, pyetje për ministrin Ferid Agani. Deputetja nuk është e pranishme. Ministri qenka këtu, por deputetja nuk është.

Zoti nënkryetar Konjufca, pyetje për ministrin Fadil Ismajli. Nuk është i pranishëm. Shpejt e paskeni bërë pyetjen! Doni ta lexoni pyetjen? Atëherë, zoti Konjufca e ka fjalën.

GLAUK KONJUFCA: Jo, veç desha të them nënkryetar që unë nuk e kam bërë shpejt pyetjen, por Qeveria është vonuar në emërimin e tij.

KRYESUESI: Zonja Fetoshi, pyetje për ministrin Hoxhaj.

ALBANA FETOSHI: Faleminderit, kryesues!

Sa i përket pyetjes që e kam parashtruar për ministrin Hoxhaj, unë jam informuar në mënyrë të detajuar në Komisionin për Buxhet e Financa, kështu që mendoj që nuk ka nevojë të përsëritet edhe një herë, prandaj e tërheq pyetjen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Aliu, pyetje për ministrin Çeku. Ministri nuk është këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen? Atëherë, kur të jetë ministri, dëshiron ta bëjë pyetjen.

Zonja Albulena Haxhiu, pyetje për zëvendëskryeministrin Hajredin Kuçi. Zëvendëskryeministri nuk është i pranishëm.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe pse ministri nuk është këtu, unë po e parashtroj pyetjen.

Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, zoti Enver Peci, në një deklaram publik, në lidhje me Njësine e Veçantë të Gjykatës së Apelit në veri, tha se duhet të sqarohet ende për shkak se flitet edhe për një Divizion të Apelit të kësaj gjykate.

Ai, gjithashtu, tha se me Ligjin e gjykatave është paraparë vetëm një gjykatë e apelit në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit për gjykata, Gjykata e Apelit përbëhet nga gjithsej 5 departamente, përkatësisht Departamenti i Përgjithshëm për Krime të Rënda, Departamenti për Çështje Ekonomike, Departamenti për Çështje Administrative dhe Departamenti për të Mitur.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës ende nuk e di se si do të rregullohet çështja e mungesës së bazës ligjore që të ekzistojë një divizion i apelit. Se si do të sistemohet ai panel, do të rregullohet më tutje me marrëveshje dhe implementim të marrëveshjes, që është në proces e sipër.

Ne jemi duke e shikuar mundësinë se si do të inkorporohet ai panel, apo si do të veprojë në kuadër të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, tha zoti Peci.

Divizioni i Gjykatës së Apelit, i paraparë me marrëveshje, do të gjykojë vetëm rastet gjyqësore në komunat me shumicë serbe. Meqë në seancën e kaluar, ministri tha që me vete në delegacion e kishte kryetarin e Këshillit Gjyqësor dhe atij Prokurorial, tashmë po del se kryesuesi i Këshillit Gjyqësor ka shprehur shqetësime, që po i ngremë edhe ne.

Andaj, pyetja për ministrin është: A e shkel pika 10 e marrëveshjes Ligjin për gjykatat dhe a e cenon sistemin tonë të drejtësisë?

Por, ai do të duhej të ishte këtu edhe që të na shpjegonte se a parashihet në planin e zbatimit të marrëveshjes edhe miratimi i Ligjit për amnisti? Pra, amnistimi i kriminelëve serbë në veri, pasi kështu shkruante para dy ditësh gazeta “Tribuna”. Mirëpo, unë do ta pres përgjigjen në seancën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Hoti, pyetje për ministrin Bajram Rexhepi. Ministri nuk është këtu. Dëshironi ta bëni pyetjen?

AFRIM HOTI: Po, do ta parashitroj! Gjatë fundvitit 2012 dhe muajve të parë të vitit 2013 ishim dëshmitarë të aferës korruptive të pasaportave biometrike dhe 1,4 milion eurove të humbura. Aktualisht, gati gjysmë viti më pas nuk ka asnjë hap apo veprim konkret nga Ministria e Punëve të Brendshme në lidhje me këtë rast.

Disa zyrtarë rreth e përqark ministrit, u pezulluan, disa edhe u larguan, por se ku mbetën paratë e Buxhetit të Shtetit dhe se ku u gjetën paratë për tenderin e ri, ende askush nuk ka dhënë përgjigje.

Ministër, ku janë 1,4 milion euro? Cili është përgjegjësi për aferën e pasaportave biometrike? Pres përgjigje javën e ardhshme nga ministri. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ymeri, pyetje për zëvendëskryeministren Edita Tahiri. Zoti Ymeri, e keni fjalën!

VISAR YMERI: Faleminderit, nënkryetar!

Para se me të hyj te çështja dhe pyetja, vetëm desha t’i përmend disa gjëra që i trajtoi tashmë zëvendëskryeministrja në përgjigjen e saj. Tha që Lëvizja “Vetëvendosje” nuk qenka konsistente për shkak se në njërën anë po i refuzon negociatat, po i kundërshton ato, ndërkohë në anën tjetër po pret rezultate prej tyre.

Zonja zëvendëskryeministre, kjo çështje është shumë e thjeshtë. Ne kemi thënë që çështja e të pagjeturve duhet të jetë ndër ato dhjetë çështjet me të cilat do të kushtëzohet Serbia para se të nisin negociatat. Pra, që kjo të zgjidhet para se të nisen, e jo të negociohet për to, për shkak se kjo nuk është çështje pazari. Por, nuk ka kurrëgjë jokonsistente këtu, për shkak se meqenëse po shkon atje, ne po ju pyesim çfarë keni bërë.

E meqenëse ju po i arsyetoni këto negociata, përkundër interesit të Kosovës, edhe me çështjen e të pagjeturve, atëherë çfarë keni bërë për këtë?

Pra, nuk është këtu punë e moskonsistencës së Lëvizjes “Vetëvendosje”. Në fakt, në rastin më të keq ndoshta, ose në rastin më të mirë, ta quajmë qysh duash, kjo është pamundësi ose paafësi jotja për ta kuptuar këtë konsistencë.

Dhe mendoj që edhe në këtë ne mund të ju ndihmojmë po që se je e interesuar dhe brenda Lëvizjes “Vetëvendosje” ne e organizojmë një shkollë për aktivistët tanë, ku i diskutojmë gjërat e ndryshme, dhe po që se je e interesuar, ne mund të ta japim atë ligjëratë edhe ty. Pra, që ta kesh aftësinë ta kuptosh këtë konsistencë.

E tash, po flas për çështjen. Në një komunikatë, të lëshuar nga Qeveria e Kosovës, më 18 maj 2013, midis tjerash, thuhet edhe kjo: Duke folur për përparimet konkrete, zëvendëskryeministrja Edita Tahiri bëri të ditur se në fushën e telekomit, përparimi kryesor është se Serbia është pajtuar që Kosova ta ketë kodin telefonik shtetëror, pra është pajtuar që t’i heqë pengesat që ia ka krijuar Kosovës deri më tash. Me këtë pajtim hapet rruga që ITU-ja t’ia ndajë Kosovës kodin shtetëror që i ka takuar edhe kur ka qenë njësi federale e Jugosllavisë. Andaj presim që kodi 383 ose 384 t’i jepet Kosovës së shpejti”, tha zonja Tahiri. Kështu përfundon ky paragraf i komunikatës.

Pyetja ime është kështu: Çfarë do të thotë së shpejti? Pra, cila është data apo muaji, duke qenë se humbja e mospasja e kodit janë marramendëse dhe shtohen për çdo ditë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zonja zëvendëskryeministre Tahiri, e keni fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDIDTA TAHIRI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryesues i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Deputetë të nderuar,

I nderuar deputet Ymeri,

Çështjet e Telekomit kanë qenë pjesë e bisedimeve në dialogun teknik që nga prilli i vitit 2011, mirëpo deri më tash, siç e dini, nuk ka pasur marrëveshje. Në takimin e mbajtur në Bruksel, më 17 maj 2013, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, janë shënuar disa përparime. Përparimi kryesor është se Serbia është pajtuar me realitetin që Kosova si shtet ka të drejtën për ta pasur kodin e saj shtetëror telefonik. Serbia pra është pajtuar që mos t’i krijojë pengesa Kosovës në marrjen e kodit telefonik nga ana e ITU-së, përkatësisht Organizata Ndërkombëtare për Telekomunikacion.

Me këtë pajtim, hapet rruga që ai ITU-ja t’ia ndajë Kosovës kodin ndërkombëtar telefonik dhe presim që ky kod do të jetë 383, ose 384. Në fakt, kodi telefonik shtetëror i ka takuar Kosovës qysh në kohën kur Kosova ka qenë njëra nga 8 njësitë federale të ish-Jugosllavisë, dhe në atë kohë ITU-ja kishte ndarë për Kosovën dhe njësitë tjera federale kodin telefonik dhe brezin frekuencor. Po ashtu, në përkrahje të këtij procesi, Bashkimi Evropian ka premtuar se do të angazhohet që ta përkrahë Kosovën në procesin e marrjes së kodit shtetëror telefonik nga ITU.

Sa i takon kohës se kur do të ndodhë kjo, unë nuk mund të flas me datë, sepse kemi të bëjmë me procedurat e aplikimit dhe vendimet e ITU-së, por ajo që mund të them është se në një të ardhme të afërt, Kosova do të bëhet me kodin e saj telefonik, pas gati 14 vjetësh përpjekjesh për këtë çështje.

Dhe, në fund, dua të ju falënderoj që ma hapët rrugën për bashkëpunim ndërmjet “Vetëvendosjes” dhe Qeverisë. Ne ju kemi hapur rrugën si Qeveri shumë më herët. Ju kemi ftuar të jeni pjesë e ekipit për negociata në të dyja raste dhe në dialogun teknik, edhe në atë për normalizim. Pra, vlen ftesa që të bëheni pjesë e ekipit të dialogut dhe pastaj do të jeni në rrjedha komplet për këto çështje. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Ymeri, keni fjalën për pyetje shtesë!

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Në fakt, prapë u keqkuptova nga zëvendëskryeministrja. Unë nuk ju bëra ofertë për bashkëpunim ndërmjet “Vetëvendosjes” dhe Qeverisë, por të bëra ofertë ty personalisht po që se do t’i ndjekësh ligjëratat për ta kuptuar konsistencën e “Vetëvendosje”, nëse nuk je e interesuar dakord. Nuk ka kurrgjë problem, por pyetja ime është kështu: Çka keni ofruar ju si pjesë e marrëveshjes për kodin, se kësaj pyetjeje nuk u përgjigje. Kjo ishte pjesa e dytë e pyetjes. Apo thjesht, Serbia vetëm tash ka rënë në dakord, pas 14 vjetësh pengesa? Në një moment u bind që në fakt Kosova paska të drejtë, apo i është ofruar diçka nga Kosova dhe çka është ajo diçka? Cila është marrëveshja për telekomunikacionin për shkak se negociatat për telekomunikacionin nuk kanë pasur të bëjnë vetëm me kodin, por edhe me ndërhyrjet e Serbisë brenda territorit të Kosovës me operatorët e vet ilegalë.

KRYESUESI: Zonja zëvendëskryeministre, e keni fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA EDITA TAHIRI: Platforma e Qeverisë së Republikës së Kosovës në të dy dialogët, edhe teknik, edhe të normalizimit, bazohet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në ligjet e vendit tonë dhe në Rezolutën e Kuvendit të Kosovës. Ajo që ne kemi premtuar është zhbërja e të gjitha strukturave paralele, përfshirë fushën e Telekomit, ku ka operator ilegalë që veprojnë për një kohë të gjatë, qoftë në telefoninë mobile, qoftë fikse, nga Serbia, dhe mund të ju them se kemi treguar gatishmëri për të vendosur bashkëpunim ndërshtetëror ndërmjet dy shteteve, në bazë të parimeve evropiane. Ndërmjet tjerash, kemi kërkuar që të bëjmë marrëveshje për romingun, për ta rritur cilësinë dhe për t’i ulur çmimet e shërbimeve telefonike, si dhe kemi ofruar një marrëveshje interkonjeksioni, e cila po ashtu ka të bëjë me një bashkëpunim rajonal dhe rritjen e cilësisë në fushën e Telekokmit.

E fundit, me digresion, për kurset e “Vetëvendosjes”, të them të drejtën, pas diplomimit Harvard, nuk di a keni këso kursesh ju. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Visar Ymeri, pyetje për zëvendëskryeministren Mimoza Kusari-Lila.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryesues!

Më 1 korrik, Kroacia hyn në Bashkimin Evropian, pra rrjedhimisht del edhe nga CEFTA. Bashkimi Evropian ka kërkuar nga shtetet ballkanike që ta vazhdojnë tregtimin pa taksa doganore me Kroacinë, edhe pas daljes nga CEFTA. Kosova po ashtu është pjesë e kësaj marrëveshjeje dhe e këtij organizimi. Kroacia i ka në Kosovë importet me shifra të

konsiderueshme. Për shembull, vetëm në vitin që shkoi dhe vetëm për produktin e qumështit, e importi gjatë vitit të kaluar është realizuar nga 518 mijë litra, të cilat janë importuar nga Kroacia me 342 mijë euro bazë doganore, pa llogaritur artikujt tjerë. Ndërkohë, Agjencia e Statistikave të Kosovës, përkatësisht Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare na tregon se statistikat e tregtisë së jashtme për muajin janar të sivjetshëm tregojnë për një deficit tregtar prej 112 700 000 euro, ose rreth 3 milionë euro më shumë se në janarin e vitit të kaluar.

Zonja ministre, në këto kushte si do të veprojë Kosova në raport me Kroacinë pas datës 1 korrik të vitit 2013?

KRYESUESI: Zonja zëvendëskryeministre, e keni fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRJA MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar kolegë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti Ymeri

Në pyetjen tuaj ju thoni se Bashkimi Evropian ka kërkuar nga shtetet ballkanike, përfshirë edhe Kosovën, që të vazhdojë tregtimin me Kroacinë pa taksë doganore, pas hyrjes së këtij shteti në Bashkimin Evropian. Kosova nuk e ka marrë asnjë kërkesë nga Bashkimi Evropian, apo ndonjë etnitet tjetër që ta vazhdojë tregtinë me Kroacinë pa taksa doganore, pas hyrjes së Kroacisë në Bashkimin Evropian, më 1 korrik 2013. Një kërkesë e tillë nuk do të ndodhur, sepse do të ishte në kundërshtim me Traktatin dhe ligjet ekzistuese të Bashkimit Evropian.

Traktati i Lisbonës dhe ligjet e Bashkimit Evropian e rregullojnë qartë çështjen e tregtisë me jashtë, me vendet e Bashkimit Evropian. Sipas këtyre ligjeve, vendet anëtare, në këtë rast Kroacia së shpejti, nuk mund të kenë marrëdhënie të veçanta tregtare me asnjë vend individualisht jashtë Bashkimit Evropian. Prej momentit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, tregtia me jashtë për Kroacinë është çështje që vendoset në nivel të Komisionit Evropian dhe vlen për të gjitha vendet anëtare. Vendet jashtë BE-së, siç është Kosova në këtë rast, nuk mund të negociojnë çështje tregtare individualisht me vendet anëtare të BE-së. Çdo vendim për tregti me jashtë për vendet e BE-së merret nga Komisioni Evropian dhe ka efekt për të gjitha shtetet anëtare.

Për këtë arsye, Kroacia nuk mund të ketë marrëdhënie të veçanta tregtare me asnjë vend specifik, e kjo nënkupton se pas 1 korriku 2013, tregtia ndërmjet Kosovës dhe Kroacisë do të bëhet ashtu siç Kosova e bën me çdo vend tjetër anëtar të Bashkimit Evropian, pra në nivel të BE-së, e jo vendet anëtare individualisht. Marrëdhëniet tregtare ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian zhvillohen për momentin në bazë të masave autonome preferenciale të Bashkimit Evropian, të cilat janë në fuqi deri në vitin 2015. Esenca e këtyre masave, mbi të cilat zhvillohet tregtia BE - Kosovë dhe anasjelltas, është lirimi doganor i të gjitha mallrave me origjinë nga Kosova për në BE dhe mbajtja e vlerës doganore prej 10% për të gjitha mallrat që e kanë origjinën nga Bashkimi Evropian për në Kosovë. Përgjashtim janë vetëm verërat dhe disa produkte të peshkut, me çka Kosova

përfundimisht ka arritur që ta ketë e kuotën e vet të caktuar të eksportit, pas së cilës natyrisht duhet të paguajë doganë.

Mallrat kroate në të kaluarën, si pjesë e CEFTA-s, kanë hyrë në Kosovë me normë 0% doganore, ndërsa pas 1 korrikut edhe këto mallra do t'i nënshtrohen taksës doganore prej 10%. Kjo do të thotë se deficitit tregtar me Bashkimin Evropian i shtohen mallrat nga Kroacia, por buxheti i Kosovës do të përfitojë në vlerë prej 7 milionë euro, për arsye se në vitin 2012, nëse merret një paralele, mallrat e importuara nga Kroacia kanë qenë në vlerë prej 72 milionë eurove.

Raportet tregtare të Kosovës me Kroacinë do të ndryshojnë me rastin e nënshkrimit të Marrëveshjes të Stabilizim-Asocimit. Mënyra e kontraktimit të kësaj marrëveshjeje do ta rirregullonte edhe raportin tregtar të Kroacisë si pjesë të BE-së dhe njësoj do të vlejë edhe për shtetin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Ymeri?

VISAR YMERY: Faleminderit, kryesues! Nuk kam pyetje shtesë se e mora përgjigjen dhe nuk arsye të dyshoj në këtë përgjigje. Do ta shohim se si do të ndodhë, por është raportuar se është kërkuar nga vendet e ndryshme të Ballkanit për t'i vazhduar edhe për një kohë marrëdhëniet tregtare me Kroacinë sipas CEFTA-s, mbase Kosova nuk paska marrë, mbase dhe nuk është kjo e vërtetë. Nuk po dua të supozoj. Shumë mirë pra që do të ndryshojë ky raport tregtar me Kroacinë edhe shpresoj se do të ndodhë një gjë e tillë.

KRYESUESI: Faleminderit! Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur më 16 maj 2013

A ka dikush vërejtje lidhur me procesverbalin? Nuk ka. Atëherë konstatoj që Kuvendi e miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 16 maj 2013. Në sallë janë 61 deputetë. Fjalën e ka kërkuar zoti Muhamet Mustafa lidhur me një kërkesë. Urdhëroni, e keni fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Komisioni që është formuar këtu për hetimin parlamentar lidhur me faturimet e energjisë e ka filluar punën, e ka bërë planin e punës dhe më 25 prill është drejtuar me një kërkesë që të shtyhet, përkatësisht të zgjatet afati për arsye të dinamikës së paraparë për një muaj. Me vendimin e Kuvendit, afati ka qenë 2 muaj. Është kërkuar edhe një muaj, me orientim që puna të përfundohet deri në fund të qershorit, duke e drejtuar edhe raportin që është duke e përgatitur komisioni. Prandaj, meqenëse kjo çështje nuk është proceduar, unë jam drejtuar me një shkresë të posaçme që kjo të hyjë në rend dite për arsye se në fillim të javës së ardhshme na përfundon mandati dymujor dhe shkresën e keni përpara të gjithë.

KRYESUESI: Faleminderit! Sa deputetë janë në sallë? Regjia, bjeri ziles që ta hedhë menjëherë në votim kërkesën. Atëherë, siç e dëgjuat, zoti Mustafa kërkon që mandati i Komisionit të shtyhet deri më 27 qershor, domethënë për një muaj.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim lidhur me kërkesën, në qoftë se nuk ka dikush diçka për të thënë lidhur me kërkesën e zotit Mustafa. Votojmë tash!

Regjia, edhe një herë përsëriteni votimin, ju lutem. Votojmë tash!

Konstatoj se me 61 vota për, asnjë kundër, asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi kërkesën e zotit Mustafa që afati i Komisionit Hetimor të vazhdohet për një muaj.

Ndërsa, e kemi edhe një informim të kryetarit të Grupit Parlamentar të SLS-së, i cili besoj se nuk ka nevojë t'i nënshtrohet votimit, sepse është vetëm njoftim për Parlamentin.

Grupi Parlamentar i SLS-së ka marrë vendim që të bëhet ndërrimi i kryetarit të Komisionit për të Drejtat e Komuniteteve dhe Kthim, Goran Marinković, dhe në vend të tij emërohet zonja Jasmina Zhivković. Ky është vendim i Grupit Parlamentar.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2012

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka shqyrtuar raportin vjetor të Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2012 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim. Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2012 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj kryetarin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, Nait Hasani, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje kolegë,

Komisioni, në mbledhjen e mbajtur më 15.4.2013, e ka shqyrtuar raportin vjetor të punës për vitin 2012 të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim, me ç'rast janë parashtruar dhe pyetjet e zyrtarëve nga deputetët dhe komisioni. Komisioni vlerëson se raporti vjetor i punës për vitin 2012, i parashtruar nga kjo zyrë, është më i avancuar në krahasim me raportet tjera të gjertanishme, me përmirësime graduale dhe është në pajtim me nenin 3 të ligjit të cekur më lart.

Komisioni i rekomandon Kuvendit që ta miratojë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zonja Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 26 prill të këtij viti, e shqyrtoi raportin vjetor financiar të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2012 dhe vlerësoi se në raport janë prezantuar shpenzimet në mënyrë të detajuar sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike. Raporti po ashtu përmban të dhëna për planifikimin e buxhetit për vitin 2012 dhe krahasimet për përqindjen e realizimit të shpenzimeve në raport me vitin paraprak.

Buxheti i Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2012 ka qenë 337 819 euro. Janë shpenzuar 318 024 euro, apo buxheti është shpenzuar në masën 97,07%. Në raport janë prezantuar edhe të hyrat e realizuara nga Zyra e Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2012. Kjo zyrë ka arritur të inkasojë 70,84% të të hyrave të planifikuara për vitin 2012, që do të thotë se janë realizuar diku 225 309 euro të shumës së planifikuar nga kompanitë e licencuara në sektorin e ujësjellësit dhe kompanitë e grumbullimit të mbeturinave.

Në komision ka qenë i pranishëm edhe përfaqësuesi i Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim, me ç'rast janë ngrehur shumë çështje nga anëtarët e komisionit, sidomos për shpenzimet e disa nënkategorive të caktuara dhe pas marrjes së përgjigjeve nga përfaqësuesi i kësaj zyre, Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka miratuar këtë raport me konstatimin se i përmbush obligimet ligjore për raportin që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe plotësim-ndryshimet e këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESI: Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare të përfaqësuesve. Në emër të komisionit, zoti Sadriu e ka fjalën.

ALI SADRIU: Faleminderit që ma dhatë fjalën!

Dhe pikërisht që Rregullorja e vjetër e ka pasur këtë mangësi. Desha ta ngre një çështje, se në vitin 2010 dhe 2011, raportet që i kemi pasur, asnjë raport tjetër nuk ka pasur të gjetura më të mëdha se këto raporte. Unë do të isha shumë i kënaqur që këta parametra të prezantuar, që kolegët e mi i kanë shqyrtuar, dhe po të isha edhe unë në vendin e tyre, ndoshta njësoj do t'i vlerësoja, por që defekti po frikohem që është se këto nuk janë audituar ende, ose janë audituar, por nuk kanë arritur te ne. Prandaj, radhitja e këtij raporti në këtë kohë, pa pasqyra financiare, po frikohem se do ta kemi një vlerësim krejt tjetër në momentin kur t'i marrim pasqyrat financiare. Prandaj, unë mendoj se kësaj praktike, kësaj çështjeje duhet t'i japim fund, nëse duam që paraja publike të mirë-menaxhohet.

Ju kujtohet, zoti nënkryetar, dhe të gjithë të tjerëve, në raportin që e kemi shqyrtuar të vitit 2010, ka dalë se me gjithë dobësitë shumë të theksuara, me gjithë shumë të gjetura, atje Bordi ka marrë 23 paga në emër të performansës së mirë. Prandaj, unë kam frikohem se me këto të dhëna do të kemi diçka tjetër në momentin e vlerësimit dhe ky është një defekt në Kuvend, sepse raportin e performansës e shkruan vetë menaxhmenti dhe natyra e njeriut e justifikon punën e vet, sido që të jetë. Prandaj, duhet dikush tjetër të na e bëjë një vlerësim për të ardhur deri te e vërteta. Mund të jetë edhe kështu siç e kanë e dhënë,

por ne nuk e dimë, dhe në bazë të asaj që kemi pasur në të kaluarën, unë i ngre këto dyshime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Ne si komision e kemi vlerësuar raportin dhe do ta japim fjalën tonë, por edhe si grup parlamentar.

Raporti vjetor i performansës për kompanitë e ujësjellësit dhe mbeturinave i këtij viti është raport i hartuar mirë, i pasur me shumë të dhëna dhe mbi të gjitha korrekt. Në raport, për vitin e kaluar janë evidentuar disa suksese, ndër të cilat dëshirojmë t'i përmendim: Në vitin 2012 është rritur mbulueshmëria me shërbimet e ujësjellësit, e cila ka arritur në 78%, është rritur po ashtu mbulueshmëria me shërbimet e kanalizimit në 56%. Kjo shpërputhje nuk është e mirë për shkak tregon se ne nuk e kemi një cikël të mbyllur në këto dy fusha.

Ka përmirësim në faturim të ujit. Ai ka arritur në 58% të sasisë së ujit të prodhuar. Është shtuar arkëtimi për 13%, mirëpo duhet të thuhet se ky përmirësim është pasojë e ngritjes së tarifave të ujit të konsumatorëve që paguajnë, e më pak i efikasitetit të kompanive për faturimin e ujit të konsumuar. Megjithatë, ka rritje simbolike të shkallës së arkëtitimit, e cila është 1%, e kjo ka arritur në 79%. Janë zvogëluar humbjet e ujit 1%, të cilat janë në 60%, gjë që është larg standardeve evropiane. Suksesi më i madh është arritur në vendosjen e ujëmatësve, mbulueshmëria e të cilëve ka arritur në 91% nga 81%, sa ka qenë vitin e kaluar. Ky ka qenë edhe një rekomandim i komisionit që kjo punë të përfundojë sa më shpejt, me qëllim që të mos kemi tarifa paushalle.

Është për t'u lavdëruar ulja e tarifave të këtij viti për rreth 6,5%, të cilat do t'i rëndojnë sigurisht më pak konsumatorët tanë. Ka pasur edhe mangësi në aktivitetet që i kanë përcjellë këto institucione. Ta marrim shembull, kualiteti në Klinë nuk i ka përmbushur standardet në aspektin mikrobiologjik dhe kimik, për ç'gjë edhe është ndërprerë furnizimi me ujë nga ky burim. Ne mirëpresim që së shpejti fabrika e re e ujit të vihet në përdorim dhe kjo punë të mbyllet.

Rrezik potencial ka paraqitur edhe zvogëlimi i numrit të mostrave të marra për analizat e kualitetit të ujit në KRU "Prishtina", me çka nuk është respektuar udhëzimi administrativ.

Humbjet vjetore të ujit arrijnë në 80 milionë metër kub, gjë që është për shqetësim, sepse po ta kthesh në para arrin në një shumën prej 25 milionë euro. Po ashtu janë evidentuar dështime në realizimin e investimeve kapitale për vitin 2012, nga të gjitha KRU-të në nivel të përgjithshëm të sektorit, prej 76%. Ky dështim i ka përcjellë edhe donatorët në masën 70%, që është një tregues jashtëzakonisht i dobët. Është konstatuar se në 15% të rasteve, ujëmatësit nuk janë lexuar dhe faturimi nuk është bërë sipas gjendjes së tyre. Ka pasur edhe ankesa nga konsumatorët. Më të shumta janë adresuar në regjionin e Prishtinës, 53 sosh. Shpenzimet operative të lejuara janë tejkaluar për rreth 28%, gjë që paraqet një shkelje dhe një tregues jashtëzakonisht të keq. Zyra e Rregullatorit i ka

mbështetur rekomandimet për përfshirjen e njësive operative në kuadër të KRU-ve, e bashkë me to edhe sistemet rurale, që ka qenë një trend që këto të shkëputen pak a shumë nga sistemi ynë unik për investimet në zhvillimin e burimeve të reja të ujit, ngritjen e kapaciteteve të prodhimit të ujit dhe zhvillimin e infrastrukturës së ujësjellësit dhe kanalizimit, për subvencionimin e konsumatorëve të varfër, të cilët nuk janë në gjendje të paguajnë, për reduktimin e ujit të pafaturuar dhe për arkëtimin e tij.

Dëshirojmë t'i inkurajojmë ndërmarrjet publike të ujësjellësit dhe të kanalizimit të komunave me popullsi shumicë serbe, Shterpcë, Novobërdë, Mitrovica e veriut, Leposaviq, Zubin-Potoku dhe Zvečan që të inkuadrohen në Zyrën e Rregullatorit të Kosovës. Po ashtu, dëshirojmë që ta përmendim faktin se jemi në proces të punës për hartimin e ligjit të ri, me të cilin Zyra e Rregullatorit të Ujërave dhe Kanalizimeve do t'i heqë kompetencat.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përshëndet anëtarësimin e Zyrës së Rregullatorit në shoqatat ndërkombëtare të ujit. Ne e kemi inkurajuar këtë institucion që të vazhdojë me sukseset e arritura, ndërsa si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike do ta votojmë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike e ka shqyrtuar raportin e Zyrës Rregullative për Ujësjellës dhe Kanalizim dhe njëkohësisht, me gjithë sfidat e shumta me të cilat aktualisht përballet sektori i shërbimit të ujit në Kosovë, performansa e përgjithshme në këtë sektor, në krahasim me vitin e kaluar, e ka pasur një përmirësim jashtëzakonisht të vogël, si nga vetë kjo zyrë, po ashtu nga kompanitë regjionale, të cilat merren me çështjen dhe shërbimin e ujësjellësit dhe kanalizimit. Por, mbetet të bëhet më shumë, sidomos që qytetarët e Kosovës të kenë ujë të mjaftueshëm nga të gjitha kompanitë regjionale, si dhe vendosja e ujëmatësve është një problem me të cilin, edhe pse ka një rritje dhe një përmirësim, në krahasim me vitin e kaluar dhe me këtë vit, kemi një rritje të vendosjes së ujëmatësve, mirëpo vazhdon të jetë problem kyç ende, sepse qytetarët e Kosovës vazhdojnë që faturimin ose shumën e pagesës ta bëjnë në mënyrë paushalle.

Prandaj, tash dihet mirëfilli që kjo zyrë më nuk e ka edhe sektorin e mbeturinave dhe është iniciuar edhe ligji i veçantë për ujëra dhe kanalizime dhe komisioni, një njëfarë forme, e ka mbështetur që ky ligj të fillojë të hartohet dhe njëkohësisht që gjatë këtij viti, apo në fillim të vitit të ardhshëm, të bëhet miratimi, sepse çështja e ujërave duhet të rregullohet tash e tutje me një ligj të veçantë.

Grupi Parlamentar i LDK-së, në parim, do ta mbështesë raportin e Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Kanalizim dhe njëkohësisht mbështet edhe mendimin e kolegut deputet, deputetit Ali Sadriu, i cili tha që ndoshta të gjitha raportet që vijnë në Parlamentin e Kosovës duhet

të bashkëkordinohen me raportet e auditimit në kuptimin e asaj që të pasqyrohen realisht pasqyrat financiare, sepse kjo do të ishte një diçka shumë pozitive, nëse raportet publikohen nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm dhe pastaj ato vijnë nga agjencitë e ndryshme, të cilat i raportojnë këtij Kuvendi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “Vetëvendosje”, zoti Liburn Aliu e ka fjalën.

LIBURN ALIU: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” do ta votojë raportin e Zyrës e Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim. Dakord që vërehen përmirësime në çështjen e mbulueshmërisë me ujë dhe në çështjen e faturimit, por akoma vazhdon të mbetet problem çështja e faturave paushalle, me ç’rast barra bie mbi qytetarët, të cilët i paguajnë këto fatura.

Meqenëse në shumë raste këto paushalle vendosen në mënyrë fikse, sidomos në zona, edhe pse ekzistojnë pra orë të ujit, këto paushalle vendosen me njësi fikse, qytetarët i paguajnë dhe mesatarisht mund të themi që vendosen mbi mesataren e shfrytëzimit apo shpenzimit të ujit që ata bëjnë, respektivisht i bie që qytetarët që sot paguajnë dhe janë të rregullt në pagesa, i bie t’i paguajnë edhe humbjet e ujit, e po ashtu edhe pjesën e ujit të pafaturuar. Prandaj, ky është një problem, i cili duhet me urgjencë të merret nga vetë Qeveria e Kosovës, meqenëse nuk është Zyra e Rregullatorit ajo që do të mund ta bënte drejtpërdrejt, por do të mund të bënte udhëzim. Pra, duhet të investohet patjetër në orët e ujit gjithandej, sidomos në zonat urbane, ku ky problem është tejet i theksuar.

Pra, megjithatë, ne do ta votojmë këtë raport, meqenëse përmirësimet në raport me vitin e kaluar janë të dukshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së, zonja Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e ka shqyrtuar raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim dhe shqyrtimin e tij po e filloj me vizionin dhe misionin që ia ka caktuar vetes kjo zyrë. Vizioni thotë: “Shërbimi cilësor dhe i qëndrueshëm i ujësjellësit dhe kanalizimit për të gjithë qytetarët e Kosovës”. Shtrohet pyetja: A po realizohet kjo, kur dihet se veç në Prishtinë sa ka reduktime të ujit? Ndërsa misioni ka të bëjë rregullimin e kompanive të ujësjellësit, kanalizimit në funksion të ofrimit të shërbimeve cilësore efikase dhe të sigurta në përputhje me praktikën e mira evropiane, veçanërisht duke fokusuar promovimin e eficiencës, transparencës, shtrirjes së shërbimeve për të gjithë qytetarët, mbrojtjen e konsumatorit me çmime sa më të përballueshme për shërbimet e ofruara, gjithmonë duke pasur në konsideratë mjedisin dhe shëndetin publik.

Atëherë, si mund të themi se po ofrohen shërbime me çmime të përballueshme për qytetarët, kur qytetarët tariforen pa asnjë kriter, qoftë nga metrat katror në shtëpitë apo në banesat ku jetojnë, apo edhe me kokë banori, domethënë tarifohen në mënyrë paushalle.

Raporti vizualisht është i hartuar mirë, duke e shpjeguar skemën organizative, ligjshmërinë, synimet strategjike të parapara në planin strategjik 2012-2014, performansën e kompanive të nivelit qendror, por edhe të kompanive rajonale të ujësjellësit. Kjo zyrë duhet të jetë në shërbim të qytetarëve të Kosovës dhe vërtet ta përmbushë vizionin dhe misionin e caktuar nga ajo vetë, shërbimet cilësore dhe çmimet e përballueshme të konsumatorit.

Me gjithë këto vërejtje, Grupi Parlamentar i Aleancës do ta votojë këtë raport.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Koalicioni Kosova e Re, zonja Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryesues!

Edhe Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovën e Re e përkrah raportin e Zyrës së Rregullatorit.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë desha të ndalem në këtë çështje dhe do të dëshiroja, meqenëse është komision që duhet të raportojë edhe për disa çështje tjera, jo vetëm për çështjen e orëve dhe të financave të përdorura mirë apo keq, nuk është punë imja, është punë e komisioneve dhe i atyre që i mbikëqyrin, por unë e kam një shqetësim tjetër, që Kosova nuk është e mbuluar me impiantet, të cilat garantojnë qytetarët e saj që do të pinë ujë të pastër. Pra, e kemi një mbulesë shumë të vogël, domethënë atë që e mbulon Liqeni i Badovcit, ai i Batllavës, i Radoniqit, që e garantojnë në njëfarë mënyre popullatën që pi ujë të pastër, ndërsa pjesët tjera pinë ujë të rrjedhshëm, i cili pastrimin më të madh e ka nëpërmjet klorifikimit dhe absolutisht asgjë tjetër.

Pra, lidhur me këtë çështje do të duhej të debatohet dhe do të duhej ta kemi një raport të detajuar për nevojat që të ngrihen dhe të ndërtohen rezervuarët e rinj të ujit, sepse uji po shteron. Ato zona që pinë nga ujërat e rrjedhshëm, ose nga lumenjtë dhe burimet e ndryshme malore, gjatë verës shteren dhe shumica e banorëve nuk kanë ujë të pijshëm, prandaj do të duhej që vërtet të shqetësohemi dhe ta bëjmë një planifikim institucional qeveritar mbi domosdoshmërinë e investimit për t'i siguruar popullatës ujë të pijshëm.

Në rrethanat kur sot në vit vdesin rreth 1 milion e gjysmë banorë në rruzullin tokësor vetëm për shkak të përdorimit të ujit jo të pastër, atëherë shqetësimi mendoj që duhet të jetë permanent nga ne. Ashtu si për ta pasur një ambient normal jete për të gjithë në fshat dhe në qytet, domosdoshmërisht që duhet të mbulohet e tërë Kosova edhe me kanalizimin dhe përpunimin e ujërave të zeza. Faleminderit!

Atëherë nuk ka tjetër të paraqitur, nuk e di sa deputetë janë në sallë për ta votuar raportin. Lus regjinë që t'i bjerë ziles, që të vijnë deputetët për të votuar.

Në rregull. Vazhdojmë me pikën e radhës:

5. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2012

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e ka shqyrtuar raportin vjetor i punës së Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2012 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij. Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2012 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar rekomandimin e tij.

Sipas kësaj, radha e diskutuesve është e kryetarit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zoti Pajaziti, për arsyetimin e raportit me rekomandime. Zoti Pajaziti, e keni fjalën.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Kolegë deputetë, Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në mbledhjen e datës 7 maj, e ka shqyrtuar raportin vjetor të punës për vitin 2012 të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave dhe ka marrë vendim që t’ia rekomandojë Kuvendit për aprovim.

Më lejoni, zoti kryesues i seancës, të jap informata të shkurtra lidhur me këtë raport. Ky raport, për dallim nga viti i kaluar, kur komisioni ka pasur vërejtje të shumta, jo vetëm në cilësinë e raportit, por edhe në përgjithësi në performansën e këtij komisioni, këtë vit, për dallim, e kemi një rritje, në fakt edhe raporti është më cilësor, por edhe puna e këtij institucioni, e këtij mekanizmi është rritur dukshëm. Pra, në vitin që shkoi në përputhje me ligjin, ky komision ka arritur t’i realizojë në pjesën më të madhe detyrat e veta ligjore, ka arritur ta formësojë në njëfarë mënyre këtë fushë, duke licencuar dy agjenci ose dy mekanizma, ‘Infrakos’ dhe ‘Trajmkos’, në përputhje me ligjin dhe është në punë e sipër për t’i institucionalizuar, për t’i aktivizuar deri në fund të gjithë resorët. Po ashtu, kanë pasur mangësi të mëdha në staf.

Më lejoni, po ashtu që, meqenëse jemi në kohën kur ne po e trajtojmë një numër të madh të raporteve të agjencive dhe të rregullatorëve, mendoj që ka edhe disa mangësi në këtë proces, meqenëse ju e dini që ndër kriteret kryesore të cilat ne i trajtojmë janë sfidat nga Raporti i Progresit, pastaj raporti i Auditorit Gjeneral për këto institucione, dhe të shumtën e herëve këto çështje nuk janë të përfshira në këto raporte dhe sidomos raporti i Auditorit të Përgjithshëm. Ndoshta do të ishte mirë që në njërën nga mbledhjet e radhës, vetë Kryesia e Kuvendit, ose me kryetarë komisionesh, ta trajtojë këtë çështje, në mënyrë që të kemi një trajtim të përputhur në kohë, paraprakisht të raportit të Auditorit Gjeneral dhe të jemi në agjendë të përbashkët, në mënyrë që kur t’i kemi në trajtim këto raporte, njëkohësisht ose me kohë, komisionet t’i kenë të trajtuara edhe raportet e Auditorit Gjeneral dhe t’i kemi të gjitha dokumentet para vetes, në mënyrë që ta japim një vlerësim sa më real.

Në përgjithësi, do të them që ky komision, në vitin që shkoi e ka pasuar një performansë të mirë dhe ne si komision i kemi kërkuar seancës që të bëjë aprovimin e tij, ose të kalojë në Kuvend. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryetares së Komisionit për Buxhet dhe Financa, zonja Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2012. Institucionet e pavarura me ligj e kanë afatin e paraparë se deri në çfarë date duhet t'ia paraqesin raportin Kuvendit.

Në momentin kur ne na arrin raporti, ne jemi të obliguar ta shqyrtojmë atë. Zyra e Auditorit Gjeneral ka afate tjera për t'i shqyrtuar, për t'i analizuar dhe për të bërë auditimin e institucioneve. Për ne do të ishte mirë që në momentin kur i shqyrtojmë këto raporte, ta kishim edhe raportin e rregullsisë edhe raportin e performansës së këtyre institucioneve. Mirëpo, meqenëse Zyra e Auditorit deri në fund të qershorit ka afat për ta dorëzuar raportin e vet të rregullsisë dhe ndonjë raport të performansës, ku e ka bërë auditimin, atëherë nuk e di sa mund t'i shqyrtojmë të gjitha përnjëherë në të njëjtën kohë, edhe pse për ne do të ishte shumë mirë që t'i kemi edhe ato raporte që vërtet ta marrim një qëndrim dhe një vendim të mirë në lidhje me këto institucione.

Megjithatë, ne në Komisionin për Buxhet dhe Financa e analizojmë buxhetin se si është planifikuar dhe rrjedhën e shpenzimeve se si ka shkuar ajo krahasim me atë që është planifikuar.

Efektshmërinë e shfrytëzimit të këtyre mjeteve e analizon Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike në bazë të raportit të Auditorit të Përgjithshëm. Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e datës 26.4.2013, e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave dhe ka ardhur në përfundim që duhet të plotësohet edhe me disa të dhëna, i cili është prezantuar para komisionit, duke kërkuar informata amë të detajuara nga ky autoritet rregullativ. Autoriteti i ka sjellë këto informata plotësuese dhe më 8 maj është rishqyrtuar raporti i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave dhe pasi janë dhënë edhe informatat e kërkuara nga përfaqësuesit e tij, anëtarët e komisionit i kanë marrë sqarimet të cilat ata i kanë kërkuar. Komisioni ka vlerësuar se raporti i përmbush obligimet ligjore që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe e ka miratuar këtë raport.

Buxheti i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave në vitin 2012 ka qenë 242 962 euro, kure janë shpenzuar 225 519 euro, që do të thotë se realizimi i buxhetit ka qenë 93,60%. Rekomandojmë që të miratohet raporti financiar, në emër të komisionit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e kryetarëve të grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i PDK-së, zonja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje të nderuar kolegë deputetë dhe deputete dhe ju të pranishëm, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave. Që në fillim do të them se e mbështetim.

Ky është raporti i tretë me radhë që e sjell rregullatori i pavarur, ARH. ARH është i ngarkuar për rregullimin, mbikëqyrjen, organizimin e sektorit të hekurudhave në Republikën e Kosovës. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave e ka një përparim të theksuar në punën e tij, krahasuar me vitin 2011 dhe vitin 2012. Kështu është konform në zbatimin e Ligjit të hekurudhave, si dhe përmbushjes së mandatit të vet rregullator për sektorin e hekurudhave në Republikën e Kosovës.

Më lejoni të cek se të arriturat kryesore të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2012 ndahen në katër fusha kryesore, të cilat janë: licencimi, sigurimi, rregullimi i tregut dhe interoperabilitetin. ARH-ja, gjatë vitit që shkoi, në punën e tij ka bërë licencimin e dy kompanive hekurudhore, siç është kompani për infrastrukturën e hekurudhave të Kosovës, e quajtur ‘Infrakos’, dhe kompania për operimet me trenat te hekurudhave të Kosovës, e quajtur si ‘Trajmkos’. Sa i përket segmentit që merret ky autoritet, është edhe siguria. Gjatë vitit 2012, autoriteti në fjalë ka hartuar dhe ka nxjerrë rregullore për certifikatën e sigurisë, rregullore për autorizim të sigurisë dhe gjithë infrastrukturën dytësore ligjore, e cila është si obligim nga Ligji për hekurudhat.

Legjislacioni sekondar, si dhe procesi i dhënies së certifikatës dhe autorizimit të sigurisë janë në harmoni të plotë me direktivat e Bashkimit Evropian për sigurinë në hekurudha. Sa i përket rregullimit të tregut, ARH në vitin 2012 ka ndërmarrë disa hapa konkretë në rregullimin e tregut hekurudhor në Republikën e Kosovës. Ndërsa, sa i përket interoperabilitetit sipas Ligjit për hekurudhat e Kosovës dhe direktivat evropiane mbi interoperabilitetin e sistemit hekurudhor, çdo shtet duhet të mbajë një regjistër të mjeteve lëvizëse të autorizuara në territorin e saj për ta ndërlidhur atë me regjistrin qendror evropian të llojeve të autorizuara të mjeteve lëvizëse. Në Kosovë, detyra e mbajtjes të regjistrit nacional të mjeteve lëvizëse hekurudhore i është caktuar Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, përkatësisht Departamentit të Interoperabilitetit sipas Ligjit për hekurudhat e Kosovës, i cili ka për detyrë ta organizojë këtë regjistër dhe për t’i futur të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore që janë në shërbim të Kosovës brenda këtij regjistri.

Për ta realizuar këtë obligim ligjor, gjatë vitit 2012, ky departament ka filluar regjistrimin e të gjitha mjeteve lëvizëse hekurudhore, duke nisur me kompletimin e dokumentacionit të nevojshëm për këtë proces.

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave tashmë e ka në dispozicion regjistrin nacional të mjeteve lëvizëse hekurudhore për herë të parë në Kosovë. Në këtë regjistër janë të regjistruara të gjitha mjetet lëvizëse hekurudhore në territorin e Republikës së Kosovës konform legjislacionit vendor dhe atij evropian. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave e mbështet punën e vet në bashkëpunimin e mirë të besueshëm me të gjitha palët e interesuara në sektorin e transportit hekurudhor, siç është ‘Infrakos’, ‘Trajmkos’, Ministrinë e Infrastrukturës, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ky autoritet ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi edhe me Autoritetin e Aviacionit Civil për shkëmbimin e përvojave ndërmjet dy institucioneve. Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave mbetet i përkushtuar për ta mbrojtur mirëqenien ekonomike të konsumatorëve, të transportit në Kosovë, duke siguruar transport hekurudhor, konkurrues

dhe efikas. Vlen të përmendet se hekurudhat e Kosovës shtrihen në tërë territorin e Kosovës me një gjatësi mbi 300 000 kilometra katror; vija hekurudhore bën lidhjen e të gjitha qendrave më të rëndësishme të Kosovës, përveç Gjakovës dhe Gjilanit; vijat hekurudhore të Kosovës kanë lidhje direkte edhe me shtetet fqinje, si me Maqedoninë dhe Serbinë.

Pra, siç shihet, ky raport i punës është dukshëm më i mirë se raporti i punës të vitit të kaluar dhe ne si Grup Parlamentar e mbështetim. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.)

KRYETARI: Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Lutfi Zharku e ka fjalën

LUTFI ZHARKU: Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar raportin dhe në parim do t'i japim përkrahje, megjithatë do t'i cek dy-tri çështje, të cilat besoj se do të duhet të merreshin parasysh nga udhëheqësit e autoritetit. E para ka të bëjë me licencimin. Në parim, e përkrahim licencimin e bërë për 'Infrakosin', si menaxher të infrastrukturës, dhe 'Trajmkosin' si operues në hekurudhat e Kosovës, por vërejtja jonë shkon në atë për licencimin e operatorëve të jashtëm, të cilët tani më janë të licencuar në Bashkimin Evropian.

Me rregulloren mbi licencimin parashihet që të gjithë ata duhet t'i plotësojnë kushtet, apo licencimi i tyre pranohet nëse ata janë bërë në përputhshmëri me legjislacionin tonë, por e kemi një mospërputhshmëri logjike, kur gjithë legjislacioni ynë përpiket të përputhet me legjislacionin e evropian, kurse në anën tjetër ata që e respektojnë legjislacionin evropian thonë duhet patjetër të përputhet me legjislacionin tonë. Kështu që duhet bërë një përpjekje në kuadër të autoritetit që të harmonizohen të gjitha direktivat, të gjitha udhëzimet, në mënyrë që së paku operatorët që janë të licencuar në Unionin Evropian të mos kenë problem për licencim në Kosovë.

Çështja e dytë ka të bëjë me regjistrimin e infrastrukturës hekurudhore. E përkrahim dhe natyrisht që e mirëpresim regjistrimin e tij, përkundër asaj që një regjistrim i tillë ka qenë i bërë edhe më herët. Disa elemente të regjistrimit i përmendi edhe deputetja Sala Berisha. Megjithatë, është një çështje që mbetet e pasqaruar, derisa regjistrimi është kryer më 25 shtator, rregullorja për regjistrimin e infrastrukturës hekurudhore ka hyrë në fuqi më 19 tetor, që i bie afro një muaj ditë më pas. Kështu që nuk e dimë, thjesht nuk e kemi të qartë nëse regjistrimi është bërë në përputhje me rregulloren në fuqi, apo duhet të bëhet sërish regjistrimi i infrastrukturës hekurudhore dhe mjeteve lëvizëse hekurudhore, në mënyrë që t'i përshtatemi apo thjesht ta plotësojmë një obligim ligjor.

Çështja e fundit ka të bëjë me rregullimin e tregut, përkatësisht me tarifat, e që është çështja më me rëndësi besoj në veprimtarinë apo aktivitetet e Autoritetit të Hekurudhave, i cili e ka departamentin për rregullimin e tregut. Siç dihet, 'Infrakosi', si menaxher i

infrastrukturës, e jep ekspozenë e rrjetit apo tarifat mbi shfrytëzimin e infrastrukturës hekurudhore. ‘Trajmkosi’ e ka bërë një ankesë mbi tarifën e larta për shfrytëzimin e infrastrukturës hekurudhore, që është shqyrtuar nga departamenti për rregullimin e tregut dhe, por që në realitet papëseprapë Ministria e Infrastrukturës i ka përkrahur apo i ka miratuar tarifën për shfrytëzimin e infrastrukturës hekurudhore, që janë kundërshtuar nga ‘Trajmkosi’.

Është një çështje jashtëzakonisht me rëndësi për shkak se në gjendjen e sotshme, transporti hekurudhor nuk është aspak konkurrues në krahasim me transportin rrugor. Po i përmend shifrat mbi tonazhin që është bartur me transportin hekurudhor gjatë vitit 2011 dhe gjatë vitit 2012, e që shënon një zvogëlim prej 25%.

Mënyra e tillë e përcaktimit të tarifave për shfrytëzimin e infrastrukturës hekurudhore, pa një analizë të thellë të konkurrueshmërisë së këtij transporti në krahasim me transportet tjera, në rastin konkret me transportin rrugor, nuk mendoj se çon në zhvillimin e mëtutjeshëm të infrastrukturës dhe në përgjithësi të themi të ekonomisë hekurudhore në Kosovës, që duhet të kihet parasysh që këto tarifa të jenë shumë më konkurrense se që ishin deri më tash.

Në parim, edhe një herë po e përmend, do ta përkrahim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! “Vetëvendosja”, kryetari i Grupit, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” e përkrah këtë raport të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave. Natyrisht u përmendën disa çështje për raportin, është mjaft informues, mirëpo nuk mund ta them të njëjtën për gjendjen të cilën e kemi sot në sistemin e hekurudhave dhe shkurt, mendoj që do të duhej ta kishim një plan kombëtar, por natyrisht edhe rëndësia e rregullatorit është e pazëvendësueshme. Plan kombëtar të zhvillimit të sistemit dhe rrjetit hekurudhor që, jo vetëm që do t’i lidhte të gjitha pjesët e Kosovës me njëra-tjetrën, por veçanërisht do ta lidhte Kosovën edhe me Shqipërinë, për shkak se e dimë që hekurudhat janë të pazëvendësueshme në dy aspekte kryesore, në transportimin e mallrave, por edhe e kanë rëndësinë e vet strategjike sa i përket sigurisë, dhe si të tilla hekurudhat, edhe kur të funksionojnë me humbje, janë të domosdoshme për t’u mirëmbajtur, e lëre më që ka hapësirë që të bëhen edhe kompani profitabile. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Aleancës, deputeti Xhevdet Neziraj e ka fjalën.

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës në parim do ta përkrahë raportin e Autoritetit të Hekurudhave. Gjithashtu, i përkrahim vërejtjet që u dhanë nga anëtarët e Komisionit Funkcional, por edhe nga kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Unë dua të shtoj se nga Komisioni për Buxhet dhe Financa kemi kërkuar dy herë që të

sillet në mënyrë analitike dhe sintetike shumë të qartë buxheti i planifikuar dhe i harxhuar dhe atë obligim e ka kryer ky autoritet rregullativ, por për të qenë më efikas dhe më mirë dhe që të funksionojë më mirë, Komisioni FunkSIONAL duhet i fundit ta shqyrtojë raportin, për arsye se duhet të marrë të dhëna nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe nga Komisioni për Mbikëqyrjen Financiare, me qëllim që Komisioni FunkSIONAL të mund në mënyrë më detale ta analizojë.

Mirëpo, kjo është çështje që duhet të rregullohet ndoshta me Rregulloren e re të Kuvendit, me qëllim që komisionet funksionale të jenë të fundit që këto raporte t'i analizojnë në mënyrën shumë më detale dhe ta kenë një pasqyrë më të mirë, edhe nga Komisioni për Buxhet, edhe nga Komisioni për Mbikëqyrje Financiare, me qëllim që këto autoritete ta përmirësojnë punën e vet, të raporteve të tyre, por në përgjithësi të jenë shumë më efikase. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Koalicionit për Kosovë të Re, kryetarja Myzejene Selmani e ka fjalën.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Përsëritet për deputetët,

Duke marrë parasysh se është një rregull, edhe kushtetuese, që raportet e autoriteteve të pavarura të vijnë nga marsi deri në maj të shqyrtohen brenda Kuvendit Kosovës, ne si Koalicion për Kosovë të Re e kemi shqyrtuar raportin e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, dhe në rast se shihet ky raport nga raporti i kaluar, mund të themi se ka përmirësime për arsye se ka qenë një autoritet i formuar rishtazi dhe për këtë arsye problemet e tyre kanë qenë më të mëdha.

Mirëpo, në rast se e shohim çështjen e funksionimit të departamenteve dhe çështjen e funksionimit në bazë të Ligjit të hekurudhave, mund të themi se ARH-ja e bënë licencimin, mirëpo çështja e tarifave, që u përmend edhe nga deputeti Lutfi Zharku, papë se prapë ngel nën menaxhimin e Ministrisë së Infrastrukturës, e cila merr vendime lidhur me miratimin e 6 çmimeve të ekspozesë së rrjetit 2013 dhe atëherë shtrohet pyetja për Kuvendin se për çka është formuar Agjencia e Hekurudhave? Në rast se të gjitha vendimet për çështjen e tarifave duhet të shkojnë nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës, atëherë roli i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave nuk është i pavarur, por është i varur direkt nga Ministria e Infrastrukturës.

Në parim mund t'i japim përkrahje raportit, mirëpo duhet të sqarohet definitivisht nëse është agjenci e pavarur, apo është agjenci e cila funksionon nën Ministrinë e Infrastrukturës dhe një zyre apo agjenci, e cila është e vendosur në Zyrën e Kryeministrit, që është prapë përgjegjës. Shtrohet pyetja, çfarë kemi bërë me Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave?

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS, nuk ka të lajmëruar. Në emër të “6+”, jo. Në emër të grupit “Zajednička Budućnost”, nuk ka.

Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës, pasi nuk kemi kuorum për të votuar.

6. Debat parlamentar lidhur me gjendjen e pyjeve në Kosovë, sipas kërkesës së Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në bazë të nenit 15, pika 8, të Rregullores së Kuvendit, ka kërkuar debat parlamentar lidhur me gjendjen e pyjeve në Kosovë.

E ftoj kryetarin e Komisionit, deputetin Nait Hasani, që ta marrë fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për kolegët deputetë,

Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e ka kërkuar këtë debat për gjendjen dhe mbrojtjen e pyjeve në Kosovë.

Të nderuar deputetë,

Ne si komision, gjatë vitit të kaluar kemi konstatuar se pyjet në Kosovë janë në rrezik të përhershëm, në dëmtimin dhe shkatërrimin e tyre nga mosfunksionimi i mirë i menaxhmentit dhe në mungesë të kapaciteteve në këtë institucion, që mund të ketë mundësi për mbrojtje në nivel të duhur.

Ne si komision kemi parë shumë përmirësime apo përpjekje në dukje nga e kaluara në mbrojtjen e pyjeve nga segmente të caktuara në Ministrinë e Bujqësisë, por në mungesë të një buxheti të mjaftueshëm dhe kapaciteteve të vogla, nuk ka pasur mundësi të ndërpritet ky shkatërrim i pyjeve në Kosovë.

Pyjet si pasuri kombëtare e Kosovës dhe e qytetarëve të saj janë në gjendje të mjerueshme dhe në shkatërrim e sipër.

Të gjitha vendet e rajonit i kanë pyjet më të mbrojtura se këtu në Kosovë. Të gjitha ato vende kanë legjislacion të qartë në mbrojtjen e pyjeve dhe ato i shohin si pasuri kombëtare, ndërsa ne të ne si veprimtari biznesi dhe mundësi e shkatërrimit. Pyjet janë kah dëmtohen nga papërgjegjësia dhe kompetencat që kanë disa nga menaxhmenti i pyjeve, sepse janë krijuar shumë ndërvarësi ndërmjet vete, kanë konflikt ndërmjet vete dhe nuk mund t'i mbrojnë ato.

Ne si komision, në vitin e kaluar kemi konstatuar se në Kosovë janë shkaktuar një numër i madh i zjarreve të qëllimshme dhe nga vetë natyra. Zjarret e qëllimshme janë shkaktuar nga persona fizikë, me qëllim përfitimi të pastajshëm nga masat drusore dhe si dru teknik.

Ne këtë e bazojmë në raportin e Ministrisë së Punëve të Brendshme nga Departamenti i Emergjencës të gushtit të vitit të kaluar ku në Deçan dhe në Koretnik... Dragash, janë djegur me qindra hektarë pyje të mbrojtura të pishave rrobull e që llogariten ndër lloje të rralla në Kosovë, sepse ekzistojnë vetëm në këto dy vende, ku edhe thuhet se shumica e zjarreve janë të qëllimshme, ku mund të shihet edhe në foto. Fotot i kemi edhe të djegura, edhe të shkatërruara të pyjeve nëpër vendin tonë.

Ndërsa, angazhimi në shuarjen e zjarrit nga banorët dhe kompanitë të cilat kanë marrë pjesë në shuarjen e zjarreve është indikative, sepse e njëjta kompani “Minatori”, për 10 vjet e ka tenderin për prerjen e drurëve në Koretnik për sa vite. Kjo ka ngjallur dyshim dhe konflikt interesi, e cila merret edhe me shuarjen e zjarrit.

Po ajo që dua të them këtu, sepse është një fakt, që na ka përcjell në vitin e kaluar në miratimin e ligjeve të parqeve kombëtare të Bjeshkëve të Nemuna dhe të parkut kombëtar ” Bjeshkët e Sharrit”.

Ne si komision në debatet që kemi pasur nëpër komuna me banorët e pjesëve ku i prekin këto ligje, kemi pasur konflikt me zyrtarët e Agjencisë së Pyjeve në mënyrë të koordinuar. Në çdo vend kanë organizuar banorët dhe kompanitë, që të na kundërshtojnë në debatet tona në arsyetimin për mbrojtjen dhe nxjerrjen e ligjeve për parqet dhe interesimin e mbrojtjeve të pyjeve. Kemi pasur edhe kërcënime fizike nga banorët, që i kanë nxitur njerëz të agjencisë për të kundërshtuar ligjet e parqeve, si në Pejë e Deçan, Rugovë, Istog, Dragash.

Në çdo vend kemi pasur mbështetjen e kryetarëve të komunave, që na kanë mbështetur në raport me debatet për ligjet për t’i nxjerrë, që sa më parë duhet të miratohen këto ligje dhe shpëtohen pyjet. Ndërsa, në çdo vend kemi pasur Agjencinë kundër nesh si Komision, kundër këtyre ligjeve. Për këto i kemi edhe procesverbalet e takimeve.

Po, gjëja më e keqe ka mund të ndodh, meqë ne si Komision kemi qenë në mes konfliktit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Mjedisit. Në luftën e tyre për bërjen dhe mosbërjen e këtyre dy ligjeve për parqet, kjo dëshmon edhe kërkesën e Ministrisë së Bujqësisë te presidentja për të mos e nënshkruar këtë ligj.

Të nderuar deputetë, me bërjen e këtyre ligjeve ne i kemi treguar botës se kemi dhe mund të marrim përgjegjësi për mbrojtjen e pyjeve dhe krijimin e parqeve kombëtare, që do të jenë në të mirë të banorëve të vendit tonë.

Unë mendoj se këtu me këto ligje iu kemi ndërprerë mundësinë e keqmenaxhimit të pyjeve në këto pjesë, ku janë shkatërruar më së shumti masa drusore për përfitimet materiale të njerëzve të caktuar.

E gjithë kjo vjen, sepse me ligj nuk janë të përcaktuara si duhet përgjegjësitë. Ne kemi katër apo pesë nivele që kanë marrë përgjegjësi e kompetenca në pyje. Kemi Bordin e pyjeve, kemi Departamentin e Pyjeve në Ministri, kemi Agjencinë e Pyjeve, kemi komunat dhe Inspektoratin e Pyjeve në Kosovë.

Kjo shumë e përgjegjësisë në Ligjin e pyjeve tregon se gjithë këto nivele nuk kanë mundur të harmonizohen dhe të ndajnë atë që duhet bërë për t’ mbrojtur pyjet.

Me vendimin e fundit administrativ, ku u janë dhënë disa përgjegjësi komunave në mbrojtjen dhe kujdesin e pyjeve, përsëri nuk janë dhënë të gjitha përgjegjësitë apo kompetencat, që duhet t’i kenë komunat me Udhëzimin administrativ 05/2013, rojtari i

pyllit mbron 500 deri në 1 500 hektarë. Ka roje që ka mbi 2 500 hektarë. Dhe, këtë Agjencia e ka bërë me qëllim dhe nuk ka plotësuar numrin e rojeve dhe i ka dëmtuar komunat, ndërsa i ka mbledhur teknikët e pyjeve, inxhinierët, i ka grumbulluar në Agjenci, kështu që janë dëmtuar komunat, ku edhe u janë dhënë disa përgjegjësi komunave në mbrojtjen e kujdesit për pyje, përsëri nuk janë me tërë përgjegjësitë.

Pyjet nuk ka mundësi të mbrohen kështu me këtë, po edhe duhet të thuhet që ministri i Bujqësisë në vitin e kaluar e ka sjell në Kuvend Projektligjin e pyjeve për miratim, siç thuhet ligj i ri.

Ne në Komision edhe në bazë të analizave të ekspertëve të pylltarisë, që kemi angazhuar, ky ligj ishte i njëjtë me një ndryshim të vogël, sepse i parashihte që pylltarët që janë pa armë, t'u jepte nga një pushkë për të mos u frikësuar kur të hyjnë në pyje dhe asnjë ndryshim më shumë, e linte të njëjtin ligj në vazhdimësi. Ne morëm vendim thuaja unanim në Komision për ta kthyer Ligjin për ndryshime, që duhet t'i përshtatet kohës dhe mundësive për mbrojtjen e pyjeve, sepse ne po e shohim se si është gjendja në pyjet e Kosovës.

Kuvendi në seancën e dhjetorit ia ktheu Ministrisë ligjin për përgatitje dhe tash Ministria na e akuzon Komisionin, se ne kemi lënë pa ligj vendin dhe nëse ky ligj ka qenë mirë i përgatitur, pse Ministria nuk e solli ligjin menjëherë në afat më të shkurtër, por e la përsëri në tetor të na e sjell në Kuvend për miratim?

Kjo tregon se në Ministri kërkohet të vazhdojë kjo gjendje në pyje dhe të shkatërrohen më shumë dhe askush të mos ketë përgjegjësi për dëmet e pyjeve.

Pra, tash me planin për prurjen e ligjeve në Kuvend është paraparë që Ligji për pyjet të vijë në tetor dhe verës t'i provojmë djegiet, ku vetëm se kanë filluar në disa vende të digjen pyjet në prill të këtij viti, në Ferizaj, Shtërpçë e tjerë.

Të nderuar deputetë,

Vetëm vitin e kaluar ka pasur mbi 7 mijë fletëparaqitje për dëmtime të pyjeve. Rreth 3 mijë hektarë pyje kualitative janë djegur në Koretnik të pishave rrobull dhe Deçan. Këto janë shifra alarmante për një vend të vogël, siç është Kosova.

Si pasojë e kësaj kanë dështuar pyllëzimet në afro 900 hektarë sipërfaqe të pyllëzuara. Inspektoratin e Pyjeve në Agjencinë Pyjore përbën konflikt interesi dhe është në kundërshtim me Ligjin e pyjeve nr. 3/L-153 të nenit 12; Ligjin për Inspektoratin bujqësor, nenit 3; Ligjit 029 neni 2 pika 4, me vendosjen e Inspektoratit në mënyrë të paligjshme nga Ministria e Bujqësisë me vendim të sekretarit të Ministrisë.

Të nderuar deputetë, edhe ne si Komision jemi për menaxhimin e pyjeve dhe shfrytëzimit të mirëfilltë të masës drusore për banorët tanë, që ka sasi të mjaftueshme për krejt banorët, po pa keqpërdorime nga kompani të caktuara.

Unë dhe Komisioni, pra ne së bashku duam të mbrojmë sadopak që kemi mundësi, këto pyje tonat, sepse janë pasuri kombëtare dhe janë trashëgimi që na e kanë lënë brezat e që duhet edhe ne t'ua lëmë brezave që po vijnë, ashtu si po i lënë vendet tjera pyjet dhe parqet kombëtare brezave të veta, në vendet e Evropës, që e kemi edhe ne synim Evropën e zhvilluar.

Të nderuar deputetë, ne si komision kemi kërkuar që këto rekomandime të miratohen dhe të jenë të obligueshme për zbatim nëse duam t'i mbrojmë pyjet.

1. Qeveria e Republikës së Kosovës t'i vlerësojë dëmet e pyjeve në Kosovë të shkatërruara gjatë verës së vitit 2012,

2. Kërkohet që Qeveria e Republikës së Kosovës të ofrojë mbështetje financiare në ngritjen e kapaciteteve për mbrojtjen e pyjeve, sidomos gjatë periudhës së verës

Dhe në fund të debatit, jemi të hapur të plotësohet me propozime apo rekomandime tjera, nëse kanë deputetët. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputet! Në emër të Qeverisë, fjalën e ka ministri Blerand Stavileci.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Mirë menaxhimi i qëndrueshëm i tokave pyjore, që në Kosovë kemi gjithsej 464 800 hektarë, ku 60% ose 278 880 janë në pronësi shtetërore dhe 40% ose 185 920 janë në pronësi private, nënkupton administrimin dhe përdorimin e pyjeve në një mënyrë dhe normë e cila ruan biodiversitetin, produktivitetin, kapacitetin regjenerues dhe potencialin për t'i përmbushur funksionet shumëdimensionale, atë ekonomik, social dhe ekologjik, funksione këto, të cilat janë me rëndësi thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e kualitetit të jetesës, posaçërisht në zonat rurale dhe malore.

Prandaj, ne si institucione, pavarësisht se cilit nivel i takojmë, përderisa i konsiderojmë këto funksione si të rëndësishme, duhet të përkushtohemi që t'i ruajmë dhe menaxhojmë në mënyrën më profesionale të mundshme.

Zhvillimet në sektorin e pylltarisë viteve të fundit janë të shumta dhe pas delegimit të kompetencave nëpër komuna, përkatësisht kompetencave për mbrojtjen e pyjeve, dhënien e licencave për prerjen e drunjve në territorin e komunave, roli i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural bazuar në ligjin 03/L-153 është vetëm monitorues.

Mirëpo, problemet me të cilat është ballafaquar nëpër vite ky sektor vazhdojnë të jenë në përmasa të mëdha dhe meqë e kam lexuar arsyeshmërinë e thirrjes së këtij debati parlamentar, po ndalem tek dy çështje që janë me interes për t'u diskutuar bashkërisht.

Me planin vjetor në këtë vit planifikohet prerja e rreth 300 m³ masë drusore, por sasia e prerjeve është nën nivelin e mundësive reale, për faktin se një sasi e konsiderueshme

prehet nga popullata në mënyrë ilegale, si në pyje publike ashtu edhe në ato private. Në këtë kontekst vlen të theksohet se vetëm vitin e kaluar janë ngritur 7 586 fletëparaqitje nga autoritetet lokale dhe Inspektorati i pyjeve për prerësit ilegale, ku 4 854 për kundërvajtje dhe 2 732 për vepra penale, të cilat përfshijnë dëmin prej 24 000 m³ masë drusore dhe prej tyre janë konfiskuar rreth 5 000 m³ nga Inspektorati.

Ngritja e këtyre fletëparaqitjeve është bërë nga autoritetet komunale, pasi që mbrojtja e pyjeve është përgjegjësi e deleguar dhe këtu duhet ta vëmë theksin, kurse raportimi në Agjencinë e Pyjeve bëhet në baza mujore dhe periodike.

Këtu dua të ngre edhe një shqetësim timin personal për dënimet e vogla që shqiptohen nga gjykatat, sepse me ligj mund të shqiptojnë dënime deri në 10 mijë euro, ndërsa ndodh shpesh që kapen prerës ilegale me masë drusore, që kushton deri në njëmijë euro dhe gjobiten me njëqind euro, duke ndikuar kështu jo se jo në parandalimin, por në stimulimin e prerësve ilegale.

Gjithashtu, gjatë gjithë vitit, Inspektorati Qendror i Agjencisë së Pyjeve ka realizuar 1 028 kontrole në subjekte afariste, drejtori regjionale, komuna, si dhe në tregje dhe në qarkullimin rrugor dhe ka konfiskuar mbi 1 000 m³ masë drusore. Ndërsa, me përkrahjen dhe angazhimin e Agjencisë Pyjore të Kosovës janë organizuar takime të shumta me gjykata, me policinë, EULEX-in, kryetarët e komunave dhe inspektorët e pylltarisë, për bashkërendimin e veprimeve, ku vlen të theksohet këtu krijimi i pikave të kontrollit 1 dhe 2 së bashku me policinë dhe autoritetet komunale në Deçan.

Si institucione jemi të vetëdijshme, që duke përdorur ligjin si të vetmin mjet për zvogëlimin e aktivitetëve joligjore, nuk mund të jemi efikas sa duhet, prandaj edhe jemi duke u munduar të praktikojmë një sistem menaxhimi të përbashkët, si dhe ta ngremë vetëdijen e popullatës për rëndësinë shumëdimensionale të pyjeve. Por, normalisht që duhet të rritet edhe efikasiteti i inspektorëve dhe i mekanizmave të tjerë ligjor.

Ndërkaq, çështja e dytë me interes për t'u diskutuar sipas kërkesës dhe me rekomandimin e parë që ju përmendët, është problematika e zjarreve të vitit të kaluar, ku kërkohej të bëhej edhe vlerësimi i dëmeve si rekomandim.

Në vitin e kaluar në zjarre nga më sipërfaqësoret dhe deri tek format më të kombinuara të tyre, janë përfshirë gjithsej 3 487,74 hektarë pyje. Në të shumtën e rasteve zjarret sipas dyshimeve kanë qenë aksidentale dhe të paqëllimshme, si pasojë e djegies së amullorëve, deponive të mbeturinave e kështu me radhë, po në disa raste të tjera kanë qenë të bartura nga pyjet e shteteve fqinje, por gjithashtu nuk përjashtohet edhe mundësia e zjarrvënies së qëllimshme nga persona të papërgjegjshëm.

Dhe thënë të drejtën, përkundër që nuk është kompetencë e Agjencisë së Pyjeve, intervenimi dhe shuarja e tyre, sepse dihet që kjo është fushëveprimtari e zjarrfikësve dhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, punëtorët e Agjencisë janë mobilizuar dhe bashkë me ekipet për shuarjen e zjarreve, duke mos harruar të përmend edhe ekipet e

FSK-së, kanë marrë pjesë në shuarjen e tyre, të cilat assesi nuk kanë mund të futen nën kontroll.

Rregullimi i infrastrukturës rrugore për intervenime duhet të jetë prioritet. Dhe, besoj që edhe këtë çështje si dhe shumë të tjera i kemi diskutuar edhe brenda Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor. Në këtë vit, ne me kapacitetet tona dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kemi angazhuar 90 punëtorë shtesë sezonalë, për vrojtimin dhe parandalimin e zjarreve, ndërsa aktivitetet e lokalizimit dhe shuarjes së tyre janë koordinuar edhe me palët tjera të përfshira me komunat, pra po e them, ku mbrojtja është kompetencë ekskluzive e tyre, si dhe me palët tjera relevante për të mos u përsëritur dëmet e vitit të kaluar, natyrisht që nevojitet një përkrahje më e madhe logjistike dhe një menaxhim më i mirë i emergjencave.

Ka edhe shumë probleme që e shoqërojnë sektorin, që kërkojnë gjithashtu angazhim më të madh, por në këtë sektor, siç e thatë edhe ju e siç e dimë edhe ne dhe në veçanti edhe me dy projektligje, të cilat u apostrofuam, kemi një përzierje edhe më të madhe të përgjegjësisë dhe vetëm me Ligjin e ri për pyjet planifikohet të rregullohen. Mirëpo, veprimtari mjaft e rëndësishme, mos të harrojmë, është edhe pyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura të tokave pyjore, në të cilën është mjaft e fokusuar edhe Agjencia e Pyjeve të Kosovës dhe deri më tani me investimet vetjake janë pyllëzuar rreth 2 800 hektarë tokë pyjore, pra investime diku rreth 1,9 milion euro.

Këto informacione besoj se shërbejnë mjaftueshëm për debatin e sotëm dhe ne si institucion mirëpresim secilin mendim, vlerësim dhe rekomandimet që bëhen nga ju, mirëpo unë e shoh edhe një herë të arsyeshme, atë që ia kam thënë edhe kryetarit edhe anëtarëve të Komisionit, që asnjëherë duke mos dashur t'u ikim përgjegjësisë tona, ato i dimë dhe i pranojmë, por në mënyrë që të ketë edhe ky debat ta japë frytin e vet, duhet që të organizohet një takim dhe besoj që ne jemi të gatshëm, po ashtu edhe Komisioni me të gjithë aktorët relevantë të fushës.

Nuk dua të kuptohet që po e hedhim fajin nga komunat dhe institucionet tjera, po ata janë aktorë të rëndësishëm, sepse ju e dini në qershor të vitit 2010, bile ka qenë një muaj pasi që unë kam marrë mandatin si ministër, në bazë të përgjegjësisë ligjore është dashur pra që ta delegojmë kompetencën e mbrojtjes së pyjeve dhe lejeve për prerjet në komuna. Dhe, edhe përkundër asaj që kjo kompetencë ka shkuar te komunat, zyrtarët e Agjencisë së Pyjeve me insistimin tim dhe të drejtorit përgjegjës, kanë qenë gjatë tërë kohës ne terren, e dini edhe ju këtë, sepse shumë herë ka qenë, i është përgjigjur ftesave tuaja brenda Komisionit, për ta monitoruar punën, për t'u dhënë mbështetje kryetarëve të komunave.

Ne i dimë ato probleme që kanë ekzistuar me numrin e vogël të rojtarëve, të cilat nuk janë adekuate ndoshta për madhësinë territoriale të pyjeve, që ata i mbulojnë, por përsëri po e them që të gjithë punëtorët dhe e tërë logjistika, që ka qenë brenda Agjencisë së Pyjeve në bazë të ligjit, gjithmonë duke respektuar obligimet ligjore, janë deleguar te komunat.

Dhe tash, nëse ato kanë vullnetin dhe duan t'i mbrojnë pyjet ashtu si bëjnë kërkesa për punëtorë shtesë, duhet të bëjnë kërkesa shtesë për punëtorë, pra në këtë sektor. Dhe, u kam thënë edhe kryetarëve të komunave, me të cilët jam takuar dhe gjithmonë e kemi diskutuar këtë problematikë që edhe ne si ministri do t'ju mbështesim, nëse ka nevojë edhe punëtorët tonë shtesë, në mënyrë që të rritet efikasiteti i tyre. Më vjen keq që një pjesë e komunave e ka bërë punën si duhet, një pjesë tjetër nuk e ka bërë punën si duhet, diku kemi përmirësim të gjendjes, diku kemi stagnim, po më e keqja është që diku kemi degradim edhe më të madh të asaj çfarë ka qenë.

Dhe, mos të harrojmë, që menaxhimi jo i mirë në dekadën e parë të pasluftës ka lënë pasojë edhe te ky sektor...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, edhe një minutë ia vazhdoni.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: ...që po e zëmë, një rrugë priset dhe mund pastaj të rikonstruktohet, të rindërtohet, këtu dëmi që është shkaktuar, unë e kam thënë edhe në paraqitjet publike, është një dëm trinomial ekonomik, social dhe ekologjik dhe nuk është i riparueshëm, as për një vit, as për dy vjet. Dhe, ju këtë e dini, prandaj, është momenti i fundit, unë besoj edhe kolegët e tjerë, sepse tash e kemi edhe Ministrinë e Mjedisit, mos të harrojmë, si aktor të rëndësishëm, sepse kështu është me ligjet e reja, ne kemi në dispozicion bashkë me tërë stafin e Agjencisë së Pyjeve, në mënyrë që vazhdimisht të gjejmë zgjidhje. Natyrisht, edhe për ligjin, të cilin e përmendët dhe nëse ekziston ky vullnet, unë besoj që mund ta përmirësojmë gjendjen. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër! Nëse jeni të disponuar, një pauzë deri në orën 14:00 ose ta vazhdojmë... E vazhdojmë! Dakord.

Në emër të Partisë Demokratike, kush e do fjalën? Deputeti Nijazi Idrizi e ka fjalën.

NIJAZI IDRIZI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuari ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pylltaria është vënë në agjendën e prioritetëve botërore, jo vetëm për shkak të rrezikut nga ndryshimet klimatike, por edhe për rolin social dhe ekonomik që ka.

Forumi mbi pyjet i Kombeve të Bashkuara ka miratuar katër objektiva globale, rikthimin e sipërfaqeve pyjore të humbura, rritjen e përfitimeve nga pyjet, rritjen e sipërfaqeve të pyjeve të menaxhuara në mënyrë të qëndrueshme, mobilizimin e burimeve financiare. Këto objektiva janë sfida edhe për Kosovën.

Të nderuar deputetë,

Mbi 40% të Kosovës mbulohet nga pyjet, të cilat shtrihen mbi toka të pëlleshme. Shteti është pronar i rreth 60% të pyjeve më të mira të vendit tonë, të cilat janë problemi kryesor

i pyjeve, ndërsa rreth 40% janë private, të cilat përkundër vështirësive të shumta menaxhohen më mirë dhe janë furnizuesit kryesor legalë të popullsisë, me dru zjarri.

Studime të ndryshme kanë konstatuar një nivel të lartë të përdorimit të drurit për ngrohje nga familjet tona, që bie të jetë edhe deri në dhjetë herë më i lartë se prodhimi legal i drurit, të cilin aktualisht e raportojnë institucionet përgjegjëse. Kjo diferencë merret ilegalisht nga pyjet, duke lënë pasojë afatgjatë në rreth 70% të tyre, të cilat kanë nevojë për masa të përmirësimit.

Të gjithë e vlerësojnë popullsinë lokale si problemi kyç për këto prerje ilegale. Konsumatorët e druve jetojnë kryesisht në zona rurale. Ata janë të punësuar, krijojnë të ardhura ekonomike dhe e garantojnë mirëqenien për familjet e tyre nga pyjet, me të cilët kanë jetuar nëpër kohë, duke dhënë e marrë njëri tjetrit aq sa u është dashur.

Sfidë janë familjet, që nuk disponojnë me pyje të vetat dhe kanë të njëjtat nevoja, të cilat i plotësojnë me rrugë ilegale të pylli, të pylli i shtetit. Këto banorë pa tokë pyjore janë privuar nga mundësia, që të kontribuojnë për rritjen e pyllit dhe për furnizimin legal të familjeve të tyre me dru për ngrohje, edhe pse jetojnë pranë tyre.

Të nderuar deputetë,

Për pyjet ne paguajmë taksa për t'i shfrytëzuar ato në mënyrë të qëndrueshme, sipas potencialit që kanë me përfitim e jo taksat e ndara nga buxheti i familjeve tona të shpenzohen, duke paguar metrin e druve deri në 90 euro, sa e paguam në këtë dimër që shkoi, për shkak të acarit të madh që kaploi vendin tonë.

Në të vërtetë, kjo i bie se njerëzit tanë paguajnë taksa për ta privuar veten e tyre nga shfrytëzimi i potencialit të pyjeve. Për më keq, kjo i bie edhe për të rënë rreth deri në 10 mijë qytetarë për çdo vit në konflikt me ligjin, pse duan që t'i plotësojnë nevojat e tyre që janë nevoja më elementare të jetës atë të ngrohjes së vatrave të tyre, që është radhitur si nevojë ekzistenciale. Përpjekje për t'i plotësuar politikat, bazën ligjore dhe menaxhimin e kësaj pasurie kombëtare ka pasur vazhdimisht, por arritjet nuk janë të kënaqshme.

Shteti me 60% të pyjeve më të mira kontribuon vetëm me 22% të prodhimit vjetor të drurëve, rreth 34 000 m³ vitin e kaluar, ndërsa pronarët privatë me 40% të sipërfaqes, kryesisht me pyje të ulëta sigurojnë rreth 78% të prodhimit vjetor legal të drurëve. Këto janë statistika të vitit 2012.

Për 14 vjet me radhë është harxhuar shumë buxhet, energji njerëzore e studime, për ndërprerjen e prerjeve ilegale, si nga Qeveria, donatorët dhe gjykatat, por ne nuk kemi arritur asnjë rezultat. Kjo ka ndodhur, sepse është punuar mbrapshtë. Ne vend se ky mund të derdhej për planifikimin dhe zbatimin e prerjeve legale, ka ndodhur e kundërta.

Kjo është arsyeja, që debati për prerjet ilegale në pyje është përherë i pranishëm. Ky debat na ka çuar deri në absurd, sa e ka mashtruar shtetin që në përpjekje për t'i ndaluar prerjet ilegale, u ka vendosur pushkë në supe rojeve të pyllit.

Edhe kjo përpjekje ka dështuar dhe ka rezultuar me acarimin e panevojshëm të raporteve të shtetit me popullin, ndërsa të gjitha këto eksperimente i kanë paguar pyjet e Kosovës, të cilat po vazhdojnë të degradohen dhe të shkatërrohen. Nga emocionet pakkush është kujtuar, se mbrojtja e pyjeve me pushkë është metodë bolshevike. Në shtetet demokratike pyjet mbrohen me dije.

Edhe përpjekjet për reformim e ndryshim kanë qenë të vazhdueshme. Ligji i pyjeve i vitit 2003 ka qenë gjithmonë objekt kritikash dhe përmirësimesh. Me decentralizim komunave iu është deleguar mbrojtja dhe prerjet e pyjeve. APK-së i është lënë e drejta e planifikimit vjetor dhe e kontrollit. Që atëherë akuzat e ndërsjella vazhdojnë dhe situata në pyje është keqësuar.

Me mbështetjen e donatorëve është hartuar strategjia për periudhën 2010 - 2020. Shumë investime janë bërë për të hartuar plane menaxhuese afatgjata për pyjet publike, madje edhe për zonat e mbrojtura, të cilat po vjetrohen pa u zbatuar asnjëherë. Po ashtu, janë investuar shumë para për pyllëzimet e tokave publike, mirëpo rezultatet e këtyre investimeve nuk po duken askund.

Të nderuar deputetë,

Perëndimi në vitin 1848 e ka zbatuar reformën mbi tokën pyjore, të cilën ia ka dhënë fshatarit për t'i përmbushur nevojat e tij. Kjo reformë nuk është zbatuar në territoret e pushtuara nga Perandoria Osmane. Reforma sot e kohës së pushtimit ua mori pyjet pronarëve shqiptarë, duke përdorur kritere politike. Ne sot për këto shkaqe po përballemi me ankesa nga banorët e Rugovës, të cilët janë të interesuar që t'i kthejnë pronat e tyre, të cilat vërtet u takojnë. Pra, Kosova ende nuk e ka përfunduar reformën për të drejtat mbi tokën pyjore.

Për të dalë nga kjo gjendje kërkohet nga Qeveria, që ajo urgjentisht të ndërmarrë një reformë të thellë, e cila duhet të japë efekte shumëqëllimore, si në dimensionin mjedisor edhe në atë social e ekonomik.

Sfida jonë është që sloganin botëror “pyjet për popullin” ta kthejmë në realitet. Kjo kërkesë nga institucionet do angazhim serioz, për të analizuar traditën tonë të menaxhimit në pyje, për t'i deleguar përgjegjësitë e menaxhimit te komunat dhe popullsia lokale, duke i qartësuar të drejtat dhe detyrimet pronësore.

Unë e konsideroj popullin tonë si zgjidhje të mundshme të këtij problemi. Ne duhet të guxojmë dhe t'i delegojmë te ai të drejtat dhe përgjegjësitë. Ai nuk mund të mbetet hajdut i pronës së vet, ai nuk duhet të ndahet nga pylli i tij, rreth të cilit e ka ndërtuar shtëpinë e vet dhe ka jetuar me të nëpër shekuj. Atij nuk bën t'ia fusim armën në fyt, përkundrazi ai duhet të angazhohet që ta luajë rolin që i takon, duke u përfshirë në menaxhimin e kësaj pasurie kombëtare.

Për më mirë, kjo reformë është në harmoni me politikat evropiane të zhvillimit të pyjeve, të cilat synojnë që pyjet t'ua kthejnë njerëzve, për t'i vënë në shërbim për plotësimin e nevojave të tyre dhe rritjes së mirëqenies.

Të nderuar deputetë,

Për në fund, dëshiroj që të jap disa rekomandime, të cilat shpresoj se do të merren parasysh nga vendimmarrësit.

1. Të iniciohet sa më shpejt hartimi i një reforme për pylltarinë, e cila duhet t'i ketë parasysh tri dimensionet e përmendura;
2. Të harmonizohet baza ligjore, në të cilën do të definohen saktë rolet dhe përgjegjësitë e menaxhimit në mes të niveleve qendrore dhe të dy niveleve të qeverisjes, atij lokal dhe qendror;
3. Të definohen me ligj pronarët e pyjeve të Kosovës, cila nga ministritë, komunat apo privat;
4. Plani strategjik duhet të harmonizohet me planet operationale të prerjeve, për t'i harmonizuar nevojat e popullsisë për dru me potencialin prodhues të pyjeve dhe të obligohen të gjithë pronarët e pyjeve, pa dallim, që t'i zbatojnë këto plane;
5. Ligji i ri i pyjeve duhet t'ua njohë pronarëve pronësinë, shtetit rolin e hartimit të politikave, kompanive profesionale menaxhimin, administratës publike kontrollin e zbatimit të ligjit dhe qytetarëve përfitimin;
6. Pyjet në zonat e mbrojtura në malin Sharr dhe në Bjeshkët e Nemuna të menaxhohen nga pronarët duke i respektuar standardet e Bashkimit Evropian për zonat e mbrojtura;
7. Të ngrihet një sistem arsimor i mesëm dhe universitar për edukimin e ekspertëve për pyjet;
8. Të ngrihet infrastruktura fizike për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe mbrojtjen e tyre nga fatkeqësitë natyrore, zjarret, stuhitë e tjera;
9. Të zbatohen rekomandimet e strategjisë për menaxhimin e pyjeve në partneritet publiko-privat për përfshirjen e të interesuarve që kanë kapacitete në menaxhimin e pronave publike;
10. T'u hiqen armët rojeve të pyjeve dhe të aplikohen shërbimet këshillimore për rojet e pyjeve dhe për gjithë shfrytëzuesit e tyre;
11. Të obligohen shfrytëzuesit e pyjeve, që biomasën e pyllit ta largojnë nga pyjet dhe të subvencionohen nga shteti të gjithë ata që e shfrytëzojnë për përpunimin e saj dhe këtë biomasë e shndërrojnë në bioenergj. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë! Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Salih Morina e ka fjalën.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Lidhja Demokratike e Kosovës gjendjen e pyjeve në Kosovë e sheh si shqetësuese, sidomos në sektorin publik, ku 60% e sipërfaqes së pyjeve i takon këtij sektori.

Prerja dhe transportimi i paligjshëm i drurëve bëhet në shumë mënyra në Kosovë, përfshirë prerjen dhe transportimin pa leje nga pyjet publike, prerjen dhe transportimin e drurëve nga zonat e mbrojtura, si dhe përmes deklaratimit të rrejshëm të vëllimit të drurëve të prerë.

Pyjet në Kosovë ofrojnë një skemë jo të mirë, ku mund të zhvillohet korrupsioni, krimi i organizuar, kontrabanda dhe shkatërrimi mjedisor, në përgjithësi.

Sipas Agjencisë së Pyjeve në Kosovë thuhet se 42% e Kosovës është e mbuluar me pyje. Diku rreth 32 apo 40% e kësaj sipërfaqeje është në prona të pronarëve të vegjël, ndërsa mbi 60% është në pronësi publike. Sipas një inventarizimi të kryer nga grupi pyjor i Norvegjisë, prerja dhe transportimi i pakontrolluar i drurëve bëhet në 35% të sipërfaqeve pyjore në Kosovë.

Ndërsa, sa i përket vëllimit të drurëve të humbur përmes praktikave të paligjshme, vlerësohet se në vit humbin mbi 100 000 m³. Andaj, mungesa e kapaciteteve nga ana e Ministrisë së Bujqësisë dhe aktorëve tjerë, për të mbrojtur pyjet janë të cenueshme, ku faji bartet prej Ministrisë në Agjencinë e Pyjeve dhe prej Agjencisë së Pyjeve, në komunat. Pra, ne si Komision kemi ftuar të gjithë aktorët, për të sqaruar problemin e kompetencave, të cilat janë bartur me ligjin e fundit, i cili është ende në fuqi.

Bartja e kompetencave prej nivelit qendror në nivelin lokal ka qenë shqetësuese për nivelin lokal, për shkak se nuk kanë kapacitete menaxhuese, sepse sfidat janë trashëguar nga një staf i pakualifikuar, si të rojave të pyllit dhe stafit tjetër menaxhues.

Komunat kanë pranuar kompetencat e ofruara nga ligji, pa ditur mirë problemet si dhe në çfarë gjendje janë pyjet dhe me një inventarizim formal. Pra, sfidë tjetër për të cilën është thirrur debati është degradimi apo shkatërrimi i pyjeve nga ana e zjarreve dhe me të drejtë Komisioni Parlamentar për Bujqësi dhe Mjedis, kërkon, në radhë të parë nga Ministria e Bujqësisë, si dhe institucionet tjera relevante, të cilat kanë lidhur edhe marrëveshje memorandumit si me Ministrinë e Punëve të Brendshme, të merren të gjitha masat parandaluese me qëllim të ruajtjes së pyjeve nga zjarret në përgjithësi, sepse siç e tha edhe kolegu tjetër, tashmë ato kanë filluar gjatë këtij muaji dhe e rrezikshme është muaji korrik dhe muaji gusht.

Besohet, se në disa prej zjarreve në pyjet, të cilat paraqesin rrezik të vërtetë edhe për fshatarët dhe jetën e njerëzve, janë ndezur nga prerësit e paligjshëm të drurëve, të cilët përpiqen t'i fshehin gjurmët e tyre. Pra, gjatë vitit që lamë pas në Kosovë janë përfshirë shumë pyje me zjarre dhe vlen të theksohen dy regjionet, regjioni i Prizrenit në komunën e Sharrit dhe po ashtu regjioni i Pejës në komunën e Deçanit. Pra, në total nga raporti të cilin e ka sjellë Agjencia e Pyjeve, thuhet se gjatë vitit 2012 janë djegur mbi 3 487 hektarë pyje.

Prandaj, është shumë shqetësuese dhe ne kërkojmë nga aktorët përgjegjës, në radhë të parë kërkojmë nga Ministria e Bujqësisë, kërkojmë nga Agjencia e Pyjeve dhe kërkojmë nga komunat, që të marrin hapat e duhur, do të thotë në kohën e duhur, në momentin e duhur, që të bëhet parandalimi i djegies së pyjeve në përgjithësi. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Liburn Aliu.

LIBURN ALIU: Faleminderit, kryetar!

Gjendja e pyjeve në Kosovë vazhdon të jetë e rëndë. Kjo fjali përsëritet vit pas viti dhe ky konstatim i vazhdueshëm vajtues, nga të gjithë po shoqërohet në fakt me përkeqësimin e vazhdueshëm.

Organizata norvegjeze Norwegian Forestry Group (NFG) në një raport të saj vitin e kaluar tregon për një fond të varfëruar të masës drusore në pyjet e Kosovës, lart nën mesatare.

Kjo organizatë raporton për prerjet ilegale, të cilat përfshijnë 56% të rritjes vjetore, në ndërkohë që realizimi i prerjeve të planifikuara, sado që vit pas viti synon të zvogëlohet, të jetë më real si ta quajmë, ai është prapë i paarritshëm. Pra, kur bëhet fjalë për prerje të planifikuara këtu kemi një dështim të plotë. Në ndërkohë që dëmtimi i pyjeve nga prerjet është në rritje dhe kjo në mënyrë epidemike bartet nga njëri masiv pyjor në tjetrin.

Nëse deri tani dominonte Deçani, Peja, Istogu, për nga prerjet ilegale dhe Sharri konsiderohej pasuria pyjore që po ruhet e po zhvillohet, viti që shkoi dhe ky vit po përbën një ndryshim të situatës edhe atje, pra tash edhe atje priten pyjet edhe atje dëmtohen ato. Edhe atje kanë filluar dëmet, duke filluar që nga pjesa e komunës së Therandës, ku pyjet, qoftë jashtë e qoftë brenda parkut nacional, priten dhe ku këto pyje janë duke u futë në dukuri kohëve të fundit, pra gjatë këtij viti.

E njëjta situatë tani po vazhdon edhe në komunën e Sharrit, ku vitin që shkoi u përfshi nga zjarri një sasi enorme e pyjeve të rrobullit, ku zjarret për disa ditë rresht nuk arritën të ndalen. Dhe, tani në këtë zonë ka filluar prerja. Ka filluar prerja aty, ku deri më tani konsiderohej se është një zonë e cila ka mbetur një pasuri e paprekur, siç janë edhe shumë zona të tjera të Sharrit, të cilat do të kërcënohen edhe gjatë viteve në vijim, qoftë nga prerjet apo qoftë edhe nga industria apo planet e shumta, që parashihen të bëhen brenda këtyre hapësirave.

Nga raportet e shqyrtuara del, se prerjet ilegale kryesisht vijnë nga prerës të organizuar dhe kjo bëhet në tejkalime të prerjeve të planifikuara. Në emër të pastrimit ndodh prerje masive, në emër të prerjes së paraparë me tender ndodh prerja e papaparakë përtej planit. Kamionët transportojnë lëndë drusore nga pyjet halore, në ndërkohë që prapa mbetin mbetjet të cilat shndërrohen në burim të djegieve, në burim për zjarret dhe në burim për sëmundjet.

Si pasojë e këtyre tejkalimeve dhe teprimeve që kanë ndodhur në prerje edhe Agjencia Qendrore Pyjore e Kosovës u detyrua të bënte pezullimin në vitin që shkoi, ngase u dëshmuar dhe dolën sheshit si rezultat i inspektimeve të shumta edhe prerje e tejkalime të mëdha në prerje.

Situatë e rëndë, po ashtu mbetet edhe në pjesët tjera të Kosovës, atje ku nuk janë vetëm halore, pra nëse mund të vizitohet Jezerca e Ferizajt, do të shohim që atje ka ndodhur një katastrofë nga prerjet e po ashtu edhe Kaçaniku e shumë zona të tjera, ku prerjet janë shndërruar në një dukuri të vazhdueshme, e cila nuk po arrin të ndërpritet.

Në anën tjetër, kemi një tentativë për një pyllëzim, e cila mbetet një tentativë e dështuar ku të gjitha sipërfaqet e pyllëzuara realisht nuk po mund të jenë të suksesshme, meqenëse pyllëzimi po dështon pasi që nuk po mund të zhvillohen ato fidanë të mbjella. Dhe tash, ku ta gjejmë ne fajtorin për këtë situatë?

Në një anë e kemi sistemin, i cili po presim që të reformohet vazhdimisht, pra që nga viti 2011, jemi në pritje të një ligji të ri që do të vijë. Dhe, ky proces vazhdimisht na zvarritej dhe në fund erdhi një ligj, i cili nuk ka të bëjë me një sistem të ri, ndryshim të sistemit, por synon ta përsërisë situatën e njëjtë.

Çka kemi aktualisht në sistemin e pyjeve, në menaxhimin e pyjeve në Kosovë? Kemi nivele të tepërta, të cilat i mbivendosen njëra-tjetrës, të cilat ndërthuren në kompetenca me njëra-tjetrën dhe të cilat në fakt e shndërrojnë një kaos, ku prerja e pyjeve vazhdon dhe nuk mund të ndalet. Kemi nivelin e komunës, kemi nivelin regional të Agjencisë të Pyjeve të Kosovës, kemi Ministrinë, kemi bordin në Kryeministri dhe të gjitha këto ndajnë kompetenca të ndryshme, punësojnë njerëz të ndryshëm, por situata mbetet po e njëjta.

Në anën tjetër, te niveli i Agjencisë të Pyjeve e kemi të vendosur brenda tij Inspektoratin. Realisht, kemi një shtim të kompetencave në nivelin komunal, ndërsa inspektorati i cili do të duhej që këtë shtim të kompetencave në nivelin komunal ta kompensonte me një kontroll të centralizuar nga ana e Ministrisë, këtu në këtë rast inspektoratin e kemi të decentralizuar nga ministria, pra komplet Inspektoratin e kemi të vendosur në Agjencinë e Pyjeve, i cili njëkohësisht bën edhe planet menaxhuese dhe ndërton përmes nivelit regional, i cili në fund të fundit është antikushitetues, marrëdhënien e drejtpërdrejtë me komunat, në ndërkohë që e ka në dorë edhe Inspektoratin, që s'është asgjë tjetër, përpos një konflikti interesi.

Në lidhje me këtë çështje Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Planifikim Hapësinor dhe Mjedis, ka bërë përpjekje vazhdimisht të organizojë debate e diskutime të ndryshme, madje edhe kemi pas dëgjim publik.

Temë kryesore e të gjitha këtyre diskutimeve kanë qenë, pikërisht sistemi dhe reforma në sistem. Me të gjithë kemi diskutuar, se si duhet të ndryshojë dhe të thjeshtësohet ky sistem. Kemi pasur edhe vizitë në Austri, ku ekspertët të cilët kanë qenë njëkohësisht edhe ekspertë në Ministri, na e kanë sugjeruar të njëjtën gjë, pra, duhet të ndryshojë sistemi dhe për këtë ndryshim edhe vetë ministri, edhe vetë ministria është plotësisht e vetëdijshme se është më se i domosdoshëm.

Po çka ndodhi? Tani kur u prit të vinte ligji i ri, pra projektligji nga Ministria me këto ndryshimet e nevojshme, pas zvarritjeve të shumta na erdhi një ligj, i cili nuk bën asgjë tjetër, veçse e vazhdon situatën e njëjtë. Dhe, natyrisht ne si Komision e kundërshtuam dhe bëri mirë, që edhe Kuvendi e ktheu mbrapshtë.

Pra, ardhja e këtij ligji i cili nuk sjell ndryshime, në fakt tash ministrin e bën pjesë të këtij sistemi. Ndoshta, do të doja që i tërë faji të mbetet tek AKP-ja apo tek nivelet tjera, t'i

fajësonim, mirëpo ardhja e projektligjit, i cili nuk sjellë ndryshime në këtë situatë, e përfshinë plotësisht edhe ministrin.

Nga ana tjetër, e kemi Ligjin për parqet nacionale, ku temë diskutimi e madhe është bërë çështja e pronave, ku natyrisht, çështja e pronave duhet të zgjidhet dhe pronat duhet t'u kthehen pronarëve. Dhe, për sa i përket parkut nacional zonat strikte nuk guxojnë të ndërtohen në prona private. Nëse ato duhet domosdoshmërisht të bëhen të tilla, atëherë ato duhet t'u kompensohen pronarëve, ndërsa ekzistojnë zona të dyta dhe të treta, të cilat nuk ndryshojnë thellësisht nga situata aktuale.

Pra, qytetarët atje do të mund të vazhdojnë ende të shfrytëzojnë pyjet dhe pronat e tyre, që i kanë brenda parkut nacional. I vetmi dallim bën që nga parqet nacionale janë hequr tenderët, gjë që në njëfarë mënyre bën që këto pyje të mbrohen nga shteti, pasi që nga shteti janë më shumë të rrezikuara se sa nga vetë qytetarët e thjeshtë, ku prerjet ilegale nga qytetarë të thjeshtë nuk përbëjnë realisht rrezikun real. Rreziku real për to është prerja masive, e cila lë pas vetes dëmet dhe mbetjet e shumta, të cilat sjellin pastaj zjarr dhe sëmundje të ndryshme.

Sa u përket rekomandimeve të Komisionit, unë mendoj që rekomandimet duhet të plotësohen, duhet të plotësohen lidhur me ligjin dhe ne duhet këtu t'i kërkojmë ministrit, që të na sjellë ligjin sa më shpejtë. Ne natyrisht, përherë kemi qenë të gatshëm të diskutojmë dhe këtë e kemi bërë. Kemi organizuar dëgjime publike dhe kemi diskutuar vazhdimisht dhe kemi shpresuar dhe kemi pritur, në fund madje, kemi pasur pritje që si rezultat i këtyre diskutimeve do të na vijë një projektligj tjetër. Por, ne jemi prapë të gatshëm të vazhdojmë këto diskutime dhe të vijmë në fund deri te një projektligj, i cili do ta ndalojë prerjen ilegale dhe në fakt, do ta bëjë zhvillimin e pyjeve.

Nëse sot kemi masë të varfër drusore nëpër pyjet tona, ne duhet të kemi një plan shumë të qartë për zhvillimin e pyjeve tona, për vitet e ardhshme.

Sa u përket pyjeve në fund të fundit ato janë pasuri nacionale dhe nuk duhet që mbrojtja e tyre të mbetet vetëm si kompetencë e komunave, pasi që e kemi parë vjet se si Koretniku, kur mbetet në kompetencë të komunës së Sharrit me ato kapacitete tejet të vogla, se çfarë ndodhë. Pra, kjo çështje duhet të jetë nën kompetencë qendrore...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Vazhdojmë. Në emër të Grupit të Aleancës, deputetja Time Kadrijaj e ka fjalën.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Menaxhimi me pyjet dhe resurset pyjore të Kosovës gjatë historisë i është nënshtruar zhvillimit të sistemeve politike dhe shoqërore. Luftërat përgjatë historisë, konfliktet, krizat politike, ekonomike dhe sociale, kanë ndikuar në dëmtimin e pyjeve dhe resurseve pyjore deri në degradim të sipërfaqeve të tëra pyjore dhe resurseve tjera natyrore.

Mjerisht, edhe sot e kësaj dite kujdesi dhe qeverisja ndaj pyjeve dhe resurseve pyjore nuk kanë gjet vend merit. Këto resurse me rëndësi ekonomike, sociale dhe mjedisore po vazhdojnë të shkatërrohen nga prerjet ilegale, zjarret pyjore, sëmundjet dhe dëmtuesit pyjor, duke përfshirë edhe dëmtimin e llojeve të rralla dhe të rrezikuara të florës dhe faunës.

Edhe pse Ministria e Bujqësisë dhe Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nëpërmjet Agjencisë Pyjore të Kosovës dhe Departamentit të Pylltarisë si dhe drejtorive përgjegjëse komunale, kanë ndërmarrë disa aktivitete, dëmtimi i këtyre resurseve po vazhdon.

Në bazë të shënimeve nga Riinvest dhe organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, në vit prehen rreth 550 000 m³ në mënyrë jo ligjore, të shndërruara në vlerë monetare i bie që Buxheti i Kosovës më së paku humb rreth 5,5 milionë euro në vit.

Dëmet tjera llogaritet të jenë shumë më të mëdha, si shkatërrimi i strukturës pyjore, ndotja e ujërave dhe mjedisit, shkaktimi i erozionit e dëme të tjera të pariparueshme. Gjendja alarmuese ekziston në dëmtim të pyjeve dhe tokave pyjore me ekzistimin e numrit enorm të gurore, duke mos përfillur zgjedhjen e terreneve dhe duke sjellë dëme shumë të mëdha në pastrimin e rrjedhave të lumenjve, shkatërrimin e pyjeve, shkaktimin e erozionit, duke përfshirë dhe rrezikimin e shëndetit të njerëzve nga zhurma dhe pluhuri që shkaktohen gjatë punimeve dhe transportit të materialit tjetër.

Është fakt, se ekzistojnë gurëthyes edhe brenda parqeve kombëtare dhe vendeve të shpallura si zona me vlera të veçanta ekologjike. Edhe përkundër ekzistimit të akteve ligjore dhe nënligjore mbi kriteret dhe obligimin e revitalizimit të sipërfaqes pas përfundimit të punëve, në praktikë nuk ekziston asnjë rast i revitalizimit, i kthimit të gjendjes së mëparshme të sipërfaqeve të shfrytëzuara për gurore.

Organet përgjegjëse për administrim dhe menaxhim të pyjeve dhe tokave pyjore dhe kontrollim të menaxhimit, fokusin kryesor e kanë orientuar në fajësimin e ministrive tjera, organeve gjyqësore, shërbimit policor, organeve komunale e institucioneve tjera, duke mos u marrë me hartimin e politikave dhe strategjive pyjore me interes të popullatës dhe vetë pyllit.

Po theksoj, se nevojat e popullatës për dru për ngrohje dhe nevojave tjera familjare, sipas dokumenteve të prodhuara nga ndërkombëtarët, në bashkëpunim me ministrinë, janë rreth 1,5 milion m³ në vit, kurse Agjencia Pyjore në planet e veta planifikon të priten rreth 230 mijë m³ dru në vit në pyjet shtetërore dhe pyjet private.

Strukturat menaxhuese dhe delegimi i disa kompetencave të organeve komunale, shumë herë po shfrytëzohet si alibi i dëmtimit të pyjeve nga të dyja palët, duke e fajësuar njëra-tjetrën. Ekzistojnë modele të ndryshme të strukturave menaxhuese të pyjeve dhe tokave pyjore. Ka modele kur komunat menaxhojnë me pyje, kurse organi përgjegjës i Qeverisë qendrore ka rol rregullativ dhe kontrollimi dhe monitorimi i menaxhimit të pyjeve në pronësi shtetërore dhe pronësi private.

Ka mjaft shembuj të menaxhimit të pyjeve nga agjencitë shtetërore, shërbimet pyjore me delegimin e disa të drejtave në organet lokale, veçanërisht në plotësimin e nevojave dhe shfrytëzimin e të mirave pyjore nga komuniteti i cili është i lidhur me pyjet dhe resurset pyjore.

Përkitazi me shpalljen e parqeve kombëtare dhe brengat e popullatës, përkitazi me pronën e tyre private, AAK-ja mendon se nevojitet shpjegim shtesë tek pronarët dhe banorët e ndikuar nga shpallja e parqeve kombëtare mbi të drejtat dhe kufizimet e shfrytëzimit të pronave të tyre. Pronarët duhet detajisht të njoftohen, se cilës zonë të mbrojtjes u përkasin pronat e tyre dhe cilat janë kufizimet dhe të drejtat e shfrytëzimit të pyjeve, kullosave, tokave bujqësore e tjerë.

Shumë shtete pas arritjes së pëlqimit me banorët e ndikuar nga zonat e mbrojtura aplikojnë nënshkrim të kontratës me pronarët e pronave private. Në anën tjetër, nevojitet interpretim më detaj i akteve ligjore, si Ligji për mbrojtjen e natyrës dhe ligjeve për shpalljen e parqeve kombëtare, si dhe interpretim të drejtë ligjor të kriterëve të IUCN-së, direktivave dhe konventave tjera lidhur me menaxhimin e zonave të mbrojtura. Këto akte ligjore dhe ndërkombëtare në disa raste interpretohen dhe paraqiten më rigorozë, se sa janë në realitet.

Të nderuar deputetë,

Për të mos hyrë në detaje tjera, po theksoj se jo efikasiteti në menaxhimin e pyjeve dhe tokave pyjore, mungesa e politikave pyjore të mirëfillta, gërshtimi i përgjegjësive në mes të ministrive të linjës dhe ministrive me organet komunale, kanë shkaktuar përveç tjerash këtë gjendje:

- Mungesën e mbledhjes së të hyrave nga shitja e masës drunore,
- Aplikimi informal i lejeve,
- Shfrytëzimin e pyjeve,
- Tregun jotransparent dhe joeficient të materialit drunor,
- Jo shfrytëzimi i mbetjeve drunore, posaçërisht aty ku ndodhin prerjet ilegale,
- Jo shfrytëzimi i prodhimeve jo drunore, bimëve mjekuese, bimëve aromatike dhe frutave pyjore,
- Mungesa e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret, sëmundjet dhe dëmtuesit.

Andaj, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, propozon krijimin e bazës ligjore për fillimin e procesit të denacionalizimit të pyjeve dhe tokave pyjore; caktimin e synimit të përqindjes së pronës pyjore në Kosovë; caktimi i politikave pyjore përkitazi me ndarjen e pyjeve sipas rëndësisë: pyjet ekonomike, pyjet me karakter mbrojtës, pyjet me karakter historik, zonat e mbrojtura, e tjerë. Caktimi i metodës së trajtimit të tipave pyjore të caktuar dhe periudha e arritjes së objektivit; rritja mesatare pyjore e synuar në nivel vendi; caktimi dhjetëvjeçar i sipërfaqeve për pyllëzim dhe ripyllëzim duke caktuar llojin e fidanëve dhe përdorimin e tyre.

Duhet theksuar, se pyllëzimet të cilat bëhen për çdo vjet, përveç dështimit të suksesit të fidanëve të mbjella mungon dhe studimi përkatës i llojit të fidanëve drunor dhe qëllimi i selektimit të këtyre llojeve pas rritjes.

Planifikimi dhjetëvjeçar i mbrojtjes së pyjeve nga sëmundja dhe dëmtuesit pyjor, inventarizimi i sëmundjeve, sipërfaqja që do të përfshihet dhe propozim masat duke përfshirë koston e përgjithshme. Caktimi i objektivave të politikës zhvillimore pyjore do të ndihmonte në zhvillimin strategjik të këtij sektori dhe ndalimin e veprimeve dhe aktiviteteve të tjera ad hoc. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, zoti Glauk Konjufca.)

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën tash, në emër të Koalicionit Kosova e Re e ka deputetja Sevdije Lama.

SEVDIJE LAMA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër Stavileci,

Të nderuar deputetë,

Rreth 42% të territorit të Kosovës janë sipërfaqe pyjore të cilat gjatë viteve të fundit kanë qenë cak i krimit ekonomik. Të 465 mijë hektarë me pyje shtrihen kryesisht në brezin kufitar të Kosovës, përkatësisht në komunat perëndimore, Istog, Pejë, Deçan, Junik e deri në Gjakovë me rreth 50% të masës drusore të pyjeve, përkatësisht me rreth 52 milionë m³ dru, ku rreth 60% janë pyje publike dhe 40% pyje private.

Kjo është një pasuri e madhe e Kosovës. Kjo sipërfaqe i është ekspozuar për vite të tëra shfrytëzimit të pakontrolluar nga grupe të ndryshme dhe individë, të cilët kanë formuar mekanizëm të fuqishëm ilegal, për prerjen dhe transportin e masës drusore.

Janë ngritur diku rreth 8 000 padi penale dhe kundërvajtje, ku nuk janë shqyrtuar nga ana e gjykatësve dhe prokurorëve, për qindra metër kub dru të prera dhe mund të thuhet se ky është një motivim për prerësit ilegal të pyjeve, që vazhdojnë punën e tyre pa u trazuar.

Përpjekjet e Agjencisë për të ndërprerë prerjet ilegale kanë qenë të mëdha dhe të vazhdueshme, pothuajse ditën dhe natën, por sfidë mbetet planifikimi i prerjeve dhe zbatimi i tyre sipas potencialit që kanë pyjet.

Sfidë tjetër mbetet mbrojtja e pyjeve nga shkatërrimi dhe zjarret dhe shkaktarët e vënies së këtyre zjarreve. Po ashtu, problem tjetër është niveli komunal, i cili përballet me mungesë të stafit, të automjeteve, e tjera.

Në anën tjetër, Ligji për parqet nacionale edhe më tepër i ka thelluar problemet, nga se nuk është harmonizuar me Ligjin e pyjeve.

Prandaj, rekomandojmë që Qeveria dhe komunat të marrin masa për mbrojtjen dhe kultivimin e pyjeve, duke mos lejuar të keq menaxhohen dhe në emër të pastrimit të pyjeve, të shkatërrohen sipërfaqe të tëra të pyjeve, siç janë shkatërruar deri më tani. Të

identifikohen arsyet e këtyre prerjeve, qofshin sociale apo komerciale dhe të merren masa, sepse humbjet që i shkaktohen Buxhetit të Kosovës janë rreth 10 milionë euro në vit. Dhe, si mund të zëvendësohet gjithë ajo masë drusore, ku edhe po të ripyllëzohen duhet vite për t'u kthyer në gjendjen e mëparshme, ngase ky është një dëm i madh ambiental dhe ekonomik njëkohësisht? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Këtu në elektronikë po thotë, që Biserka Kostiq do të flasë në emër të SLS-it, por me siguri tash e përfaqëson këtë grupin e ri Për “Ardhmërinë e Përbashkët”, apo jo?

Fjalën e ka deputetja Biserka Kostiq.

BISERKA KOSTIĆ: Zahvaljujem potpretsedničke!
Danas ću govoriti u ime Poslaničke grupe Zajednička Budućnost.

Šume na Kosovu pokrivaju oko 60% teritorije Kosova i to kao rezultat klimatskih i hidrografskih promena, koje su uticale na raznovrsnost sveta biljaka i životinja. Sve javne šume na Kosovu su nacionalno bogatstvo, koje je zaštićeno zakonom.

Odgovornost za upravljanje ovim sektorom šuma obuhvatajući zaštitu aktivnosti pošumnjavanja, prevenciju i zaštitu od požara, desinfekciju od insekata i raznih bolesti odgovorno je zapravo Agencija Šumarstva Kosova, koja pored ostalog izdaje dozvole i licencu za seču stabla.

Kada govorimo o šumama na Kosovu, ne možemo a da ne nabrojimo vrste koje su najrasprostranjenije u ovom trenutku a to su: hrastove šume, jela, kanadski brest, beli bor, crni bor, bagrem, breza, bela breza, kesten, i ostalo. Na Kosovu postoje dve vrste šuma. Šume koje su državno vlasništvo, kao i šume u privatnom vlasništvu. Ali za sve šume Kosova možemo da kažemo da je to nacionalni resurs i njime se mora upravljati na takav način kojim se obezbeđuje značajan prinos a u isto vreme čuva raznolikost vrsta u korist sadašnjih i budućih generacija.

Poštovana gospodo poslanici,
Ja bih htela da vam postavim jedno pitanje ili da se zajedno zapitamo da li je to tako. Da li smo dovoljno odgovorni da zaštitimo naše nacionalne resurse ili postajemo bahati i ne razmišljajući uništavamo iste?

U prethodnim godinama, svedoci smo da i usred klimatskih promena sve više požara koji uništavaju velika prostranstva kao i bahatost pojedinaca, koji namerno ili nenamerno pale i uništavaju šume. Da je to samo razlog, možda bismo mogli i da to predupredimo i kao društvo izađemo sa tim problemom na kraj. Ali, gospodo poslanici, veća pošast u ovom trenutku je divlja seča šuma, kako privatne tako i društvene, gde se u jednoj godini hiljade hektara poseku a da za to niko ne odgovara ili je broj onih koji su odgovarali pred zakonom veoma mali.

U Zakonu o šumama Kosova, u članu 8. predviđen je fond za obnovu šuma, gde se vidi na koji način bi se sve to finansiralo. U istom članu 8, tačka 3. kaže da ostvareni prihodi od investicija u šumsko zemljište, deo prihoda od prodaje resursa iz javnog šumskog zemljišta, kao i novčane kazne ili prikupljena sredstva od naplaćivanja šteta u javnom sektoru šumskom zemljištu ići će u ovom fondu za zaštitu i obnovu šuma.

Isto tako predviđena su i sredstva koja se izdvajaju iz Budžeta Kosova. Takođe imamo i fond za obnovu, gde možemo tražiti subvencije od drugih organizacija, koji pozajmice od onih koji su spremni da ulažu u šume Kosova. Sva ova ulaganja imaju za cilj održivost resursa u doglednoj budućnosti i šumska agencija priprema dugoročne planove u upravljanju javnim resursima.

Na kraju, apelujem na sve relevantne činioce da izvrše svoje zakonske obaveze, kako bi se sačuvalo ovo prirodno bogatstvo koje danas imamo na Kosovu, kao i veću angažovanost policije i inspektorata u pronalaženju ilegalnih drvoseča. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, sipas radhës fjalën e ka deputeti Ramiz Lladrovci.

RAMIZ LLADROVCI: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Shumëçka që u tha unë do të mundohem të mos e përsëris.

Kosova, në raport me sipërfaqen e përgjithshme tokësore ka mbulueshmëri pyjore prej 44%. Prej kësaj sipërfaqeje 60% është në pronësi shtetërore dhe 40% në sektorin privat. Në periudhën maj - nëntor të vitit 2012 ka përfunduar puna në terren për inventarizimin nacional të pyjeve të Kosovës. Ky inventarizim ka përfshirë të gjitha pyjet e të dy pronësive, private dhe publike në tërë territorin e Kosovës, përfshirë edhe zonat që më parë kanë qenë të minuara dhe komunat veriore të cilat nuk ishin përfshirë në inventarizimin e vitit 2003.

Tani AKP-ja është në fazën e përpunimit të dhënave të mbledhura nga terreni dhe në fillim të muajit prill është dashur të prezantojë raportin final të inventarizimit nacional të pyjeve.

Agjencia Pyjore e Kosovës sipas Ligjit për pyjet nr. 2003/3 është përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e pyjeve dhe tokave pyjore në pronësinë publike, si dhe pyjeve në parqet nacionale të Kosovës, si dhe përgjegjëse për çështje të ndërlidhura në rregullimin e pyjeve dhe tokave pyjore private.

Gjatë periudhës raportuese AKP-ja ka kryer një varg aktivitete. Hartimi dhe miratimi i planeve menaxhuese afatgjate është bërë në bazë të nenit 17 të Ligjit për pyjet 2003/03. Gjatë vitit 2012 janë përgatitur planet menaxhuese afatgjate të financuara nga Buxheti i Kosovës.

Në total nga buxheti i AKP-së gjatë vitit 2012 janë mbuluar me plane menaxhuese afatgjate 25 707,85 hektarë. Po ashtu gjatë vitit 2012 janë përgatitur plane menaxhuese

afatgjate të financuara edhe nga Qeveria e Finlandës, e implementuar nga FAO, për 9 434 hektarë. Përfundimi i projektit në tërësi do të realizohet gjatë vitit 2013.

Hartimi dhe miratimi i planit vjetor operacional për menaxhimin me pyje bëhet në bazë të nenit 18 të Ligjit për pyjet.

Komponentët kryesore të këtij plani janë:

- Shfrytëzimi racional i pyjeve,
- Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale,
- Mbrojtja e pyjeve nga zjarret.

Totali i realizimit të shfrytëzimit të pyjeve në të dy sektorët, publik dhe privat, për vitin 2012 është 192 618, 85 + 7 000 m³ nga rrallimet, çlirimet, pastrimet bazuar në memorandumun e mirëkuptimit në mes të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Realizimi i planit vjetor menaxhues nëpërmjet tenderimit, kontraktimit dhe përcjelljes së masës drunore është përgjegjësi e deleguar te autoritetet komunale. Raportimi për aktivitetet e kryera bëhet nga kuvendet komunale pranë autoritetit menaxhues dhe monitorues të APK-së.

Duke iu referuar Ligjit nr. 03/L-153 të 25 shkurtit 2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/3 për pyjet e Kosovës, mbrojtja e pyjeve si dhe Ligji mbi vetëqeverisjen lokale dhe disa kompetenca nga fusha e menaxhimit të pyjeve, si mbrojtja e pyjeve dhe dhënia e lejeve për prerjen e masës drunore, tenderimi si dhe shërbimet teknike, në pyjet private dhe përcjellja e masës drusore janë përgjegjësi e komunave.

Autoritetet komunale në baza të rregullta mujore raportojnë te APK mbi të gjitha aktivitetet e zhvilluara në pyje. Bashkëpunimi mbi bazën ligjore në mes autoriteteve qendrore dhe lokale është i kënaqshëm dhe do të ndikojë në përmirësimin e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve.

Për realizimin e përgjegjësiave ligjore të krijuara pas delegimit të kompetencave në komuna është bërë edhe bartja e nëpunësve civilë, rojeve të pyllit, teknika dhe përgjegjësitë të njësive komunale.

Numri i personalit pas bartjes së kompetencave në komuna është 266, kurse në APK 134 të punësuar. Roli i APK-së në kompetenca të deleguara në mbrojtjen e pyjeve, dhënien e licencave për prerjen e drurëve në territorin e komunës është monitorues në bazë të Ligjit nr. 03/L-153.

Me miratimin e dy projektligjeve për parqet nacionale, Bjeshkët e Nemuna dhe Malet e Sharrit, pyjet administrohen nga dy ministritë, nga Ministria e Ambientit, Planifikimit Hapësinor, që përfshinë 115 mijë hektarë dhe nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural, me 353 400 hektarë, duke përfshirë atë privat dhe publik.

Në mbrojtjen e pyjeve autoritetet komunale gjatë vitit 2012 kanë zhvilluar një varg aktivitete në lëmin e mbrojtjes së pyjeve nga prerjet ilegale, të cilat janë ndihmuar dhe përkrahur nga APK. Në funksion të mbrojtjes së pyjeve janë mbajtur takime të shumta me gjykatat, Policinë e Kosovës, EULEX-in, kryetarët e komunave dhe inspektorët e pylltarisë, për veprime të përbashkëta.

Ka vazhduar funksionimi i pikave permanente të kontrollit së bashku me Policinë e Kosovës dhe autoritetet komunale. Në bashkëpunim me Ministrinë për Mirëqenie Sociale APK ka angazhuar 50 punëtorë për vrojtim dhe parandalim nga zjarret, kurse në aktivitetet e lokalizimit dhe shuarjes së zjarreve ka koordinuar aktivitetin me shumë institucione: me komunat si përgjegjëse për mbrojtjen e pyjeve; FSK-në; organizatat e zjarrfikësve; Agjencionin e Emergjencave, të cilat kanë ofruar edhe përkrahje logjistike.

Nga zjarret janë përfshirë 3 487,74 hektarë pyje. Zjarret sipas opinioneve- dyshime mund të kenë qenë aksidentale, të paqëllimshme si pasojë e pakujdesisë, hedhjes së cigareve të pashuara, djegies së hamullorëve, të cilët pastaj nuk mund të kontrollohen dhe janë përhapur në pjesët tjera, djegiet në deponitë e mbeturinave, po nuk përjashtohet mundësia që në disa raste zjarret të kenë qenë të qëllimshme nga persona të pandërgjegjshëm.

Burimet e zjarreve kanë qenë të brendshme, por edhe të bartura nga jashtë, si nga Shqipëria, Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi. Me qëllim të rregullimit të infrastrukturës rrugore për qasje më të lehtë gjatë intervenimeve të shuarjeve të zjarreve, kontrolleve, inspektimeve dhe shfrytëzimit më të lehtë, është bërë rindërtimi i rrugëve pyjore.

Është aprovuar plani vjetor për menaxhimin me pyje, në shkurt të 2013-ës. Komponentët kryesorë të këtij plani janë: raportimi final i inventarizimit të pyjeve në nivel nacional të financuar nga Qeveria norvegjeze, i realizuar nga NFG. Hartimi i planeve menaxhuese për afro 27 640 hektarë nga Buxheti i Kosovës, hapja e 49 kilometrave rrugë - breza kundër zjarreve, si dhe mirëmbajtja e 10 kilometra korridore ekzistuese kundër zjarreve, rindërtimi i 10 kilometrave rrugë pyjore në vend gjueti, në Blinajë.

Po ashtu është nënshkruar memorandum ndërmjet Ministrisë të Bujqësisë, Pylltarisë, Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Punës, Mirëqenies Sociale, në shkurt të 2013 për angazhimin e 19 punëtorëve për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve si dhe 20 punëtorë në ngritjen e prodhimtarisë fidanore në Institutin e Pylltarisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, tash fjala i jepet nga Lidhja Demokratike të Kosovës, Afërdita Berisha-Shaqirit, e cila është po ashtu edhe anëtare e Komisionit që e ka ngritur debatin.

AFËRDITA BERISHA-SHAQIRI: Faleminderit!

I nderuar kryesues!

I nderuar ministër, të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Pyjet dhe industria pyjore janë elemente të rëndësishme për ekonominë e Kosovës, kjo posaçërisht vlen për zonat rurale ku një numër i konsiderueshëm i popullatës siguron

mjetet e jetesës nëpërmjet operacioneve pyjore. Pyjet janë ekosistemet më komplekse, më të rëndësishme dhe më produktive në natyrë, prandaj politikat ndërkombëtare, veçmas ato të Bashkësisë Evropiane, bazohen në principin e shfrytëzimit të qëndrueshëm të këtij resursi duke aplikuar dhe realizuar principet ekologjike.

Sipas statistikave, Republika e Kosovës është e mbuluar me pyje 42%, që në vlerësim global ka një sipërfaqe të konsiderueshme pyjore, mirëpo gjendja e pyjeve nuk paraqitet e mirë siç u tha nga parafolësit.

Sa i përket komunës së Dragashit, gjendja e pyjeve është më e mirë se në komunat tjera. Popullata rurale e komunës së Dragashit është munduar të tregojë një shkallë të lartë të vetëdijesimit duke mbrojtur pasurinë natyrore, pyjet, florën, faunën e egër, pra popullata ka bërë përpjekje që të mos ketë prerje ilegale, por i ka ruajtur ato me fanatizëm.

Komuna e Dragashit, siç është e njohur shtrihet në pjesën jugore të Republikës së Kosovës dhe kufizohet me komunën e Prizrenit dhe dy shtete fqinje, Republikën e Shqipërisë dhe Republikën e Maqedonisë.

Kjo është e rëndësishme, sepse ka një periudhë të gjatë, mbi tri dekada që në këtë komunë nuk abuzohet pylli nga popullata rurale, me përjashtim të zonave rurale të afërta me pyjet e kësaj zone që përfshin fshatrat e thella të Shqipërisë.

Nga paraluftra dhe tani 14 vjet pas luftës, pyjet e Kosovës po vazhdojnë të dëmtohen me intensitet të pazvogëluar. Ato vazhdojnë të priten pa asnjë kriter. Po citoj titullin e një artikulli në gazetën Koha ditore, ku thuhej: prerësit ilegalë shkaktojnë dëme milionëshe, në të cilin artikull, gazetari kishte shprehur një deklaram për abuzime dhe përfitime milionëshe nga pylli. Pra, është kjo një çështje tejet e ndërlikuar në të cilën organet e shtetit, gjykatat po dështojnë në kryerjen e misionit të tyre.

Siç jeni në dijeni, Parku Nacional i Sharrit, miratuar më parë përfshin 57% të territorit të komunës së Dragashit, gjë që ka bërë që popullata lokale të jetë e shqetësuar, bile ata kanë vazhduar të japin nënshkrimet e tyre dhe t'i shprehin ato në peticion.

Lënda e formuar prej mbi 1400 nënshkrimesh të këtij peticioni, jam e informuar, se është e dërguar në Kuvendin e Republikës së Kosovës, me qëllim që të rishqyrtohet Ligji për Parkun Kombëtar Sharri.

Popullata lokale është e informuar, siç thonë ata, pjesërisht për të mirat e mundshme që mund të sjellë Parku Kombëtar, sidomos në aspektin e turizmit. Ata shqetësohen dhe kanë droje se nëse do të merret parasysh Ligji numër 03/L-233 i 30 shtatorit 2010 për mbrojtjen e natyrës, konkretisht neni 11, pika 4 e tij, ku thotë: në Parkun Kombëtar ndalohet shfrytëzimi ekonomik i të mirave të natyrës.

Atëherë, kjo është shumë e qartë se komuna e Dragashit, mbi 3 500 hektarë pyjesh shtetërore dhe mbi 3 700 hektarë pyje dhe toka private janë brenda Parkut Kombëtar. Ata jetojnë nga veprimtaritë pyjore dhe nga kullotat, i bie që popullata lokale nuk do të mund

t'i shfrytëzojë këto pasuri, që njëherësh do të ndikojnë në pamundësinë e furnizimit me dru teknik dhe zjarri. Por, brenda sipërfaqes së Parkut Kombëtar, ndalohet edhe kullotja e bagëtisë në zona të caktuara, grumbullimi i frutave pyjore, mbledhja e bimëve mjekuese, ndalesa e marrjes së ujit për nevoja të fshatarëve apo moslejimi i meremetimit të rrjetit ekzistues të ujësjellësit brenda zonës së parkut. Ndalohet gjuetia, ndalohet shfrytëzimi i mineraleve nëntokësore dhe sipërfaqësore, duke llogaritur edhe zhavorrin e aktivitetet tjera që kufizohen apo ndalohen.

Prandaj, mendoj që ekspertët duhet rishikuar, sidomos sipërfaqen e zonës strikte të këti parku, në mënyrë që qytetarët të vazhdojnë, domethënë të mos ketë kufizime në veprimtaritë ekonomike që i kanë ushtruar deri më tani.

Edhe gjendja e pyjeve në komunën e Suharekës nuk është në nivel të kënaqshëm, sepse atje prerjet ilegale të pyllit shtetëror dhe një pjesë të Parkut Kombëtar, po vazhdojnë, edhe pse mund të thuhet se ka një trend rënie, por është larg gjendjes së dëshiruar.

Ajo që është për t'u theksuar dhe paraqet shqetësim për ne si Komision dhe për qytetarët është fakti se gjatë stinës së verës, e veçmas verën e kaluar, u dogjën sipërfaqe të mëdha pyjore, përfshirë edhe komunën e Dragashit, ku ministritë dhe Qeveria nuk kishin mekanizëm për ndaljen e tyre.

Dëmet që u janë bërë pyjeve nga zjarret janë shumë të mëdha dhe të pakompensueshme, veçmas brengosëse është shkatërrimi i sipërfaqeve pyjore dhe rreth kullotave nga djegiet në hapësirat masive malore.

Gjithashtu, kërkoj që puna e organeve kompetente të shtetit, gjykatat dhe policia të angazhohet më shumë për të ndihmuar në pengimin e dëmtimit të pyjeve të cilat sipas ligjit janë të shpallura pasuri kombëtare, zgjidhjen sa më të shpejtë të shumë lëndëve të cilat po presin për zgjidhje me qëllim që ndikohet direkt në zvogëlimin deri tek ndalja e tërësishme e prerjeve ilegale të pyjeve, të cilat po rrezikojnë seriozisht këtë pasuri kombëtare.

Mjedisi i ri ekonomik dhe gjendja në sektorin pyjor, theksojnë nevojën urgjente për krijimin e sistemeve efikase, për menaxhim shumëqëllimor të resurseve pyjore si dhe zhvillimin e një industrie pyjore e cila është në harmoni me resurset ekzistuese pyjore. Shfrytëzimi i pyjeve duhet të jetë shumë i kujdesshëm, në baza ekologjike, i planifikuar, i kontrolluar dhe i qëndrueshëm, në të kundërtën pasuritë pyjore të vendit tonë shpejt do të humbin, jo vetëm për brezat e ardhshëm, por edhe për gjeneratën tonë.

Në fund, përkrah fuqimisht rekomandimet e Komisionit për Bujqësi, Pylltari e Planifikim Hapësinor. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nga Lëvizja “Vetëvendosje”, fjalën e ka Visar Ymeri.

VISAR YMERI: Faleminderit!

Natyrisht që u përmend këtu disa herë që pyjet janë resurs dhe po që se themi se pyjet janë resurs, atëherë kjo është një lidhshmëri e pashkëputshme mes zhvillimit ekonomik dhe pyjeve dhe resursit që na i sjellin pyjet.

Po këtu në Kosovë shpeshherë është stërpërdorur, të them ashtu, ky zhvillimi ekonomik, madje, madje shpeshherë i është shtuar edhe padrejtësisht mendoj unë edhe zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, disa politikave të cilat shkojnë në kundërshtim me këtë. Pra, në kundërshtim të drejtpërdrejtë me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Dhe, na thuhet shpeshherë që në planin afatgjatë zhvillimor të Kosovës është me prioritet që prodhimin e energjisë ta kemi nga linjiti, pra këto janë projektet e Qeverisë aktuale, veçanërisht projekti Kosova e Re, që nënkupton domethënë ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike nga thëngjilli, ndërkohë që në të njëjtën kohë na thuhet që prerja e pyjeve po bëhet edhe për zhvillim ekonomik, pra për ta ndihmuar zhvillimin ekonomik të vendit dhe këto dyja bien në kontradiktë pastaj me njëra tjetrën, për shkak se cilën do ta përdorim si resurs ultimativ të them ashtu për prodhimin e energjisë, a do të jenë ato pyjet apo do të jenë ai thëngjilli?

Natyrisht që pyjet nuk mund të konsiderohen sikur thëngjilli, të jetë resurs i **fundit**, për shkak se rigjenerimi i pyjeve merr një kohë më të shkurtër për t'u kryer se sa që do të kishte marrë rigjenerimi i thëngjillit, por prapëseprapë edhe pyjet, drunjtë e pyjeve nuk mund të konsiderohen as si një resurs i cili është lehtë i rinovueshëm për shkak se megjithatë kërkon një lloj angazhimi shumë më serioz dhe një kohë më të madhe që t'i rigjenerojmë pyjet ashtu siç kanë qenë në fazën kur nuk janë prerë.

Pra, zhvillimi i pyjeve, përveç pyllëzimit të suksesshëm e jo si ky i tanishmi ku fidanët nuk zënë, por po thahen, nënkupton edhe prerjen dhe pastrimin, të cilat do të ishin natyrisht të mirëseardhura për nevojat e qytetarëve për dru zjarri.

Por sot, masa drunore e lënë nëpër pyje, pas eksploatimit të parregullt të pyjeve, shndërrohet në burim zjarri dhe sëmundjesh për pyje. Pra, në vend që të jetë pastrim i pyjeve dhe mundësim i zhvillimit të pyjeve, ato po shndërrohen faktikisht në pengesë për zhvillimin e pyjeve.

Ekspluatuesit ilegalë, por edhe ata legalë, presin dhe e marrin vetëm pjesën më të vlefshme të drurit duke lënë pjesët e sipërme apo degët. Pra, duke e lënë kurorën nëpër zjarre, gjë që pastaj e shkaktojnë edhe mundësinë më të madhe, i shkaktojnë zjarret gjatë verës, por edhe sëmundjet e ndryshme të pyllit dhe e dëmtojnë pyllin në përgjithësi.

Menaxhimi i duhur që do të mund të bëhej nga komunat në bashkëpunim me komunitetin, do të sillte të shfrytëzimi i kësaj sasive të drurit për djegie dhe pastrim i pyjeve. Natyrisht se këtu kërkohet një lloj mobilizimi i bashkësisë dhe një orientim i shfrytëzimit të këtyre lëndëve djegëse, por këto do të kishin mund të shfrytëzohen dhe shërbejnë shumë mirë për ta përmbushur kërkesën për ngrohje dhe për të mos e dëmtuar pyllin apo për ta pastruar pyllin nëpërmjet një fushate, të them ashtu, ndërmarrjeje të organizuar.

Dhe, natyrisht se është i domosdoshëm po ashtu edhe promovimi i formave alternative për ngrohje në mënyrë që ta ndihmojmë edhe këtë aspekt.

Kjo do të mund të bëhet me politika që në bazë e kanë qytetarin, të ardhmen e tij dhe jo profitin. Duhet të kemi parasysh se cilësia e mjedisit llogaritet të jetë pjesë përbërëse e lirisë së popullit dhe e lirisë së qytetarëve, kjo është pjesë përbërëse e mirëqenies së tij. Pra, me një mjedis të degraduar, natyrisht se nuk mund të flasim për mirëqenie e as dorën në zemër, për liri. Dhe, nëse ky mjedis dhe kjo hapësirë i falet tërësisht profitit, qoftë ai legal apo ilegal i ndërmarrjeve të caktuara e jo edhe interesit të qytetarit, atëherë natyrisht se jemi duke e ndërtuar një shtet i cili më shumë e mbron interesin partikular se sa interesin e përgjithshëm të qytetarëve.

Nëse sistemi aktual është i mbingarkuar me nivele të shumta dhe prerja ilegale nuk ndalet, është i domosdoshëm thjeshtësimi i sistemit aktual në dobi të funksionimit të tij. Pra decentralizimi në menaxhim duhet të kontrollohet nga një sistem i centralizuar i inspektimit. Ndarja në kompetenca në mes nivelit qendror dhe lokal, duhet të jetë e definuar qartë e jo siç është tani me kompetenca të ndërthura nga nivelet e ndryshme që i sipërvendosin njëra-tjetrës, gjë që i përmendi edhe deputeti Liburn Aliu, më herët.

Po ashtu, një problem tjetër në këtë fushë është edhe mungesa e kuadrove pyjore, në të gjitha nivelet dhe domosdoja e shkollimit të tyre në mënyrë që të kemi kuadra të përgatitura për këtë çështje.

Po të merrej kjo më me seriozitet, atëherë përbrenda, vetëm ta zëmë, për pesë vjetëve të fundit, do ta kishim gjendjen shumë më të mirë në këtë aspekt se sa që e kemi aktualisht.

Po ashtu, mendoj që duhet të bëhet e qartë ndarja në mes të procesit të prerjes dhe shitjes, ku shitja do të duhej të ishte e kontrolluar nga një autoritet qendror me ç'rast do të mund të kontrollohej edhe çmimi si dhe qarkullimi i masës drusore në vend.

Njëkohësisht pyjet janë edhe pasuri kombëtare dhe si të tilla në rast zjarresh duhet të trajtohen nga niveli qendror në bashkëpunim me ato lokale. Për këtë çështje foli edhe zoti Aliu dhe nuk po dua t'i përsëris, por është e domosdoshme që të kemi një mobilizim në nivel vendi, të them ashtu, kur kemi të bëjmë me rastet e fatkeqësive natyrore, qofshin ato gjatë verës apo dimrit e veçanërisht kur kemi të bëjmë me rastet e djegies së pyjeve apo shkatërrimit të tyre.

Bashkëveprimi ndërmjet inspektorateve, policisë, gjykatave dhe autoriteteve komunale është i domosdoshëm edhe në ruajtjen e pyjeve nga prerjet ilegale, ku siç është në rastin tonë, kur ato shumëfish i tejkalojnë prerjet e planifikuara.

Vendosja e pikave të kontrollit në vende kyçe ku bashkëveprojnë autoritetet, janë çelësi i ndalimit të prerjeve ilegale. E përmendi këtu ministri Stavileci që kjo punë është duke u diskutuar. Pra, për t'u vendosur, me sa më kujtohet, e tha dy pika të kontrollit, mirëpo me informatat që i kam unë, kjo punë është duke u diskutuar tash e dy vjet dhe nuk po e kuptoj pse ka nevojë për kaq shumë diskutim për të ndërmarrë një veprim të tillë për të

cilin të gjithë janë dakord se do ta përmirësonte kontrollin edhe ndalimin e prerjes ilegale të pyjeve dhe rrjedhimisht edhe shkatërrimin e tyre.

Një gjë e tillë mund të bëhet, natyrisht. Nëpër situata të tilla kanë kaluar edhe vendet tjera, që sot janë bërë pjesë e BE-s, por ata ia kanë dalë që t'i ndalin prerjet ilegale, që nënkupton se edhe ne mund ta bëjmë një gjë të tillë po që se kemi një vullnet politik dhe po që se kemi orientim të qartë kah shtet ndërtimi.

Pra, për ta përfunduar, politika e shtet ndërtimit dhe shtet ndërtimi duke e pasur në qendër interesin e qytetarëve, është çelësi edhe për këtë çështje, siç është edhe për shumë probleme tjera që i kemi këtu në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, fjalën nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, e merr deputetja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar ministër,

Kosova, pra ka rreth 464 800 hektarë pyje në pronësi shtetërore dhe të pronësisë private prej tyre 60%, 60% pra në pronësi shtetërore dhe 40% në pronësi private.

Në raport me sipërfaqen e tërësishme të Kosovës, mbulueshmëria me pyje me rreth 42% e rangon Kosovën në shtetet e pasura me pyje. Në anën tjetër, vëllimi ose masa drunore prej 52 000 000 metra kub, në bazë të shënimeve që ka Aleanca, është nën minimumin e mundshëm karshi kushteve ekologjike, gjeologjike dhe klimatike që posedon Kosova.

Në bazë të shënimeve nga Riinvest dhe organizatat ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë, në vit prehen rreth 550 000 metra kub dru në mënyrë jo ligjore, pra ilegale, që shndërruar në vlerë monetare i bie që buxheti i Kosovës së paku i humb 5,5 milionë euro në vit. Dëmet e tjera llogariten të jenë shumë më shumë të mëdha.

Për 14 vjet të menaxhimit të pyjeve nga Ministria e Bujqësisë e Planifikimit dhe Zhvillimit Rural, respektivisht Agjencia Pyjore e Kosovës, nuk kanë arritur dot t'i gjejnë mekanizmat adekuat për mbrojtjen e pyjeve nga shkatërrimet masive e të pamëshirshme.

Ndonëse dy-tre vjet më parë komunave iu bartën kompetencat për mbrojtjen e pyjeve, gjendja për fat të keq asnjëherë nuk u përmirësua, sepse të jemi të sinqertë, pyjet nga APK-ja u morën nën menaxhimin në gjendje katastrofike, duke qenë kështu gati para një akti të kryer dhe duke mos e ditur mirë komunat se çka po marrin në menaxhim, pasi që pyjet ishin vërtet në gjendje të mjerë.

Nga prerjet ilegale, situata mbetet e rëndë, sidomos në sektorin e pyjeve kualitative.

Unë do të ndalem me theks të veçantë në pyjet e komunës: Gjakovë, Junik dhe Deçan, të cilat në fakt degradimin dhe shkatërrimin masiv e përjetuan pikërisht në kohën kur ato menaxhoheshin nga APK-ja, sepse edhe ashtu janë ndër komunat më të goditura nga ky fenomen.

Vetëm në këto tri komuna ka rreth 30 000 hektarë pyje me kapacitet të rritjes prej 90 000 metra kub. Pas përfundimit të luftës, pyjet e bjeshkëve të këtyre komunave kanë kaluar faza të vështira të zhvillimit degradues, dëmtime të egra dhe të pakontrolluara, derisa ishin në menaxhimin e Agjencisë Pyjore të Kosovës. Nuk ka ndjenjë më të keqe sesa të shohësh nga afër gjendjen në terren, këtë barbari nga dora e njeriut tonë, ndërsa në anën tjetër “sehiret” nga zyrtarët institucional të paguar mirë për mbrojtjen e tyre nga buxheti i Kosovës.

Pyjet kanë pasur një dëmtim të paparë të shkatërrimit dhe pasojat do të njihen edhe për shumë vite, sepse sipas ekspertëve drurit i duhen më shumë se 50 vjet për t’u rritur e zhvilluar.

Në sektorin shoqëror të pronës publike janë dëmtuar lisat shumëvjeçar, trashësia e të cilëve ka qenë me diametër mbi 1 metër dhe gjatësi mbi 30 metra. Tani kanë mbetur vetëm cungjet e thata, të cilat na i përkujtojnë lisat e gjatë dhe bukuritë natyrore me florë të pasur të bjeshkëve tona, këtyre bukurive të rralla të cilat pamëshirshëm po i shëmtojmë dhe shkatërrojmë pa asnjë kriter për të ardhmen e brezave që do të vijnë pas nesh.

Mjerisht, të nderuar kolegë deputetë, pyjet sot janë në gjendje të mjerë, ashtu sikur që u tha nga të gjithë kolegët të nderuar deputetë, sepse në dhjetëvjeçarin e fundit nuk kanë qenë të mbikëqyrura nga faktori njeri. Përkundër degradimeve masive e prerjeve të pakontrolluara askush nuk është marrë në përgjegjësi nga ata që i kanë pasur kompetencat me ligj për t’i mbrojtur pyjet. Në këtë kuptim, dështim të plotë kanë treguar edhe gjykatat, asnjëherë dëmtuesit nuk e kanë marrë dënimin e merituar.

Pse ka ndodhur kjo? Sepse primatin e dështimit e mban Qeveria e Kosovës.

Çka ka bërë Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria përkatëse në parandalimin e kësaj dukurie shëmtuese, e cila tash e 14 vjet pra po shkakton dëme të pariparueshme, absolutisht, asgjë, dështim i plotë në menaxhim.

Sikurse Qeveria e Kosovës të menaxhonte mirë sektorin e pylltarisë, do të krijoheshin edhe vende të reja pune, sepse në shfrytëzim të kujdesshëm të drurit do të krijoheshin edhe shumë kushte më të mira për punimin e drurit në vazhdimësi.

Gjendja është kaotike, sepse qasja për zgjidhjen e gjendjes aktuale të pyjeve në Kosovë është shumë e gabuar, është e gabuar sepse legjislacioni nuk është kompatibil në gjendjen në terren.

Se gjendja vërtet është alarmante tash e 14 vjet me radhë, dëshmojnë edhe faktet me shifra tmerruese të dala nga vetë AKP-ja. Në vitin 2012 autoritetet komunale kanë ngritur një numër shumë të madh të fletëparaqitjeve për dëmtimin e pyjeve. Numri i tyre është 7 586 fletëparaqitje, prej të cilave 4 854 janë për kundërvajtje, ndërsa pjesa tjetër prej 2 732 janë për vepër penale. Prej tyre, thuhet se kanë përfunduar vetëm 2 166 aktgjykime, ndërsa, vlera e dëmeve të shkaktuara është diku rreth 24 metër kub.

Pyjet pas luftës kanë pësuar një shkatërrim total dhe kanë rrezik të shndërrohen në kullosa. Për këtë deri më tani fajin e ka Qeveria e Kosovës. Nuk mjaftojnë vetëm bartja e kompetencave nëpër komunat e Kosovës kinse për mbrojtjen e tyre.

Prandaj, ne konsiderojmë se urgjentisht duhet të përcaktohen detyrat, duhet lidhur zinxhiri i shkëputur polici - prokurori - gjykatë, në mënyrë që të shpëtohet së paku ajo që ka mbetur.

Të jemi shumë të singertë, se edhe ashtu jemi të vonuar, prandaj të gjithë duhet të jemi në mbrojtjen e pyjeve, sepse mbi të gjitha ato nuk janë pasuri e individit, por janë pasuri e Kosovës dhe e të ardhmes së fëmijëve tanë.

KRYESUESI: Faleminderit! Prej Koalicionit për Kosovën e Re, fjalën e ka deputetja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajući Skupštine!

Poštovani kolege poslanici,

Poštovani građani,

Apsolutnu podršku dajem Komisiji za poljoprivredu u vezi današnje rasprave oko situacije naših šuma jer Nacionalni park Šar jeste naše prirodno bogatstvo koga moramo štititi jakim zakonima, ali ne zakonima samo na papiru kao što je bilo do sada nego strogom implementacijom i jakim kaznama oko zaustavljanja podmetanja požara, kojih imamo 13 godina na području Prevalca i interesantna je činjenica da se požari dešavaju samo na državnim šumama, na prostorima državnih šuma.

Nadležnost lokalne samouprave je ograničena. Direktorijati poljoprivrede i inspektorati ne mogu obavljati svoju dužnost od strane Ministarstva za poljoprivredu i raznih drugih agencija. Veliki broj prijave od strane građana pokazuju nam da postoji direktan konflikt interesa oko dodeljivanja raznih tendera ali i zloupotrebe službenog položaja i od strane bezbedonosnih službi na teritoriji Župskog kraja jer niko ne preuzima odgovornost u cilju sprečavanja sećanje šuma kao našeg nacionalnog blaga.

Dugogodišnja seća šume u ruralnim mestima, posebno u selima Jablanica, Nebregoste, Lokvica, Gornje i Donje Ljubinje, Manastirica, Gornje Selo, Mušnikovo predstavlja veliku zabrinutost Bošnjačkog stanovništva zbog goleti odnosno erozije zemljišta koje narušava život naših građana.

Prinudena sam da ovako žustro reagujem i uputim kritike Vladinim predstavnicima.

Kao posebno današnju problematiku želim izneti nerešenu situaciju od strane Vlade u vezi pošumljavanja određenih prostora u Restelici. Znamo koja nam se tragedija desila prošle godine i odnela je mnoge živote naših građana, tako da apelujem na Ministarstvo za poljoprivredu i Ministarstvo za prostorno planiranje, kao i na lokalnu vlast u Dragašu da pod hitno reše urgentnu situaciju u tom kraju naše zemlje da se ne bi nikad nikome tako nešto ne bi dogodilo.

Za našu državu je to mali rešivi problem, male finansijske prirode i ulaganja, a za stanovništvo Restelice je važan životni prioritet, tako da zahtevam od Komisije za poljoprivredu da moje današnje izlaganje uvrsti kao jako važnu preporuku u cilju bezbedonosnog i sigurnosnog stanja Bošnjačkog stanovništva, Župskog i Dragaškog kraja. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës nga Partia Demokratike, fjalën e merr Shaip Muja.

SHAIP MUJA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë,

Mendoj që shumë parafolës biseduan mjaft dhe konkluzat të cilat janë paraqitur do të jenë të dobishme për një planifikim më të mirë të industrisë pyjore dhe kontributi im do të radhitet në këtë që përkundër asaj pjesës ekologjike i cili është obligim shtetëror dhe i ministrive dhe i Ministrisë së Bujqësisë dhe Agjencisë Pyjore dhe komunave, të ngritën edhe kapacitete të cilat do t'i analizojnë edhe ndërtimet e paplanifikuara dhe të paçertifikuara me materiale të cilat edhe emitojnë emitimet e dioksidit të karbonit dhe elementet tjera toksike të cilat janë edhe transmetues mandej të sëmundjeve të ndryshme që barten në pjesë bimore, që rriten ato pjesë të pyjeve dhe kjo është njëra ndër pikat e cila shumë pak po preket dhe mendoj që transmetimi i sëmundjeve nga drunjtë është jashtëzakonisht i madh dhe i cili mund të transmetohet mandej edhe tek njerëzit me probleme shumë të mëdha edhe shëndetësore.

Nga aspekti ekonomik mendoj që duhet stimuluar prodhuesit, të cilët merren me industrinë drusore dhe për të filluar me projekte që quhen projektet publiko-private, me partnerë, më PPP projekte, të cilat do ta rritin në këtë mënyrë edhe organizimin e shfrytëzimit të mbeturinave, të cilat janë në pyje dhe të cilat janë të akumuluar dhe mund të riciklohen dhe të futen në rishfrytëzim për hapjen e vendeve të punës, për mundësinë e shitjes së tyre dhe kryesisht, për shembull, në industrinë e peletit që përdoret për ngrohje, e cila do të mund të hapte në mënyrë sezonale jashtëzakonisht vende të mëdha të punës në disa pika të Republikës së Kosovës. Dhe, në këtë mënyrë ne duhet analizuar ato pozicione, të cilat mund të planifikohen për prerje, për industrinë, qoftë të drurit që përdoret në industrinë e ndërtimit apo edhe në industrinë e energjetikës e cila është si pjesë edhe e energjisë në shumë vende të Kosovës dhe të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Mandej, nga ana e masave mbrojtëse të cilat u dëgjuan këtu dhe kostoja e cila është sot e angazhuar Ministria dhe Agjencia Pyjore, duhet parë për shembull nga ata 90 punonjësit sa janë produktivë. Ata janë vetëm në një mënyrë lajmërues së po ndezët mali dhe nuk mund ta nxjerrë ndonjë preventivë e cila mund ta ndalojë ose ta prevenojë problemin e ndezjes. A janë duke u ndezur malet nga keqbërësit apo nga ngrohja globale e cila është sot në temperatura të cilat shkojnë shumë lart dhe zhvillimet kimike të cilat ndodhin nga ngrohja e mbeturinave që janë nga pjesa drusore, probabiliteti është me një përqindje më të madhe shumë, vetvetiu ndezja e tyre nga kjo ngrohje dhe kjo ngrohje bëhet sepse nuk bëhet pastrimi i pyjeve.

Ne kemi shumë pika sot nëpër Kosovë ku janë djegur vitin e kaluar dhe të gjitha do të jenë prapë potencial për të vazhdojë djegia në po ato pozicione duke u zgjeruar, sepse jo vetëm nga dora e njeriut.

Mandej, si masë mbrojtëse mendoj që Ministria e Bujqësisë dhe Agjencia e Pyjeve duhet të ngritin kapacitete për aktivizimin e aeroporteve bujqësore, ose duke huazuar agjenci të cilat janë për fikjen e zjarreve nga ajri ose helikopterë ose të kenë kapacitete vetë Kosova, kështu avionë të cilët i fikin zjarret, sepse në këtë mënyrë çfarë ne po i shohim nëpër mjete të informimit, ne vetëm po jemi konkludues se është duke u zgjeruar zjarri, nuk mund të ndërhyjmë as nga ajri as nga toka, prandaj në këtë mënyrë jemi duke lejuar vetvetiu shkatërrimin.

Mendoj se parashtruesit e këtij debati dhe konkluzionet të cilat i kanë paraqitur, t'i shtrohet edhe një pikë ose në pikën e parë ku thuhet se Qeveria e Republikës së Kosovës t'i vlerësojë dëmet në pyjet e Kosovës, të shkaktuara gjatë verës së vitit 2012, kjo është e pamundur, sepse këto s'kanë çmim. Çmimet janë të pakufizueshme dhe nuk arrijmë asgjë, nëse i vlerësojmë sa jemi të dëmtuar. Jemi dëmtuar hipotetikisht, mund të themi, por realisht nuk mund ta nxjerr askush çmimin se s'ka çmim real.

Dhe, pika e dytë, mendoj që të qëndrojë dhe të shtohet një pikë e dytë, e cila do të jetë në këtë përmbajtje dhe të cilën kërkoj nga ju që ta diskutoni, edhe nga Ministria por edhe nga deputetët këtu që Agjencia e Pyjeve të shohë mundësinë për fillimin e projekteve publiko-private për industrinë drusore, prodhimin, përpunimin dhe riciklimin.

Në këtë mënyrë mund të organizohet edhe prerja me edukimin paraprak nga ata të cilët janë pronarë të pyjeve në mënyrë private, të mos të hyjnë në prerjen e pyjeve në mënyrë tradicionale siç i kanë prerë, por të kenë një edukim nga ata të cilët kanë një ngritje shkollore dhe një ngritje parapërgatitore për këtë çështje.

Po ashtu, edhe ata të cilët merren me industrinë drusore, qoftë me dyer, dritare apo me parket, apo edhe me riciklimin që është për industrinë për ngrohje, të fillohen të pastrohen malet nga ato mbeturina të cilat kanë rënë nga gjethet, nga drunjtë, nga degët që janë potencial për t'u djegur dhe për të rrezikuar pastaj pjesën tjetër.

Prandaj, këtë pikën e dytë kisha kërkuar që ta rishqyrtojnë parashtruesit e këtij debati dhe t'u hapet mundësi, edhe Qeveria të shohë masa monetare shtesë për punonjësit sezonalë për pastrimin e pyjeve, grumbullimin në një pikë të caktuar dhe të fillojë aktivizimin e disa industrive të vogla në frymën edhe të zhvillimit ekonomik, edhe të uljes së papunësisë, edhe janë disa pika në Kosovë të cilat vërtet kanë edhe nevojë ekonomike dhe në këtë mënyrë këta prodhues do të ishin edhe mbulues të pagave të tyre së bashku me Ministrinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sipas radhës, fjalën e ka deputeti nga Lidhja Demokratike e Kosovës Haki Demolli.

HAKI DEMOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Kërkesa e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor për debat parlamentar lidhur me gjendjen e pyjeve në Kosovë, është njëra prej kërkesave mjaft të arsyeshme, sepse bëhet fjalë për njërin prej resurseve më të rëndësishme pasurore të vendit tonë.

Prandaj, është e pritshme që sot në këtë Kuvend jo vetëm të debatohet, por edhe të miratohen rekomandimet të cilat do të ndikonin në mbrojtjen dhe parandalimin e veprimeve me të cilat rrezikohen dhe atakohen pyjet tona.

Fjala është për një sipërfaqe shumë të madhe të territorit të vendit tonë, sepse sipas Agjencisë Pyjore të Kosovës, diku afër 42% e Kosovës është e mbuluar me pyje, kurse 68% e këtyre pyjeve janë në pronësi publike, e cila seriozisht është e rrezikuar dhe gjendet në shënjestër permanente të veprimeve të ndryshme të kundërligjshme.

Si rezultat i këtyre veprimeve të kundërligjshme vlerësohet se diku brenda një viti vëllimi i drunjve të dëmtuar arrin në hiç më pak se 100 000 metra kub, prandaj shifra e tillë alarmante gjithsesi paraqet një arsye të mjaftueshme për një trajtim dhe një qasje shumë më serioze problemit të dëmtimit të pyjeve në Kosovë jo vetëm nga ky Kuvend, por edhe nga organet dhe institucionet tjera shtetërore të vendit tonë.

Bazuar në praktikat dhe sidomos në dobësitë e mbrojtjes së pyjeve mendoj se ndër faktorët kryesorë të krijimit të gjendjes së këtyre janë:

1. Mbrojtja jo e mjaftueshme fizike e pyjeve tona, sikur nga vjedhja, ashtu edhe nga zjarret dhe rreziqet tjera natyrore.

Sipas zyrtarëve të Agjencisë Pyjore të Kosovës, në Kosovë për mbrojtjen e afërt 288 000 hektarëve me pyje publike, janë të angazhuar vetëm 210 rojtarë pyjesh, numër ky i cili nuk është i mjaftueshëm, sepse mesatarisht një rojtar duhet kujdeset për mbrojtjen e mbi 1 400 hektarëve të pyjeve, gjë që paraqet një obligim të parealizueshëm, madje edhe në situata të përkushtimit dhe dedikimit të jashtëzakonshëm.

Vlen të theksohet se jo vetëm që numri i rojtarëve të pyjeve është i vogël, por të njëjtit nuk janë të pajisur me mjete të nevojshme teknike, nuk janë të paguar mirë, si dhe nuk mbrohen nga organet kompetente, si gjykatat, policia e të tjera.

2. Faktor tjetër që po ndikon në shkatërrimin dhe vjedhjen e pyjeve në Kosovë gjithsesi është edhe jo efikasiteti dhe jo profesionalizmi i gjykatave tona, të cilat, për fat të keq, sikurse edhe në rrafshin e paraqitjes dhe rritjen e korrupsionit, kontrabandës dhe formave tjera të krimit të organizuara, edhe në këtë rrafsh po e japin kontributin negativ, sepse, sipas zyrtarëve kompetentë në gjykatat e Kosovës janë dërguar mbi 70 000 me natyrë të vjedhjes dhe dëmtimit të pyjeve. Më se 50% të këtyre lëndëve për shkak të joefikasitetit dhe jo azhuritit të gjykatave tanimë janë parashkruar, kurse edhe në rastet e gjykimit të kryerësve, atëherë dënimet kanë qenë rëndom minimale apo shumë të ulëta sa që

sanksionet e tilla më shumë mund të konsiderohen si masa të karakterit simulues se sa të atij ndëshkues.

Andaj, kërkoj nga autoritetet shtetërore dhe gjyqësore të ndërmarrin masa të nevojshme për mbrojtjen e pyjeve dhe ndëshkimin e dëmtuesve të tyre, pavarësisht nga kostoja e masave të tilla, sepse përndryshe do të vinte në shprehje vërejtja e koordinatorit të EULEX-it për çështje pronësore, i cili pat thënë: çdo dobësi të autoriteteve në fushën e mbrojtjes së pronës, sidomos të asaj të popullit apo pronës publike e rrit rrezikun që njerëzit të jenë të detyruar të marrin ligjin në duart e veta e që ndoshta mund të ketë edhe epilog me pasoja fatale.

Faktor tjetër që ndikon në dëmtimin e pyjeve cilësore të Kosovës është edhe hartimi dhe zbatimi joadekuat i planeve operative për prerjet vjetore të pyjeve, si dhe shkatërrimi i pyjeve nëpërmjet tenderëve në emër të pastrimeve nga zjarret, veprime këto me të cilat në njërin anë për shkaqe subjektive apo më mirë thënë korruptive përcaktohet prerja tej mase e drurit në regjione të caktuara, e në anën tjetër, herë-herë fitimi i tenderëve shërben si një motiv shtesë për vënien e zjarreve me natyrë kriminale, nga të cilat fatkeqësisht shkatërrohen me qindra hektarë të pyjeve të Kosovës.

Prandaj, me qëllim të përmirësimit të gjendjes në rrafshin e parandalimit dhe mbrojtjes nga krimet kundër pyjeve të Kosovës, ndër të tjera, propozoj edhe këto masa:

1. Sforcimin dhe rritjen e numrit të pjesëtarëve të shërbimit të rojtarëve të pyjeve.
2. Shtimin e masave për parandalimin e veprimeve të kundërligjshme, përfshirë edhe zjarret e të gjitha natyrave.
3. Ngritjen e efikasitetit të gjykatave të Kosovës gjatë trajtimit të lëndëve penale të kësaj natyre.
4. Sforcimin e politikës ndëshkimore ndaj kryerësve të veprave penale me të cilat dëmtohen pyjet e Kosovës.
5. Hartimin dhe zbatimin me përpikëri të planeve profesionale për prerjet vjetore të pyjeve, dhe
6. Hetimin dhe monitorimin e posaçëm të tenderëve për pastrimin e pyjeve nga zjarret. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Demolli! Po e shoh se disa deputetë i dhanë edhe sugjerimet e tyre konkrete se çka të përfshihet në ato rekomandime, kështu që po ju paralajmëroj që tash, në këtë moment, ata që e kanë propozuar debatin si dhe anëtarët tjerë të Komisionit, po edhe ata që kanë rekomandime konkrete në këtë pjesën e sipërme të hollit këtu, janë duke i harmonizuar ato. Kështu që, nëse mendoni se rekomandimet tuaja do të kishin qenë mirë të përfshihen në rekomandimet përfundimtare që do të jenë

zyrtare, atëherë t'u bashkoheni atyre në mënyrë që kjo të mos të ndikojë në votimin tuaj negativ, në fund.

Fjalën nga SLS-ja, e ka Milivoje Stojanović.

MILIVOJE STOJANOVIĆ: Greška, predsedavajući! Poslanička grupa Zajednička budućnost!

Gospodine predsedavajući,

Uvažene kolege poslanici,

Članovi Vlade,

Šume su svuda u svetu nacionalno bogatstvo koje se štiti zakonom. Svi znamo da je Kosovo prekriveno bogatom florom i to oko 60% svoje teritorije.

Postavlja se pitanje: kakvo je danas stanje na Kosovu po pitanju šuma? Da li se povećavaju ili smanjuju površine pod šumama? Šta činimo i na koji način činimo da zaštitimo naše prirodne resurse?

Ako realno sagledamo situaciju, znamo da postoji Zakon o šumama, postoje izmene i dopune ovog zakona, kao i određena uputstva i uredbe koje prate primenu zakona i uređuju ovu oblast.

Ovim normativnim aktima je regulisan način upravljanja za očuvanje biološke raznolikosti vrsta, da se obezbedi ekološki održivi razvoj i da se obezbedi javni interes društva.

Međutim, ako realno govorimo o stanju naših šuma moramo istaći sledeće: Da nisu adekvatno zaštićene od razne bolesti, da ih razni insekti napadaju i uništavaju, da se svakodnevno u letnjem periodu javljaju mali i veliki požari, da imamo na terenu neplansku seču, da se svakodnevno dešavaju krađe ogrevnog industrijskog drveta, da nema ili vrlo malo ima pošumljavanja i nešto što se u zadnjem periodu vrlo često dešava da svakog dana niču nove vikendice bez dozvola za gradnju u šumskim područjima.

Potrebno je racionalno upravljanje šumama, koje podrazumeva imati precizne podatke o javnim i privatnim šumama. U skladu sa ovim popisom, potrebni su kvalitetni kratkoročni i dugoročni planovi upravljanja našim šumama.

Treba definisati šta treba uraditi, u kojim teritorijalnim područjima, gde i koliko se može seći šuma, koje vrste drveta se mogu eksploatisati i u kom obliku.

Vrlo je bitno sprečiti korišćenja neobnovljivih resursa kako bi se sprečilo njihovo uništavanje. Posebno treba obratiti pažnju na zaštitu vode, divljeg života ali i ostalih osetljivih prirodnih resursa koji su vezani neposredno sa šumama.

Potrebno je pošumljavanje goleti, zameniti degradirane šume, kontrolisati seču i uspostaviti ravnotežu između seče i prirasta drvne mase.

Zadnjih godina, razvija se industrija nameštaja, što je ohrabrujuće. Međutim, neplanskom eksploatacijom drvne sirovine sa domaćeg terena može da se unište šume, posebno ako znamo da se jedan deo trupaca nabavlja ilegalno odnosno krađom.

Bitno je da sve institucije preventivno deluju na sprečavanju nesavesnog ponašanja građana u letnjem periodu, kada zbog nepažnje ili nemara dolazi do izazivanja požara. Požarom se svake godine unište velike površine šuma. Požari su vrlo česti i najveća su opasnost za šume, ali i celokupnu floru.

Vrlo česta pojava, koja se javlja jeste nezakonita seča šuma. Poslednjih 13 godina imamo pojavu svakodnevne bezobzirne krađe javnih ali i privatnih šuma. Posebno je izražena pojava uzurpacija i krađa šuma pripadnika Srpske i ostale ne Albanskih zajednica, koji se zbog toga osećaju nesigurno i nezaštićeno.

Nedavno su vlasnici šuma Srpske zajednice u selu Poneš morali sami da sa oružjem u ruke spreče kradljivce koji su nekoliko puta pre toga pokušavali da im poseku šumu. Na kraju se desilo to da je došlo do pucnjave, odnosno do ubistva i ranjavanja, a kao rezultat svega toga i pogoršanje odnosa između Srpske i Albanske zajednice u ovom selu. Desilo se i to da se jedna porodica iselila iz sela zbog straha od revanšizma.

Zato, pozivam sve institucije sistema, posebno policiju i sudstvo da brzo i pravovremeno i sa više posvećenosti rešavaju ovakve slučajeve. Na taj način, Srpska zajednica stekla bi više poverenja u institucije i brže bi se uključila u društvene tokove, što je u interesu celog društva. Izbegli bi slučajeve kada građani sami uzimaju zakon u svoje ruke.

Na kraju da istaknem. Koliko uspemo da u sektoru šumarstva budemo uspešni po pitanju zaštite, aktivnosti pošumljavanja, prevencije i zaštite od požara, dezinfekcije od insekata i raznih bolesti, sprečimo seču stabla i krađu stabla, u toj meri će nam biti zaštićena šuma i obezbedićemo očuvanje biološke raznolikosti vrsta, obezbediti ekološki održivi razvoj i obezbediti javni interes društva.

Poslanička grupa Zajednička budućnost želi da ima aktivnu ulogu u očuvanje javnog interesa i da preduzme odgovarajuću odgovornost u realizaciju. Zahvaljujem!

KRYESUESI: Faleminderit! Tash së fundi, siç dihet, është krijuar edhe një grup i ri parlamentar, Ardhmëria e Përbashkët, si dhe kanë ndodhur disa kalime të deputetëve prej një grupi në tjetër. Kjo e ka prekur edhe Koalicionin për Kosovë të Re, si dhe Grupin Parlamentar SLS, kështu që i kisha bërë thirrje regjisë, që prej mbledhjes së ardhshme ta përmirësojë vendosjen e subjekteve politike në mënyrë të saktë se cilët deputetë cilin subjekt politik e përfaqësojnë, sepse këtu në elektronikë ka mbetur ende versioni i vjetër. Pra, i bëj thirrje regjisë që këtë ta kenë prioritet për mbledhjen e ardhshme dhe të mos e kemi më këtë problem.

Fjalën e merr deputeti i Partisë Demokratike, Bekim Haxhiu, pastaj le të përgatitet nga Koalicioni për Kosovë të Re, Myzejene Selmani.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sipas statistikave në Kosovë ka rreth 52 milionë metër kub dru, rreth 33 milionë metër kub u përkasin pyjeve shtetërore, ndërsa 19 milionë metër kub atyre private. Pra, i bie që rreth 60% e pyjeve janë pyje shtetërore, ndërsa 40% tjera janë pyje private.

Pyjet e Kosovës për vite të tëra janë shfrytëzuar në mënyrë të pakontrolluar si nga individë dhe grupe të ndryshme që kanë formuar një makineri të fuqishme ilegale për prerjen, tërheqjen dhe transportimin e masës drunore.

Të nderuar kolegë deputetë,

Viti 2011 ishte viti ndërkombëtar i pyjeve dhe ky vit ndërkombëtar i pyjeve i gjen pyjet e Kosovës të dëmtuara në masë të madhe, qoftë nga zjarret, qoftë nga njerëzit, ndërsa Kuvendi i Kosovës, në vitin 2012, një vit më pas, ka miratuar edhe dy ligje- Ligjin për Parkun Kombëtar të Sharrit dhe Ligjin për Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna, me çka, sipas mendimit tim, ka bërë një kthim prapa në fushën e mbrojtjes së pyjeve dhe vetëm sa e ka koklavitur këtë fushë, ku shikohet rregullimi ligjor që ka paraparë administrimin e këtyre dy parqeve dhe futjen e pyjeve private në menaxhimin e Ministrisë së Ambientit, pa paraparë as kompensimin e as qasjen në pronë private dhe kjo sigurisht se shkaktoi revoltën e banorëve të atakuar me këto dy ligje.

Të nderuar kolegë deputetë,

Është më se evidente se kemi një shkatërrim të pyjeve dhe ky shkatërrim në veçanti ka ndodhur pas përfundimit të luftës, në mungesë të një kontrolli adekuat, ka ndodhur një shkatërrim si pasojë e zjarreve po edhe me ndikimin e faktorit njeri. Mungesa e burimeve alternative të energjisë në Kosovë dhe shfrytëzimit të drurit për ngrohje ka çuar drejt keqpërdorimit të pyjeve dhe kur kihet parasysh se edhe masat ndëshkuese nga gjyqësori nuk janë në nivelin me dëmet që janë shkaktuar, atëherë është krijuar përshtypja se edhe këto masa ndëshkuese nga gjyqësori më tepër janë stimuluse se sa që janë ndëshkuese.

Ruajtja dhe mbrojtja e pyjeve tani është në përgjegjësi të autoriteteve komunale dhe për vitin 2012 autoritetet komunale kanë ngritur një numër të madh të fletëparaqitjeve për dëmtimin e pyjeve. Sipas Ahmet Zejnullahut, kryeshef i Agjencisë Pyjore, për shkak të dëmtimit të pyjeve, autoritetet komunale gjatë vitit 2012 kanë bërë 7 586 fletëparaqitje prej të cilave 4 854 janë për kundërvajtje, ndërsa pjesa tjetër prej 2 730 janë për vepër penale. Deri te një angazhim shtesë nga autoritetet komunale ka ardhur pasi që vetë kreu i Agjencisë Pyjore ishte këmbëngulës në respektimin e ligjit dhe me këtë vendosmëri ai ngriti kallëzime penale edhe për autoritetet komunale të cilat nuk e kanë respektuar ligjin dhe për këtë dua publikisht ta falënderoj kryeshefin e Agjencisë, zotin Zejnullahu për punën e mirë të deritanishme.

Komisioni përkatës parlamentar duhet të mbështesë punën e kësaj Agjencie duke i bashkërenduar veprimet me ta dhe Komisioni parlamentar ndryshimet që i ka bërë në dy ligjet, atij për Parkun e Sharrit dhe Parkun e Bjeshkëve të Nemuna, vetëm sa është vënë në shërbim të grupeve të caktuara të interesit.

Do të doja të di pse Komisioni Parlamentar, te administrimi i parqeve nacionale ka paraparë themelimin e drejtorive për administrimin e këtyre parqeve, njërit ia ka caktuar selinë në Pejë, e tjetrit nuk i ka caktuar seli fare dhe për njërin e ka paraparë themelimin e Drejtorisë për Administrim, në afat prej 3 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit, ndërsa për tjetrin ka paraparë themelimin po të njëjtës drejtori, në afat prej 6 muajsh, edhe pse këto dy ligje kanë kaluar në po të njëjtën ditë në Kuvendin e Kosovës.

Interesimi është pse Komisioni ka bërë këso koklavitjesh në ligj, a janë të rastësishme, nuk i kam parë, apo janë bërë për përfitime të grupeve të caktuara të interesit? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka shefja e Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovën e Re, Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Unë nuk e desha fjalën për çështje të diskutimit, mirëpo grupet parlamentare të cilat janë formuar të reja, ato kanë të drejtë të paraqiten në Kryesi dhe nuk ke nevojë të thuash është prekur koalicioni se te Koalicioni për Kosovën e Re s'ka të prekur, kështu që në rast se preken deputetët atëherë vijnë emrat e tyre në Kryesi.

KRYESUESI: Zonja Selmani, nuk e thashë me kurrfarë tendence këtë, e thashë për regjinë që ta ketë parasysh, sepse një grup i ri parlamentar është krijuar tash së fundi, kurse deputetë të ndryshëm iu kanë bashkëngjitur grupeve të ndryshme parlamentare, kështu që duhet ta kenë parasysh ata që përmirësimin ta bëjnë për çdo grup parlamentar që deputetët e kanë ndërruar përcaktimin e tyre. Prandaj, nuk e thashë unë me kurrfarë tendence këtë gjë, e thash për regjinë dhe jo për deputetët.

Fjalën e ka nga Partia Demokratike e Kosovës, deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Faleminderit, i nderuari kryesues!

Unë pata dy inspirime që kërkoja fjalën. Inspirimin e parë po e lexoj, të konceptuar, ashtu siç e kam dhe në të dytin, do të ndalem pastaj shkurtimisht.

Tema është mjaft e qëlluar dhe përgëzoj Komisionin përkatës që e ka propozuar. Është e vërtetë se pyjet janë resurs që zhvillojnë industrinë, kështu e kam konceptuar, e pasurojnë ekonominë në fusha, e ndryshojnë ekologjinë e vendit tonë në cilësi dhe është me ndikime në shëndetësinë e qytetarëve të vendit tonë.

Në këtë fokus, ekspertët e Ministrisë do të duhej të motivoheshin në hartimin e strategjive zhvillimore të pyjeve.

Motivi i dytë ishte për kënaqësinë e kolegëve deputetë, edhe të publikut. Më ngjalli një nostalgji me udhëheqjen e kësaj mbledhjeje, sepse këtu në këtë sallë ke hyrë me flamurin kuq e zi dhe tani nën siglën dhe nën flamurin e institucioneve të Kosovës, ma ngjallë edhe mua një sendiment, sepse edhe unë në këtë Parlament kam hyrë me flamurin kuq e

zi, por kam bërë betimin mbi këtë flamur dhe në këto simbole. Kështu që gjeta diçka nga vetvetja edhe natyrisht se më bëri kureshtar.

KRYESUESI: I nderuar, nëse mund t'i rrekeni temës, për të cilën jemi mbledhur, po debatohet për pyjet e jo për qëndrimet politike të subjekteve politike për simbolet kombëtare. Këtu jemi duke debatuar për pyjet.

Atëherë, meqë nuk ka të tjerë të paraqitur për debat, para se t'ia jap fjalën në emër të Komisionit, zotit Hasani, i bëj thirrje ministrit që ta marrë fjalën, nëse dëshiron.

MINISTRI BLERAND STAVILECI: Faleminderit , edhe një herë të nderuar deputetë. Unë e thash, që nga fillimi se i pranojmë të gjitha rekomandimet, besoj jo vetëm ato që ishin herën e parë kur u lexuan, ma merr mendja se tash do të plotësohen edhe me të tjera.

Nuk është ndoshta punë e imja që t'i vlerësoj debatet që i bëri secili. Prej secilit të këtyre debateve mund të nxirren përfundime të mira, megjithatë ndoshta nuk po i them me emra, por disa prej diskutimeve ishin shumë të mira, shumë produktive, por në anën tjetër kishte edhe diskutime të cilat ma merr mendja nuk i bëjnë mirë as Komisionit, për shkak se po i them dy prej deputetëve që deklaruan për çështjen e përzjerjes së kompetencave dhe mbivendosjes së niveleve.

Po të ishte vullneti i mirë dhe po i referohem edhe diskutimit kur kanë qenë në rend të ditës të tria ligjet, kur kam thënë se gjithçka duhet të ndryshohet dhe është mirë që të tria të kthehen dhe të ulemi t'i bëjmë bashkë, mirëpo ishte pastaj tendencë e dikuajt që të nxitojë dhe t'i miratojë ato.

Atëherë, nëse është tendenca që të eliminohen nivelet, me ato dy ligje u shtua edhe një nivel dhe ju e dini cili, një institucion dhe nuk besoj që kjo është e mirë për shkak se nga njëra anë po themi që t'i thjeshtësojmë, në anën tjetër ne vetë, ju në këtë rast, po i mbivendosni ato dhe shumë më mirë do të ishte që të shkonte nga fillimi.

Pastaj, u përmend vizita në Austri. Ne kemi diskutuar disa herë në Komision dhe më besoni që isha në hamendje a ta marr apo mos ta marr fjalën, mirëpo mendoj që secili prej neve, meqenëse edhe është debat publik, duhet ta dijë edhe angazhimin e secilit. Anëtarët e Komisionit i kanë ndryshuar mendimet dhe qëndrimet, pastaj po thoni i kemi bërë debate publike.

Pjesë e këtij Komisioni është edhe deputetja, zonja Berisha, e cila besoj që pati njërin nga diskutimet më frytdhënëse e cila tash i ndesh ato që ju i thatë me shqetësimet e qytetarëve në Dragash.

E keni parë edhe një letër të kryetarit të asociacionit të pyjeve private. Unë mendoj se e jona do të ishte që të gjitha këto t'i mblidhnim dhe të shikonim edhe një herë dhe jo vetëm të dalim dhe të bëjmë se kush e ka fajin.

Po ashtu, edhe një deputete tjetër, që i përmendi tri komuna, me dashamirësinë më të madhe e ftoj që të shkojë në njërin prej tyre dhe t'i takojë shokët e vet të partisë, e ta

shih se çfarë ndodhë atje. Me kompetenca që ata i kanë dhe shumë çështje të tjera, por unë nuk dua të ndalem, sepse nuk dua të polemizoj dhe prapë po them që rekomandimet të cilat dalin, ne do t'i respektojmë, besoj se ka edhe shumë të tjera me të cilat mendoj që pasurohet edhe debati po edhe do të na shërbejnë të gjithëve, sepse thashë që nuk është aktori i vetëm Ministria, duke mos dashur që t'i ikim përgjegjësive, përkundrazi edhe nëse pas një debati dhe analize më të gjerë mendohet se ka ndonjë zgjidhje më të mirë, ne prapë jemi edhe për të qenë ata që kemi ndoshta më së shumti përgjegjësi, por ndoshta edhe më së paku, nëse mendohet një zgjidhje tjetër për ta ristrukturuar sektorin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, ministër! Mendoj se duhet të përmbaheni nga kualifikimet se filan deputeti e kishte diskutimin keq, dhe cili mirë, për arsye se me siguri që secili i prezanton argumentet.

(Reagime)

Mos më pengoni në udhëheqjen e seancës, ju lutem! E nëse e kërkon fjalën, mund t'ua jap. Mirëpo, kjo nuk është në rregull.

(Ndërhyrje)

Po the, cili ka qenë frytdhënës dhe cili nuk ka qenë frytdhënës.

(Ndërhyrje)

Po tash, secili deputet e ka mendimin e vet dhe secili i konsideron ato argumente të tij që janë të rëndësishme dhe ju duhet ta respektoni këtë më shumë.

Mendoj se tash duhet t'ia japi fjalën, në emër të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, zotit Hasani...

(Polemikë)

Mendoj se i kemi përfunduar diskutimet dhe fjalën e ka Nait Hasani, në emër të Komisionit që t'i prezantojë rekomandimet e arritura.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Komisioni ka formuluar rekomandimet, të nxjerra nga debati dhe kërkojmë që:

1. Qeveria e Republikës së Kosovës t'i vlerësojë dëmet në pyjet e Kosovës, të shkaktuara gjatë verës së vitit 2012.

2. Kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës të formojë një taks-forcë për mbrojtjen e pyjeve brenda 30 dite deri në miratimin e Ligjit të pyjeve, me detyra si në vijim:

a) Menaxhimin e situatave emergjente në rast të zjarreve;

- b) Në parandalimin e prerjeve ilegale;
- c) Në mbrojtjen nga sëmundjet;
- d) Në ngritjen e efikasitetit të gjykatave në trajtimin e lëndëve me vepra penale, me të cilat atakohen pyjet.

3. Hartimin e reformës për pylltarinë e cila duhet t'i ketë parasysh menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve.

4. Të hartohet ligji në të cilin do të definoen saktësisht rolet dhe përgjegjësitë e menaxhmentit ndërmjet nivelit qendror dhe lokal. Faleminderit!

KRYESUESI: Urdhëro! Për procedurë është paraqitur për diskutim, Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, kryesues!

Mendoj që është e paraparë me Rregulloren e punës të Kuvendit, kur ka një ndryshim nga propozimet të cilat kanë ardhur në fillim të debatit, me rekomandimet të cilat janë në fillim të debatit, duhet që rekomandimet të shkruhen, të përkthehen dhe pastaj të vijnë në votim. Është rregull e paraparë me Rregulloren e punës të Kuvendit.

KRYESUESI: Nëse dëshiron që fjalën ta marrë propozuesi i rekomandimeve, zoti Hasani?

NAIT HASANI: Unë kërkoj të hidhen në votim, rekomandimet janë miratuar nga Komisioni dhe shumica e rekomandimeve që kanë dalë nga këtu, Komisioni e ka marrë një qëndrim tash në harmonizimin e tyre dhe kërkon të votohen.

KRYESUESI: E para, e punës, unë përderisa ishin duke u zhvilluar diskutimet, i ftova të gjithë ata që kanë propozime konkrete të dalin në vendin e caktuar ku ndodhte harmonizimi, që t'i harmonizojnë rekomandimet dhe të gjithë ata që e kanë bërë kanë bërë shumë mirë, kurse deri më tash, prej praktikës që e kemi parë, ka ndodhur që edhe pse rekomandimet fillimisht janë ndryshuar, janë hedhur për votim në seancë, kështu që këtë po e bëjmë edhe tash, sepse është themeluar një traditë deri tash si kemi vepruar dhe kështu po veprojmë edhe tash.

Lus të më informojnë se sa deputetë i kemi të pranishëm në sallë, aktualisht.

Urdhëro, zoti Muja, por shumë shpejt, për procedurë, me siguri, sepse po hyjmë në rrjedhën e votimi.

SHAIP MUJA: Unë mendoj që këto rekomandime të rishikohen dhe sot të mos votohen. E dhashë një propozim shumë konkret, i cili ndihmon zhvillimin ekonomik, ul papunësinë dhe e bën preventivën e lartë për mbrojtjen e pyjeve dhe propozimi im ka qenë kështu: Ministria e Bujqësisë dhe Agjencia e Pyjeve të shohin mundësitë për aktivizimin e programeve publiko-private për industrinë drusore, prodhim, përpunim dhe riciklim.

Është shqetësuese që Komisioni më shumë po bën politikë se sa ndonjë politikë të bazuar e cila mund të sjellë dobi ekonomike, ekologjike e tjera. Prandaj, ky Komision duhet ta shohë vetën, ose do të bëjmë politike zhvillimore, ose do të bëjmë politika filozofike. Faleminderit!

KRYESUESI: Para se të them diçka, e lus regjinë që t'i bjerë alarmit që deputetët të kthehen në sallë, sepse tash e kemi votimin e rekomandimeve.

Zoti Muja, komisioni me siguri ka punuar nëpërmjet konsensusit dhe aty secili e keni pasur rastin t'i paraqitni idetë tuaja. Me siguri që diçka do të merret parasysh e diçka nuk do të merret parasysh, mirëpo ne nuk mund ta mbajmë peng seancën dhe votimin vetëm pse një filan rekomandim i filan deputetit nuk është përfshirë drejtpërdrejt në ato rekomandime.

Rekomandimet na i paraqiti zyrtari i Komisionit në mënyrë zyrtare dhe këto janë të vlefshme për t'u votuar në këtë seancë.

KRYESUESI: Urdhëro, zoti Muja.

SHAIP MUJA: Zoti kryesues!

Propozimi im është, nuk po them pse unë jam filani, unë nuk jam filani, unë e kam një numër të votave që kam ardhur këtu. Dhe këtu unë po i përfaqësoj interesat e atyre qytetarëve të cilëve unë u takoj dhe atyre të cilët janë të interesuar ta organizojnë industrinë e punimit të drurit dhe mbetjeve drusore.

Prandaj, nuk është e mirë që ne të paraqesim vetëm projekte filozofike, por zhvillimore, ekonomike dhe preventive. Këto çfarë po fliten - task-forca, ne jemi lodhur me task-forca. Ky popull është lodhur me task-forca, e as nuk e dinë se çka është task-forca.

KRYESUESI: Jo, unë vetëm e thashë, në atë mënyrë, sepse edhe deputetët tjerë mund të kenë rekomandime, të cilat nuk mund t'u jenë përfshirë ndoshta shkronjë për shkronjë. Mirëpo, Komisioni me shumicë është e rëndësishme që ka ardhur deri te disa rekomandime zyrtare, të cilat i prezantoi udhëheqësi i Komisionit përkatës.

Kërkoj nga regjia, nëse është i saktë ky numër që e kam në dorë tash, apo ka ndryshuar? Po, ky është. Do të thotë nuk kemi kuorum. Janë vetëm 54 deputetë të pranishëm dhe nuk kemi numër të nevojshëm për të votuar.

Atëherë, unë u bëj thirrje deputetëve që të jenë më të përgjegjshëm për punën të cilën e kemi obligative, sepse kjo është fyerje, tek e fundit, edhe për qytetarët.

(Ndërhyrje)

Me kërkesë të nënkryetarit, po kërkoj një votim për prani elektronike në seancë.

Regjia, ju bëj thirrje të përgatiteni për votim dhe votojmë tash për praninë elektronike të deputetëve.

Sipas elektronikës, kanë votuar 54 deputetë, kjo do të thotë se nuk kemi kuorum për të votuar, ashtu sikur që mbetën pa u votuar edhe dy raportet më herët, edhe kjo i bartet seancës së ardhshme.

Me kaq e përfundojmë këtë seancë. Mirupafshim!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes së filluar më 23 maj
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Jakup Krasniqi.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,
Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 23 maj 2013.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 67 deputetë, që domethënë se janë plotësuar kushtet për të filluar me punë.

Vazhdojmë me pikat e mbetura të rendit të ditës, si në vijim:

1. Votimi i raportit vjetor të punës së Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2012

Diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e kaluar, tani ka mbetur vetëm votimi.

Ju njoftoj që në votim është i domosdoshëm të arrihet numri 61.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Edhe një herë! Me votimin që e keni bërë, raporti nuk kalon. Është e domosdoshme, sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, që të arrihet numri 61. Nëse në votim nuk marrin pjesë 61 deputetë, votimi konsiderohet negativ. Ta keni këtë parasysh.

Votojmë edhe një herë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!
Me 67 vota për, 1 kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi e miratoi raportin vjetor të punës së Zyrës së Rregullatorit për Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2012.

2. Votimi i raportit vjetor të punës së Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2012

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 68 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi e miratoi raportin vjetor të punës së Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave për vitin 2012.

3. Votimi i rekomandimeve nga debati parlamentar lidhur me gjendjen e pyjeve në Kosovë

Diskutimet janë kryer, rekomandimet gjithashtu janë bërë, dhe tani jem në votim.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 70 vota për, asnjë kundër dhe 3 abstenime, Kuvendi miratoi rekomandimet nga debati parlamentar lidhur me gjendjen e pyjeve në Kosovë.

Dhe me këtë e kemi përfunduar seancën e kaluar. Mirupafshim në seancën e ardhshme!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*